



Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës

WORKSHOPI I -RË RAJONAL

“Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi”

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë

8-10 Dhjetor, 2000

Organizuar nga:

Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT

Në bashkëpunim me

Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT



Tiranë

WORKSHOPI I -RË RAJONAL

“Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi”

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

***Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000***

Organizuar nga:
Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT
Në bashkëpunim me
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT

Tiranë

Workshop-i i Parë Rajonal
“Trauma, faktorët, pasojat dhe përballimi”
Një perspektivë rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000
Organizuar nga:
Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës- QSHRMT
Në bashkëpunim me:
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims – RCT, Kopenhagen

First Regional Workshop
“Trauma, factors, consequences and the coping process”
A regional perspective: Albania, Kosova and Macedonia

Tirana
8-10 December 2000
Organized by:
Albanian Rehabilitation Center for Torture Victims-ARCT
In cooperation with:
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims- RCT, Copenhagen
(summaries in page)

Address:
Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
Rruga: “Kont Urani”, 10 Tiranë, Albania
Tel.++3554256522
E-mail: arct@albmail.com

PËRMBAJTJA

- **Organizimi, Punimet, Vendime**
- **Pjesëmarrësit në Workshop**
- **Adrian Kati**
Fjala e Hapjes
- **Tue Magnussen**
Strategjia e RCT-së në mbështetje të viktimave
të torturës në botë.....
- **Prof.As.Dr. Fatmira Rama**
Retrospektivë e përndjekjes nacionale ndaj shqiptarëve
dhe integrimi ballkanik
- **Prof.Milaim Fejziu**
Trauma te shqiptarët e Maqedonisë shikuar nga aspekti i
realizimit të lirive dhe të drejtave të tyre në Maqedoni
(dhe 4 raporte të Forumit Demokratik për Mbrojtjen e të
Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Maqedoni-Gostivar).....
- **Prof. Dr. Adem Tamo**
Trauma te shqiptarët në një perspektivë social psikologjike.....
- **Dr. Dragush Totozani**
Trajtimi psikosocial në QSHRMT.....
- **Bardhyl Belishova**
Vecanti të rehabilitimit të viktimave të totalitarizmit në
Shqipëri.....
- **Dr.Feride Rushiti**
Prezantimi i QKRMT.....
- **Dr. Shaban Memeti**
Nevoja e ngritjes së Qendrës së Rehabilitimit për të
Mbijetuarit e Torturës në Maqedoni.....
- **Niazi Jaho**
Disa çështje lidhur me Liritë dhe të Drejtat e Njeriut
në frymën e dokumentave ndërkombëtare dhe
kushtetutës tonë.....

- **Luan Kroj**
Eksperiencia e Institutit të Integritit të Përndjekurve
Politikë në Shqipëri
- **Aferdita Onuzi**
Mirënjohje për miqtë e mirë si Berit Backer.....
- **Përmbledhja e temave në anglisht**

WORKSHOPI I PARË RAJONAL

"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi" Një persepektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni.

(Organizimi, Punimet, Vendimet)

Nga data 8 deri në 10 Dhjetor 2000 u mbajt në Tiranë Workshopi i Parë Rajonal me temën " Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi. Një perspektivë Rajonale: Shqipëri, Maqedoni, Kosovë".

Mbajtja e këtij Workshop-i u propozua nga QSHRMT dhe u organizua me përkrahjen e RCT- së

Në këtë workshop morën pjesë përfaqësues nga RCT- Copenhagen, Instituti i Integritimit të Ish të Përndjekurve Politike, Shoqatat e Ish të Përndjekurve Politikë nga Shqipëria , Maqedonia dhe Kosova, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, Instituti Shqiptar për Hulumtimin e Krimeve të luftës në Kosovë, Departamenti i Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës pranë Forumit Demokratik për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut në Maqedoni-Gostivar , profesorë nga Universiteti i Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës, drejtuesit e QKRMT-së dhe QSHRMT-së.

Konteksti dhe Pikësynimet e Workshop-it

Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës si partnere e RCT-Copenhagen në kuadrin e lëvizjes ndërkombëtar për lehtësimin e vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës, prej vitesh është duke punuar në drejtim të rehabilitimit të të mbijetuarve të torturës si rezultat i shtypjes së regjimit komunist të Enver Hoxhës në Shqipëri. Në kushtet e jashtëzakonshme që u krijuan gjatë krizës kosovare, për t'iu përgjigjur nevojave emergjente të shoqërisë kosovare për të përballuar problemin e mprehtë të pasojave të traumës kolektive të shkaktuar nga shtypja e gjithanshme dhe alarmuese policore e popullsisë shqiptare nga regjimi shovinist i Miloshevicit, QSHRMT dha ndihmesën e vet për krijimin e KRCT-së, Qendrës Kosovare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve nga Tortura.

Parë në një kontekst historik, në hapësirat mbarëshqiptare është ushtruar sistematikisht dhunë e genocid etnik ndaj shqiptarëve, dhunë që ka shkaktuar një traumë kolektive në popullsinë shqiptare, të cilës i është mbivendosur trauma e shkaktuar nga shtypja gati 50 vjecare e rregjimeve totalitare komuniste në këto hapësira.

Për shmangien e pasojave të shkaktuara nga një traumë e tillë kolektive dhe e shtresëzuar në kohë, del si një nevojë emergjente që të bashkërendohet puna në një nivel mbarëshqiptar, duke krijuar një sistem network-u të qendrave të rehabilitimit të të mbijetuarve nga torturat. Në një perspektivë të tillë lind nevoja që të punohet për krijimin paraprakisht të një qendre të tillë në Tetovë, në mënyrë që të bëhet e mundshme realizimi i një network-u me qendra në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë.

Realizimi i një Network-u mbarëshqiptar të Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës është edhe në logjikën e masave komplekse që ndihmojnë procesin e stabilizimit mbarëballkanik, që përbën pikësynimin kryesor të përpjekjeve të

mbarë komunitetit euroatlantik për realizimin e Paktit të Stabilitetit për Ballkanin. Është tashmë i njëpërmend fakti se nuk mund të ketë qëndrueshmëri sociale, politike dhe ekonomike në vendet e gadishullit ballkanik nëse nuk realizohet edhe rehabilitimi e integrimi social i grupeve të marginalizuar të mbijetuarve nga tortura në këto vende. Nëse nuk do të kapërcehet marginalizimi i këtyre grupeve, ato fare lehtë do të mund të kthehen në vatra gjeneruese të konfliktit shoqëror. Luftrat me bazë etnike në ish Jugosllavi dëshmojnë më së miri për këtë gjë.

Pritmëritë nga Workshop-i

Ajo që pritet si rezultat kryesor është:

- Rënia dakort dhe pleqërimi i rrugëve për të mundësuar hapjen e Qendrës së Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës në Tetovë.
- Rezultat i dytë i pritshëm është debati lidhur me modalitetet për ngritjen e një Network-u mbarëshqiptar të qendrave të tilla rehabilituese me pikëmbështetje në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë.
- Përpunimi i një strategjie të përbashkët të punës rehabilituese dhe të avokatësisë në të mirë të të mbijetuarve të torturës dhe për shmangien e shfaqjes së rasteve të reja të torturës në kuadrin e Network-ut mbarëshqiptar.

Zhvillimi i punimeve

Nga referimet dhe diskutimet u argumentua prezenca e pasojave të shumta të një traume kolektive në hapësirat mbarëshqiptare të shkakuar historikisht nga faktorë të ndryshëm (dhunë, shtypje politike me bazë ideologjike etj.)

Në mënyrë të veçantë u trajtuan pasojat e traumave të viteve të fundit, përballimi i tyre dhe parandalimi i traumave të reja.

Nga referimet dhe diskutimet rezultoi se:

1) *Në Kosovë janë probleme të mprehta:*

- Preokupimi dhe shqetësimi më i madh i të gjithë pjesëmarrësve të Workshop-it ishte lirimi i menjëhershëm i pengjeve dhe të burgosurve shqiptarë që mbahen ende në burgjet serbe.
- Numri shumë i madh i traumave të jashtëzakonshme të ndodhura në një kohë të afërt.
- Vakumi ligjor për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës të viteve '90 dhe më parë.
- Prevenimi i dhunës dhe traumave të reja.

2) *Në Maqedoni:*

- Nuk është dhënë pafajësi për ish të dënuarit e ndërgjegjës.

- Ka mungesë të interesimit nga shteti dhe organizma ndërkombëtare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës.
- Ka shkelje e të drejtave të njeriut dhe lirive nga legjislativi dhe ekzekutivi.
- Në burgje ka të dënuar të ndërgjegjës.

3) Në Shqipëri:

- Akoma nuk është realizuar një rehabilitim dhe integrim real i ish të përndjekurve politikë.
- Qëndrimi i sotëm i shtetit dhe një pjese të shoqërisë ndaj të kaluarës komuniste dhe pasojave të saj gjeneron ngarkesa psikologjike në komunitetin e ish të përndjekurve politikë.

Nga të gjithë diskutuesit krijimi i Network-ut Tiranë, Prishtinë, Tetovë u vlerësua si rruga më e mirë për përballimin e pasojave të traumës dhe parandalimit të tyre dhe se ky Network do ta bëjë më eficiente punën e këtyre tre qendrave, bashkëpunimin me RCT, BAN-in. Network-u Tiranë, Prishtinë, Tetovë në kuadrin e objektivave të Paktit të Stabilitetit Ballkanik do të jepte një ndihmesë për stabilitetin në këto vende dhe rajon.

Në diskutime u trajtuan hartimi i një strategjie të përbashkët për ndihmesën e drejtëpërdrejtë për lehtësimin e vuajtjeve të mbijetuarve nga tortura, për të zhvilluar avokatsi sociale në të mirë të kësaj shtrese dhe për të sensibilizuar shoqërinë për nevojën e ndërmarrjes së masave efikase për parandalimin e shfaqjes së rasteve të reja të ushtrimit të dhunës nga shteti, grupe jo shtetërore ose individë.

U shfaqën mjaft mendime për mundësitë dhe modalitetet e kthimit të Departamentit të Rehabilitimit të Forumit të Drejtave të Njeriut Maqedoni- Gostivar në qendër reabilitimi dhe të krijimit të Network-ut të qendrave të reabilitimit Tiranë, Prishtinë, Tetovë. Mendimi i përgjithshëm ishte se realizimi i tyre duhet të jetë objektivi kryesor i bashkëpunimit të të tre qendrave.

Pakti i Stabilitetit Ballkanik në Workshop-in u vlerësua si një shans për realizimin e objektivave të qendrave dhe ato duhet të sensibilizojnë organizmat përkatëse për rëndësinë e reabilitim-integrimit të të mbijetuarve të torturës dhe ish të përndjekurve politikë në arritjen e stabilitetit të vendeve dhe të rajonit.

Vendime

1) T'u drejtohet organizmave ndërkombëtare një thirrje për lirimin e pengjeve dhe të burgosurve të mbajtur në burgjet serbe.

2) Të vazhdojë bashkëpunimi i tre qendrave:

- Në realizimin e objektivave të tyre, dhe zgjidhjen e problemeve shqetësuese, në mënyrë të vecantë të lehtësimit të vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës dhe të dënuarve të ndërgjegjës.
- Në konstituimin e Qendrës së Rehabilitimit të Tetovës dhe Network-ut Tiranë- Prishtinë- Tetovë.

-Në realizim të projekteve të vecanta dhe të përbashkëta jashtë dhe brenda kuadrit të Paktit të Stabilitetit dhe BAN-it.

3) T'i propozohet Presidentit të Republikës dekorimi i znj. Berit Backer në shenjë mirënjohjeje për kontributin e saj për shoqërinë shqiptare.

LISTA E PJESËMARRËSVE

Shqipëri

1. **Marenglen Spiro**, Rektor i Universitetit të Tiranës.
2. **Adem Tamo**, Prof.Dr. në Universitetin e Tiranës.
3. **Fatmira Rama**, Prof.As.Dr. në Universitetin e Tiranës.
4. **Afërdita Onuzi**, Drejtoreshë e Institutit të Kulturës Popullore.
5. **Niazi Jaho**, Jurist i Komitetit Shqiptar të Helsinkit
6. **Kozara Kati**, Drejtoreshë e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut dhe Kryetare e tryezës së Demokracisë të Komisionit Parlamentar për Paktin e Stabilitetit.
7. **Kino Buxheli**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
8. **Luan Kroj**, Drejtor Drejtorie në Institutin e Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë.
9. **Tanush Mulleti**, Sekretar i Përgj. Shoqatës Kombëtare të Ish të Dënuarve dhe Persekutuarve Politikë të Shqipërisë.
10. **Tomorr Aliko**, Kryetar i Shoqatës Antikomuniste të Ish të Përndjekurve Politikë Demokratë.
11. **Lili Ndoci**, Sekretare e Përgj. e Shoqatës Antikomuniste të Ish të Përndjekurve Politikë Demokratë.
12. **Uran Kalakula**, Shkrimtar dhe studiues, ish i përndjekur politik.
13. **Adrian Kati**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
14. **Tue Magnussen**, Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT, Kopenhagen.
15. **Dragush Totozani**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
16. **Ariel Çomo**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
17. **Bardhyl Belishova**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
18. **Delisa Uruçi**, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.

Kosova

1. **Feride Rushiti**, Drejtore e Qendrës Kosovare të Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës.
2. **Arif Birinxhiku**, Neuropsikiatër, Prishtinë.
3. **Arsim Bajrami**, Prof.Dr.Universiteti i Prishtinës.
4. **Adem Hasani**, Kryetar i Institutit Shqiptar për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë.

Tetovë, Maqedoni

1. **Prof. Milaim Fejziu**, Universiteti i Tetovës.Kryetar i Senatit, Universiteti i Tetovës.
2. **Dr. Shaban Memeti**, Tetovë.
3. **Xhevat Ademi**, Shoqata e Ish të Përndjekurve Politikë, Maqedoni.
4. **Dr.Kastriot Haxhirexha**, Deputet në Parlamentin e Maqedonisë

ARDIAN KATI

FJALA E HAPJES NË WORKSHOP-IN E PARË RAJONAL

Të nderuar miq, të ftuar pjesëmarrës në këtë takim pune, mirë se keni ardhur! Në mënyrë të veçantë përshëndesim miqtë tanë të ardhur nga Prishtina dhe Tetova.

Do të doja të hapnim punimet e këtij workshopi duke nderuar viktimat e torturës kudo në botë me një minutë heshtje.

Jemi mbledhur së bashku, këtu në Tiranë, për të shkëmbyer mendime dhe përvoja lidhur me punën tonë fisnike për të lehtësuar dhimbjet e për të rehabilituar të mbijetuarit nga tortura. Në përputhje me nevojat për një punë të përbashkët midis qendrave të Tiranës, Prishtinës, dhe departamentit përkatës në Tetovë, kemi menduar që të koordinojmë punën në mënyrë që të ndihmojmë këtë departament të ngrihet në nivelin e një qendre dhe kësaj të mund të krijojmë një lidhje koordinuese të bashkëpunimit midis tyre. Ne e kemi emërtuar atë Network-u Rajonal Mbarëshqiptar i Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura. Ndoshta ky emërtim nuk është shumë i goditur dhe nuk i përgjigjet si duhet pikësnyimeve tona, por mendoj se nuk është kjo gjëja më kryesore. Ne dëshirojmë të ecim përpara dhe të zhvillohemi nga pikëpamja institucionale, duke rritur kapacitetet në funksion të realizimit sa më të mirë të misionit tonë fisnik.

Jemi të mendimit se e gjithë kjo punë që do të bëjmë së bashku në këtë workshop është në logjikën e punës sonë, përfshirë këtu edhe atë në kuadrin e Network-ut Ballkanik si dhe të veprimtarisë ndërkombëtare për të realizuar stabilitetin në gadishullin ballkanik.

Ne shpresojmë që në këtë punë do të kemi mirëkuptimin dhe ndihmën e të gjithë miqve dhe kolegëve tanë, në veçanti të atyre të rrjeteve të Qendrave të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës. Gjithashtu, duam të përshëndesim Z. Nufri Lekaj nga Kosova, një nga ideatorët e këtij bashkëpunimi.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për veprën e Znj. Berit Backer në shërbim të kulturës shqiptare dhe në ndihmë të ish të përndjekurve politikë.

Në emër të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës, ju falenderoj edhe njëherë për pjesëmarrjen tuaj dhe shpallim të hapur këtë workshop dhe i uroj atij punime të mbara!

TUE MAGNUSSEN

NJË PËRMBLEDHJE E FJALIMIT TË TIJ NË WORKSHOP-IN RAJONAL

Do të dëshiroja të shprehja, falenderimet e mia për ARCT-në si organizuese e workshop-it rajonal e që më dha mundësinë për të prezantuar strategjinë dhe vizionin e Qendrës Daneze të Kërkimeve dhe të Rehabilitimit për Viktimat e Torturës, ku unë punoj si koordinator për Ballkanin dhe Lindjen e Mesme. Së pari do të filloja me një përkufizim të shkurtër, për dhunën e organizuar dhe torturën.

Unë do të jap një përkufizim të dhunës së organizuar, përkufizim i nxjerrë nga Organizata Botërore e Shëndetit.

Dhuna e organizuar është shkaktimi i dhimbjeve të pashmangshme dhe e vuajtjeve të ushtruara nga ana e një grupi të organizuar sipas një strategjie të ligjësuar ose jo të ligjësuar sipas një sistemi idesh dhe qëndrimesh. Ajo përfshin çdo veprim të dhunshëm që bie ndesh me standartet e përgjithshme njerëzore dhe që lidhet drejtëpërsëdrejti me ndjenjat e të mbijetuarve. Dhuna e organizuar përfshin, në pjesën më të madhe, “torturën”, trajtim çnjerëzor ose degradues dhe ose ndëshkim, siç përmendet në Nenin 5 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara (1948). Dhuna që ushtrohet në këto situata të ngjashme, si pasojë e drejtëpërdrejtë e shtypjes politike, edhe pse mund të shfaqet e rastësishme, është e një natyre strukturale dhe përfshin dhunimin e të drejtave themelore të njerëzve dhe mund të zhduket vetëm kur ndryshojnë thellësisht marrëdhëniet sociale dhe politike njerëzore.

Sipas konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës mund të jepet ky përkufizim për torturën:

Torturë do të thotë çdo akt që shkakton dhimbje dhe vuajtje fizike dhe mendore që ushtrohet tek një njeri për qëllime të tilla si, nxjerrja prej tij ose prej një personi të tretë informacione ose rrëfime, ta dënosh për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet të ketë kryer, ta kërcënoh ose ta detyrosh atë ose një person të tretë, ose edhe për ndonjë arsye tjetër si shkak i çdo lloj diskriminimi , kur një dhimbje e tillë është shkaktuar ose nxitur nga prania e një publiku zyrtar ose të një personi tjetër që vepron me një funksion zyrtar.

(Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe formave të tjera të dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, Neni 1, viti 1984).

Këtu gjejmë ngjashmëri ndërmjet torturës dhe dhunës së organizuar: natyra e torturës dhe dhunës së organizuar është e njëjtë (shkaktim i dhimbjeve ose vuajtjeve të thella). Si shenjat e torturës dhe të dhunës së organizuar tek të mbijetuarit e torturës shpesh janë të njëjta (pasoja fizike, mendore dhe shoqërore).

Megjithatë ka edhe dallime ndërmjet torturës dhe dhunës së organizuar: ushtruesit e torturës përfshijnë persona që veprojnë në bazë të një pushteti zyrtar (agjentë të shtetit).

Ushtruesit e dhunës së organizuar përbëjnë një grup më të gjerë dhe më pak të përcaktuar, grup i përbërë nga figurat e shtetit ose jo, si psh. grupet kundërshtarë të armatosura.

RCT

Në prezantimin tim do të mbështetem në publikimin “RCT në një botë në zhvillim”. Ky është një dokument i politikës së RCT-së. Ajo pasqyron kuadrin e politikës së organizatës dhe fokusin e zhvillimit të saj.

Tani po bëj një hyrje të shkurtër të përvojës së RCT-së, themeluar në 1982, RCT renditet ndër të parat organizata joqeveritare kundër torturës. RCT filloi punën e saj si një organizatë e profesionistëve të shëndetit , të përkushtuar për të lehtësuar pasojat e torturës tek individët të cilët kanë vuajtur torturën dmth të mbijetuarit e torturës.

RCT ka fokusuar përpjekjet e saj në lehtësimin e vuajtjeve të të mbijetuarve të torturës përmes trajtimit multidisiplinar dhe me qëllimin kryesor, atë të ndihmës mjekësore. Në fillimet e saj RCT u angazhua në rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës që jetonin si rrefugjatë në Danimarkë. RCT nuhati shpejt nevojën akute për të shtrirë punën e saj në ndihmë të të mbijetuarve të torturës që jetonin jashtë. Njëkohësisht me punën e saj në Danimarkë , RCT u përpoq të lehtësonte mundësitë e rehabilitimit të të mbijetuarve të torturës në vendet e tyre të origjinës. Kjo nismë ndërkombëtare çoi në krijimin e një numri qendrash trajtimi në Azi, Amerikën Latine, Afrikë.

Sot, RCT është pjesë e network-ut ndërkombëtar të organizatave të të drejtave të njeriut dhe të lëvizjeve sociale që punojnë kundër torturës dhe formave të tjera të dhunës. Së pari, RCT u angazhua në luftën kundër torturës e parë kjo nga një perspektivë kuruese dhe shëndetësore.

Tashmë globalizimi dhe ekonomia e fuqishme e tregut të lirë , rastet e reja të konfliktit midis dhe ndërmjet popujve , traumatizimi në masë i popullsisë të varfra dhe të shtypura, si dhe lindja e grupeve të reja persekutuesish (atyre që ushtrojnë dhunë) : veprimtaritë joqeveritare kanë nxitur RCT-në të ridrejtojë dhe të zgjerojë qëllimin e saj.

Këta faktorë si dhe eksperiencia e fituar nga puna në fushën e shëndetit mendor dhe në atë të të drejtave të njeriut për disa vite ka çuar në ndryshimin e politikës së RCT-së:

- Duke u shpërqëndruar nga tortura e sanksionuar nga qeveritë në torturën dhe format e tjera të dhunës së organizuar nga qeveritë dhe veprimtarët jo shtetërore.
- Nga një perspektivë kryesisht humanitare në një perspektivë të orientuar drejt zhvillimit dhe të drejtave të njeriut.
- Nga përqëndrimi kryesisht mbi pasojat e torturës, në atë të shkaqeve dhe pasojave të torturës dhe dhunës së organizuar.
- Nga trajtimi kryesisht individual dhe në familje, në një përqëndrim më të madh dhe më të fuqizuar mbi komunitetin.
- Drejtimi nga aktiviteti kundërveprues, në atë veprues, pjesëmarrës e në përpjekje për të arritur qëllimin.

Vizioni i përgjithshëm i RCT-së

Vizioni i përgjithshëm i RCT-së është një botë pa tortura dhe forma të tjera të dhunës së organizuar.

Duke u nisur nga angazhimi i RCT-së për respektimin e të drejtave universale të njeriut dhe të lirive themelore si dhe bazuar mbi njohjen e dinjitetit të natyrshëm të të gjitha qenieve njerëzore, RCT merr përsipër si mision të saj :

- Të kontribojë në lehtësimin e vuajtjeve njerëzore të pasojave të torturës dhe formave të tjera të dhunës së organizuar si në nivelin individual ashtu edhe në nivelin e komunitetit, të rehabilitojë të mbijetuarit dhe komunitetin e tyre për tu bërë faktorë ndryshimi për përmirësimin e jetës së tyre si dhe të kontribojë në zhvillimin e njerëzimit.
- Të kontribojë për parandalimin e ushtrimit të torturës dhe formave të tjera të dhunës së organizuar duke shqyrtuar shkaqet themelore të cilat çojnë në vuajtjen njerëzore si dhe duke krijuar kushtet e nevojshme në nivelin social për respektimin e të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor.

Vlerat e përgjithshme të RCT-së

Në përmbushjen e misionit të saj RCT dëshiron të ndryshojë sjelljet dhe qëndrimet njerëzore, shoqërore dhe politike. Ajo udhëhiqet nga vlerat themelore të saj të cilat janë: dhembshuria dhe respekti për dinjitetin e brendshëm, integritetin fizik dhe mendor të të gjitha qënieve njerëzore.

- ❖ Respektimi i të drejtave universale të njeriut dhe i lirive themelore të të gjithë personave pa dallime, ashtu siç është parashikuar në deklaratën universale të të drejtave të njeriut si dhe në të tjera akte të njohura për të drejtat e njeriut.
- ❖ Solidariteti dhe përgjegjësia e përbashkët e të gjitha qënieve njerëzore në luftën kundër torturës dhe formave të tjera të dhunës së organizuar.
- ❖ Dialogu dhe zgjidhja jo me dhunë e konflikteve si mënyra e vetme dhe më e përshtatshme për të ndryshuar marrëdhëniet njerëzore shoqërore dhe politike
- ❖ Dënimi sipas ligjit i personave që kryejnë krime.
- ❖ Bashkëjetesë paqësore dhe pajtim kombëtar.
- ❖ Trajtimi i të mbijetuarve të torturës pa dallim race, ngjyre , besimi fetar. Pa marrë parasysh të kaluarën kombëtare, etnike ose sociale, preferencat politike, dallimet ose preferencat gjinore.
- ❖ Zhvillimi i besimit në vetvete përmes afrimit me komunitetin.
- ❖ Standartet e larta të profesionalizmit në punë.

Kur marrin përsipër detyrat e tyre si profesionistë të shëndetit, personeli i RCT duhet të respektojë gjithmonë kodet etike në lidhje me punën e profesionistëve në fushën e shëndetit, në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu kodet etike dhe deklaratat e miratuara nga shoqatat përkatëse profesionale.

Kodi etik i zbatuar në punën e profesionistëve në fushën e shëndetit mendor përveç të tjerave përfshin:

- Ruajtjen e standarteve më të larta të punës dhe praktikës profesionale me ndërgjegje dhe dinjitet njerëzor.
- Përkushtimin për të siguruar shërbime cilësore në pavarësi të plotë dhe me përkushtim dhe respekt për dinjitetin njerëzor.

- Ndalimin e përfitimit që ndikojnë në ushtrimin e lirë dhe të pavarur të profesionit dhe trajtimit të të mbijetuarve të torturës.
- Respektimin e të drejtave dhe integritetit të të mbijetuarve të torturës dhe familjarëve të tyre ashtu si edhe e konfidencave të tyre.
- Përpjekjen për të nxitur respektimin e zbatimit të kodeve etike dhe deklaratave, përfshirë këtu edhe Parimet e Etikës Mjekësore (1982).

Brenda partneritetit midis RCT dhe NGO-ve kombëtare ose lëvizjeve popullore, RCT i jep përparësi për ndërhyrje target grupeve të mëposhtëme:

Target grupi bazë për trajtimin, përbalimin dhe rehabilitimin përbëhet nga individët, të afërmit e tyre dhe komuniteti të cilët vuajnë pasojat e torturës dhe formavet të tjera të dhunës së organizuar. Puna e target grupit është e lidhur me mënyrën se si e percepton vetë situatën e tij, burimet vetjake dhe nevojën për ndihmë dhe përkrahje. Një tjetër target grup është ai i fëmijëve, adoleshentët, burrave dhe grave me dhimbje fizike dhe shqetësime nervore dhe atyre që kanë përjetuar përvojën e humbjes gjë që ka ulur kapacitetin e tyre për të punuar, si dhe për të hyrë në marrëdhënie emocionale.

Objekti për aftësimin institucional brenda zonës së trajtimit mund të përfshijë profesionistë në fushën e shëndetit, në sistemet publike dhe private të shëndetit, të sapo diplomuarit ose ata që presin të diplomohen, ndihmës mjekë dhe mjekët popullorë, si dhe vullnetarë të ndihmës së parë.

Objekt për parandalimin e torturës janë hartuesit e politikave si dhe strukturat shtypëse të shtetit, si autoritetet ligjvënëse, ekzekutive dhe juridike. Brenda institucionit ekzekutiv, RCT ka si objekt policët, personelin e burgjeve, grupet ushtarake dhe paraushtarake që dhunojnë të drejtat e njeriut. Në institucionet juridike, RCT ka si objekt prokurorët dhe avokatët mbrojtës të përfshirë në çështjet e të drejtave të njeriut. Objekt për të parandaluar dhunën e organizuar janë forcat e armatosura dhe grupet e organizuara jo shtetërore. Grupet e organizuara jo shtetërore mund të përfshijnë grupe kundërshtarë politike, grupe fetare fundamentaliste, revolucionare ose guerile, grupe multietnike, mercenarësh, pronarë të mëdhenj tokash, trafikantë armësh, grupe racistësh dhe të krimit të organizuar si psh. trafikantë armësh dhe mafia.

Së fundi, target grupet për politikën ndërgjegjësuëse dhe parandaluese janë NGO-të progresive, organizatat bazë dhe popullore, mësuesit, edukatorët dhe të tjerë profesionistë që kanë njohuritë e duhura për ndërgjegjësimin e shoqërisë civile. RCT është përfshirë në rrugën e zhvillimit, që synon të zgjerojë fushën e përzgjedhjeve të njeriut, duke filluar që nga liritë politike, ekonomike dhe sociale deri tek mundësitë për krijimtari dhe produktivitet për rritjen e respektit personal dhe për garantimin e të drejtave të njeriut.

Refuzimi i qeverive për tu marrë me pasojat fizike dhe mendore të dhunës si dhe me mjetet dhe mënyrat për ti parandaluar ato duhet të shihen dhe kuptohen si shembuj me rëndësi të thella të sjelljeve dhe strukturave shtypëse social politike, që mund dhe duhen rishikuar. Rrjedhimisht ndërhyrjet afatgjata kërkojnë të arrihet një ndikim afatgjatë e që ka të bëjë me ndryshimin e sjelljes si dhe praktikën e qeverive kombëtare dhe mbështetësve të tjerë kombëtare.

Duke u mbështetur në analizat e problemeve të vendit, në vlerësimet e rrezikut si dhe në avantazhet relative të partnerit, misioni i RCT-së është të zhvillojë kapacitetin teknik dhe intelektual si dhe mbështetje të mëtejshme për shoqërinë civile dhe strukturat qeveritare brenda këtyre fushave:

- Ngritja në nivel kombëtar të kapaciteteve për të rritur njohuritë, për të ndryshuar qëndrimet dhe praktikat brenda qeverive kombëtare dhe institucioneve shëndetësore, dhe brenda strukturave qeveritare dhe joqeveritare për të mundësuar trajtimin adekuat të nevojave psikosociale dhe fizike të të mbijetuarve të torturës dhe formave të tjera të dhunës së organizuar.
- Fuqizimin e komunitetit për të çuar përpara proceset e mëkëmbjes së tij, të rehabilitimit social të të mbijetuarve si fshatarë të varfër, banorë të lagjeve të varfëra të periferisë, indigjenë dhe komunitetet e marginalizuara, për të fituar kontroll dhe zotërim të çështjeve që shqetësojnë jetën e tyre dhe që mund të ndihmojnë ata në përfshirjen për parandalimin dhe ndryshimin e padrejtësive.

Prof. As.Dr. FATMIRA RAMA

**RETROSPEKTIVË E PËRNDJEKJES NACIONALE NDAJ SHQIPTARËVE
DHE INTEGRIMI BALLKANIK**

Një Botë dhe Rajon Mbinacional dhe Infracionale.

Refleksione

Në të gjitha organizmat ndërkombëtare, evropiane dhe më tej, në konferenca dhe tryeza të rumbullakëta me karakter politik, kulturor, historik, arsimor etj, shtrohet çështja e parashtrimit ndryshe të historisë, duke hequr dorë nga trajtesat nacionaliste, me ngarkesa shoviniste nga edukimi me të pavërteta dhe urrejtje etnike të brezit të ri, për të vështruar drejt një realiteti tjetër, drejt bashkëpunimit evropian e më tej.

Sidomos kjo paraqitet si detyrë imperative në zonën e Ballkanit, ku mbas një sërë tragjedi dhe mizorive me baza shoviniste, etnike, të njëpasnjëshme, është hedhur në tavolinë integrimi ballkanik, Pakti i Stabilitetit, të mirëpritura nga të gjithë popujt e Rajonit.

Me kohë, kryesisht që nga mesi i shekullit të XX-të, specialistë të shquar, të thelluar në probleme të nacionalizimit, të krijimit dhe funksionimit të shteteve-kombe a multietnike, konstatojnë se pavarësisht nga “roli ende i privilegjuar i nacionalizmit” ai, “është bërë historikisht më pak i rëndësishëm, se historia e shekullit të XX –të, do të duhej të shkruhej patjetër si historia e një bote, “që nuk mund të mbahet më brenda caqeve të”kombit” dhe të “shtetit komb”, më së shumti do të jetë mbinacionale dhe infranacionale”.¹⁾

Në këtë kontekst lindin pyetje të shumta, aq më tepër në analogji me ngjarjet e fundit në Ballkan a gjetkë. Sa do të zgjasë kjo epokë tranzitive? Cilat do të jenë raportet mes shteteve sovraane, globalizmit dhe krijimit të strukturave të përbashkëta rajonale, evropiane dhe botërore? Si do të trajtohen problemet etnike të mbartura nga e kaluara dhe si duhet të mbrohem nga rreziqe të reja të spastrimeve etnike? Aq më tepër, kur të gjithë janë të ndërgjegjshëm, se “megjithëse kjo epokë ka nisur, ” do të ishte absurde të thuhet se kjo ditë është e afërt”.²⁾

Këto pyetje kemi të drejtë t'i shtrojmë, kur, në kundërshtim me sa mendohej, mbas Luftës së Ftohtë, kudo, më së shumti në Ballkan, u rizgjuan frikshëm shfaqjet e shovinizmit agresiv, të ksenofobisë, të urrejtjes etnike, që shkaktuan vitet e fundit përpara syve tanë mijëra viktima, spastrime etnike në masë, tortura etj, të pabesueshme pak vite më parë. Me shpërbërjen e Jugosllavisë, ngjarjet që nisen në Slloveni, të shndërruara në një konflikt më të gjerë, duke përfshirë Kroacinë, që nga marsi i vitit 1992 dhe Bosnjën e Hercegovinën, për të kaluar më pas si një tufan i vërtetë në Kosovë, në pranverë të 1999, jo vetëm tronditën të gjithë, por çuan në refleksione të reja të njohjes së shkaqeve të krizave të tilla dhe të menaxhimit të tyre në shkallë ndërkombëtare dhe rajonale. Aq më tepër kur u vërejtën ndërthurje dhe përplasje të kontradiktave dhe civilizimeve të ndryshme në Ballkan, kur dhe shtete të tjerë përkrahën fillimisht planet serbe për një sërë faktorësh, mbajtën qëndrime të dyzuara ndaj ndërhyrjes së Komunitetit Ndërkombëtar në Kosovë, dhe ku manifestohen në mënyrë të dukshme shfaqje të ksenofobisë ndaj të huajve³⁾.

Në këto zhvillime të reja, personalitete të shquar ndërkombëtare, të fushës së shkencës, diplomacisë, politikës etj, anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar për të shqyrtuar krizën në Ballkan, së bashku me Fondacionin Karnegi të Paqes në Botë (themeluar në Washington D.C që në vitin 1910), do të nxirrin konkluzione të rëndësishme. Në vitin 1995 ata do të vërenin ngjashmëri të habitshme në Ballkanin e mesit të viteve 90-të të

këtij shekulli, me fillimet e shekullit, mbas luftave ballkanike. Në atë periudhë, Komisioni i parë ndërkombëtar për Ballkanin, Karnegi, në vitin 1914, do të theksonte se "fasada e qytetërimit është vërtetë e dobët", se "shpërthimi i papërmbajtur i kafshës njerëzore është gjithnjë i mundshëm", "kur aktet e dhunës e shndërrojnë patriotizmin në krim dhe heroin në përbindësh". Në studimin e Dytë për Ballkanin, në librin "Paqe e papërfunduar", autorët në referime me këto vërejtje do të nënvizionin se bota tashmë u ballafaqua me të vërtetën e hidhur, se "nuk ishte vetëm përdorimi i mizorisë, por vete ideja e "spastrimit etnik", si parim organizues i shtetit dhe i shoqërisë, që sfidoi në fund të shekullit të XX-të, vlerat themelore të demokracisë pluraliste në të dy anët e Atlantikut"⁴.

Ky konkluzion u vërtetua edhe njëherë në konfliktin e fundit në Kosovë, ku rreth 700000 shqiptarë kosovarë u detyruan të shpërngulen me forcë nga trojet e tyre dhe e gjithë popullsia iu nënshtua një persekutimi ndër më të egrit etnik nga forcat ushtarake dhe civile serbe, të ndjekura me tmerr nga miliona shikues në mbarë botën.

Ndër këto ngjarje e spastrime etnike gjatë një shekulli të tërë është kërkuar angazhimi më i madh i komunitetit ndërkombëtar, ndjekja e një politike afatgjatë e Fuqive të Mëdha dhe jo thjesht, rezultat i kompromiseve afatshkurtra, distancimi i hapur ndaj politikave shoviniste e ksenofobe të kujtdo shteti, respektimi i parimit të vetëvendosjes së popujve, në harmoni me normat dhe kartat ndërkombëtare, ndërhyrja në kohën e duhur për zgjidhjen e krizave etnike kudo në botë etj. Me gjithë situatën tejet të ndërlikuar që shoqëron këto kërkesa të drejta të popujve, realitetin e politikës botërore, diskutimet dhe qëndrimet aprovuase dhe dizaprovuase etj, mendojmë se ndërhyrja ndërkombëtare në Rajon, në pranverë 1999, në thelb shënon një hap, që përpiket pikërisht të vendosë ekuilibrin e duhura të respektimit të të drejtave kombëtare të popujve, distancimit nga çdo lloj shovinizmi dhe spastrimi etnik dhe zhvillimeve integruase rajonale dhe botërore. Me këtë hap tashmë termi "komunitet ndërkombëtar" nuk është më thjesht një "eufemizëm", a "entitet i imagjinuar" dhe sidoqoftë, shovinizmi dhe nacionalizmi agresiv në Ballkan ka pësuar një goditje të rëndë dhe është tulatur.

Mbi përndjekjen nacionale ndaj shqiptarëve

Shfaqjet shoviniste, përndjekjet nacionale në rajonin e Ballkanit, sidomos në kuadrin e krijimit të shteteve nacionale, që nga fillimi i shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme, kanë bërë të vuajnë në mënyrë sistematike të gjithë popujt e Ballkanit. Por, për një sërë rrethanash historike, është viktimizuar më së shumti pikërisht popullsia shqiptare. Pa dashur të bëjmë interpretime të gjata historike, është i njohur fakti, që nacionalizmi shqiptar u zhvillua në një periudhë më të vonshme historike, ç'ka çoi në krijimin e shtetit shqiptar, në fillim të shekullit të 20^{te}, kur ndërkohë shtetet fqinje, kishin disa dekada që e kishin formësuar atë.

Në këto rrjedha në Ballkan ndodhi fenomeni i këmbimit të roleve, kur grupi etnik A, ngre çështjen e vetëvendosjes, duke kërkuar pavarësinë nga grupi B, por, nga ana tjetër, ia refuzuan atë grupit etnik C, çdo herë në emër të "mbijetesës kombëtare"⁵. Jo rastësisht, por në rrjedhën e fillimit të politikave ekspansioniste të shteteve të rinj, Serbi dhe Greqi, pikërisht në të njëjtin vit, 1844, u formuluan platformat shoviniste serbe të "Megali Idesë"(Idea e Madhe) dhe e "Nacertanias"(Projekt), përkatësisht nga

Kryeministri grek J. Koleti dhe nga ministri i jashtëm i Serbisë I. Garashanini. Ata synonin t'a shndërronin Serbinë në një shtet me kufijtë e Perandorisë mesjetare të Stefan Dushanit, dhe Greqinë në një shtet të madh me kryeqytet Stambollin, si trashëgimtare të Bizantit.⁶⁾

Me këto platforma kërcënoheshin tokat e popujve të tjerë, sidomos ato shqiptare, dhe “të shtypurit e djeshëm”, kaluan në “shtypësit e rinj”, nga frika se mos ktheheshin në të shtypurit nesër.

Shqipëtarët u ndodhën në këtë kontekst përballë lakmisë së fqinjëve. Pozicioni i tyre gjeografik, ndër të tjera, ishte gjithnjë i lakmueshëm, për nxitjen e orekseve ekspansioniste, aq më tepër të Serbisë, për realizimin e aspiratës së saj shekullore të daljes në det. Nga ana tjetër Shqipëria e islamizuar në shumicë, ishte e ndryshme nga rajonet e krishtera të Greqisë, Serbisë, dhe Malit të Zi, që çoi në aleancën e shteteve ortodokse kundër saj. Shqipëria, e në veçanti Kosova, u konsiderua si pjesë e Turqisë në Evropë, identiteti shqiptar mohohej, ndërsa territoret shqiptare pas rënies së Perandorisë Osmane, u trajtuan si pasuri vakante e pa zot.⁷⁾

Në këto rrethana popullsia shqiptare, sidomos me Kongresin e Berlinit, qershor 1878, Konferencën e Londrës, 1912-1913, me vendimet mbas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, ku nuk u zbatuan parimet etnike dhe të vetëvendosjes për popullin shqiptar, përjetoi copëtimet territoriale më të mëdha ndër popujt e Ballkanit. Trojet shqiptare ndodhen të pjestuara midis pesë shteteve të Gadishullit Ballkanik, nga të cilët vetëm gjysma bën pjesë në shtetin e tyre kombëtar. Midis tyre ndodhet krahina e Kosovës, me një popullsi prej 2 milion banorësh, tashmë nën qeverisjen ndërkombëtare të OKB, por që sipas Rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që i dha fund fushatës së bombardimit të Natos, vitin e kaluar, është ende de jure, pjesë e Jugosllavisë. Vise të tjera shqiptare ndodhen në shtetet e Maqedonisë, të Malit të Zi, dhe të Greqisë.

Me copëtimet territoriale të njëpasnjëshme popullsia shqiptare ka përjetuar gjatë më shumë se një shekulli një kalvar të gjatë vuajtjesh, persekutimesh, torturash, spastrimesh etnike, shpronësimesh masive etj, që kanë përfshirë qindra mijëra shqiptarë, kryesisht ata të mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar, dhe në etapa të caktuara historike, edhe ata brenda kufijve, sidomos në skajet veriore dhe jugore të tij.

“Nacertania” dhe “Megali Ideja”, si programe politike të ekspanisoneve territoriale, ishin skenare të parë të luftërave të ardhshme dhe sipas një sërë analistëve, “spastrimi etnik”, nuk ishte kështu veçse një nga mjetet e përdorura për të realizuar këto programe dhe për të realizuar shtete “homogjene dhe të pastër”. “Spastrimi etnik”, si instrument i një ideologjie vrastare, i ushtruar shumë herë mbi shqiptarët dhe popujt të tjerë, ka konsistuar shumë herë efikas. Në fillim copëtimi i territorëve, pastaj “spastrimi etnik”, duke ndjekur politikën e faktit të kryer, duke llogaritur me cinizëm indiferencën e lidereve politike të shteteve të tjerë dhe kujtesën, shpesh herë të shkurtër, të opinioneve të tyre publike.

Në vazhden e “Nacertanias”, shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera në Jugosllavi u ndodhën përballë programeve dhe platformave të tjera shoviniste serbe, për shkombëtarizimin e tyre dhe “purifikimin” e trojeve shqiptare. Mund të kujtojmë Reformën Agrare në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene, të vitit 1919, reformë e një tipi special për shqiptarët, që çoi në spastrime etnike dhe eksode masive të tyre ose elaboratin e Vaso Cubrilloviçit, titulluar “Dëbimi i Shqiptarëve”, paraqitur në Klubin Kulturor Serb në 7 mars 1937. Në vazhden e gjithë politikave dhe programeve shtetërore anti-shqiptare,

ai përbën “një nga kulmet e ideologjisë së spastrimit etnik”. Aty jepen pikërisht këshilla dhe receta të veçanta mbi mënyrat e serbizimit, kryesisht në Kosovë dhe në Metohi, duke propozuar një arsenal komplet të represionit të dëbimit, të teknikave dhe të masave, në kuadrin e intolerancës nacionale të ngritur në rang të një misioni të shenjtë të shtetit serb. Ai propozonte në mënyrë të detyruar zbatimin e sistemit hitlerian dhe stalinist të dëbimit të popullsisë. “Opiniononi ndërkombëtar, -vërente Cubriloviçi, - do të jetë pak i alarmuar, pasi kur Gjermania mundi të dëbojë dhjetra mijë çifutë dhe Rusia transplaton miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit në tjetrën, transferimi i disa qindra mijëra shqiptarëve, nuk do të çojë në shpërthimin e një lufte botërore.⁸⁾

Krahas instruksioneve të qarta të spastrimit etnik të shqiptarëve dhe të vëna në praktikë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga cetniket me në krye Drazha Mihailloviçin, kundërshtarë të komunistëve, edhe Partia Komuniste Jugosllave, ndoqi një politike në thelb anti-shqiptare, por hipokritë dhe me dy fytyra. Mbas çlirimit të Jugosllavisë, në tetor 1944, është përsëri Cubriloviçi, që thërritet në skenë dhe u ofron drejtuesve të rinj titistë njohuritë e tij prej eksperti të spastrimit etnik. Programi i ri, i titulluar “Problemi i pakicave të Jugosllavisë”, për nga përmbajtja dhe rrugët që propozonte për shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e veta, ishte i ngjashëm me referatin e tij famëkeq të marsit të vitit 1937.⁹⁾ Ai rekomandonte përsëri, se “vetëm pastërtia etnike” mund të siguronte progresin në Jugosllavi, se shqiptarët, krahas pakicave të tjera në Jugosllavi, “meritonin” të humbisnin të gjitha të drejtat civile, se për zgjidhjen e problemit të minoriteteve, “duhet të fitonin me çdo kusht, Kosovën dhe Metohinë”, të cilat sidomos, sipas tij, duhet të ndërrojnë krejtësisht kompozimin e tyre etnik.¹⁰⁾

Nuk mund të mos përmendim projektin e hartuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë, në vjeshtë 1986, i quajtur “Memorandumi mbi çështjet sociale aktuale në vendin tonë”, ose shkurt “Memorandumi i Akademisë”. Memorandumi, që përbënte një skicë të një programi të ri nacional serb, kërkoi krijimin e shtetit të pastër të kombit serb, që sipas tyre, ishte fitues në luftë dhe humbës në paqe. Lufta për të drejta kombëtare e popullsisë shqiptare” u quajt aty, një “agresion i vërtetë”, u akuzuan shqiptarët për genocid ndaj serbëve në shekuj, që në fund të viteve 80-të kishte kaluar në një “etapë finale” dhe theksohej se “fati i Kosovës mbetet një çështje vitale për gjithë popullin serb”, duke kërcënuar se në rast moszgjidhjeje të problemit, çështja do të merrte dimensione evropiane, me pasoja të rënda, të paparashikuara¹¹⁾. Ishte ky memorandum që mbështeti politikën shoviniste kriminale të Slllobodan Milosheviçit ndaj të gjithë popujve të përfshirë në ish-Jugosllavinë Federale, që ra aq rëndë mbi lëvizjen e popullit shqiptar për një dekadë të tërë.

Kjo politikë konstante antishqiptare çoi në injorimin absolut të të drejtave të popullsisë shqiptare në Serbi, Mal të Zi dhe Greqi. Mbas Luftës së Parë Botërore, si shteti i bashkuar i Jugosllavisë dhe Greqia, nënshkruan Traktatin e Sen-Zhermenit, “Mbi minoritetet”, 16 shtator 1919, unifikuar nga Lidhja e Kombeve në vitin 1920. Por përsëri, në mënyrë sistematike, iu mohuan popullsisë shqiptare në Kosovë dhe Çamëri çdo e drejtë kombëtare: si e drejta për shkollimin në gjuhën amtare, përdorimi i saj në veprimtarite publike, e drejta e zhvillimit të kulturës kombëtare, e përdorimit të simboleve kombëtare, e manifestimit të individualitetit kombëtar etj. Situata në Kosovë ndryshoi paksa vetëm mbas shpalljes si krahinë autonome të saj, në kuadrin e ristrukturimit të Jugosllavisë në një shtet federativ, shprehur me Kushtetutën e Kosovës

në 1974, deri në likuidimin e saj total në mars të 1989, nën regjimin e egër policor shovinist të Sllobodan Milosheviçit.¹¹⁾

Ndërkohë, nga viti 1913 e deri më sot, në shtetin grek, nuk u njoh asnjëherë, as njihet edhe sot, e drejta si pakicë kombëtare për popullsinë shqiptare në Çamëri, Follorinë e Kostur. Madje çamët, si shqiptarë, nuk kanë mundur asnjëherë të përfaqësohen në Parlamentin grek, nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e këshillave komunale etj. Në vitin 1938, prefekti grek i Çamërise u ndaloi zyrtarisht çamëve përdorimin e gjuhës shqipe në familje.¹²⁾

Politikat e aneksimeve territoriale dhe e spastrimeve etnike ndaj shqiptarëve, të ndeshura me një rezistencë të vazhdueshme dhe në rritje, spontane e të organizuar, nga ana e tyre, kanë çuar në masakra dhe gjakderdhje të vazhdueshme, në shpërngulje masive, në shpronësime të qindra e mijëra banorëve. Mungojnë statistika të plota në rrafsh kombëtar, ç'ka paraqitet tepër e vështirë për studjuesit. Por, ka qindra dëshmi okulare, korespondenca etj, të pasqyruara në çdo etapë historike në shtypin shqiptar dhe të huaj; qindra dokumente në arkivat shqiptare e të huaja, një pjesë e vogël e tyre e botuar; shumë botime e studime të kryera nga autorë vendas e të tjerë.

Pa mundur të bëjmë një kronikë të këtij zinxhiri masakrash e spastrimesh etnike, po ndalemi shkurtimisht në disa prej tyre. Një nga kulmet është arritur në kuadrin e Luftërave Ballkanike, në vitet 1912-1913, para dhe mbas krijimit të shtetit shqiptar, madje shtrirë deri në vitet 1914-1915. Shtypi dhe dokumentet flasin për mijëra të dëshpëruar, të arratisur në male, pa bukë, për qindra të therur e të vvarë, për gra të djegura, të mbytyra, të dhunuara, për një persekutim, terror të egër dhe sulm ndaj institucioneve dhe civilizimit myslyman të shqiptarëve. “Duan t’a shuajnë fare emrin e shqiptarit” –shkruante shtypi shqiptar në vjeshtë të vitit 1913. Mbas Kryengritjes së Dibrës, shtator 1913, rreth 100000 refugjatë u detyruan të shpërngulen në shtetin shqiptar, kur qindra të tjerë u vranë. Ndërkohë, krahas masakrave të kryera në Çamëri në 1913, 100000 shqiptarë të Jugut, nga Kolonja, Korça, Tepelena, u detyruan të shpërngulen në ullishtet e Vlorës, për të shpëtuar nga masakrat e grupeve të armatosura shoviniste greke në verën e vitit 1914, ku vdiqën me qindra nga malarja, gripi, kushtet e vështira të jetesës etj.¹⁴⁾

Ky genocid i paparë tërhoqi vëmendjen e publikut ndërkombëtar demokrat. Në vitin 1913, shkrimtari me origjinë izraelite Leo Freundlich, do të botonte në Vjenë librin titulluar “Akuza që ulërijnë”, ku përfshiheshin dokumenta akuzonjëse, mbi spastrimin etnik ndaj shqiptarëve, barbarizmat masive të forcave ushtarake serbe dhe malazeze ndaj tyre, që mund të quhen si holokausti i parë në historinë e Evropës moderne, ku jo vetëm u planifikua, por edhe u aplikua shfarrosja e një populli.¹⁵⁾ Pikërisht në vitin 1913, Komisioni i Parë për Ballkanin, i sipërpërmendur, me në krye baronin d’Estournelle de Constantom, do të paraqiste fakte të shumta të kësaj “skene të errët”, mbi popujt e Ballkanit dhe sidomos atë shqiptar.¹⁶⁾

Represioni anti shqiptar nuk pushoi as në vitet e Luftës së Parë Botërore. Sipas vetë burimeve serbe, në mes të luftës, në vitin 1915, masakrat e ushtrisë serbe, çuan në dhjetra mijëra viktima shqiptare dhe në djegien e fshatrave të tëra. Vetë autorë serbe si Dushan Popoviç, do të fliste për horizontin e ngushtë, kriminal, politik dhe shpirtëror të komandantëve ushtarake serbë, që konsideronin “si një lloj heroizmi masakrat kriminale”,

ndaj qindra shqiptarëve, grave dhe fëmijëve, dhe akuzonte piramidën sociale dhe politike në Serbi, që kishte ushqyer “të gjitha këto kafshëri”.¹⁷⁾

Ndërkohë shqiptarët në Jugosllavi vazhduan t’i nënshtrohen proceseve të spastrimeve etnike në vitet 20-30-të, në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, në vitet 80-të dhe 90-të, të shoqëruara këto me persekutimin fetar, shpronësimin dhe shpërnguljet masive, kolonizimin e trojeve shqiptare, me burgosje në masë, fushata terrori dhe genocidi. Vetëm në kuadrin e Reformës Agrare në vitet 1918-1940, popullsisë shqiptare iu grabit rreth gjysma e sipërfaqes së tokës, që ajo zotëronte në pronësi private ose të përbashkët në vitin 1918. Po gjatë kësaj periudhe ka të dhëna për instalimin e kolonëve në fshatra shqiptare, por edhe në qytete, të rreth 200000 vetëve. Por, regjimi i Beogradit nuk mundi t’i ndryshonte dukshëm raportin e përbërjes etnike të popullsisë së Kosovës, duke e zbritur ndoshta në 65.5% numrin e shqiptarëve.¹⁸⁾ Mërgimet dhe shpërnguljet e detyruara të shqiptarëve, kryesisht në Turqi, erdhën progresivisht në rritje. Në literaturën, teorinë dhe praktikën e mërgimeve ndërkombëtare, është vështirë të gjendet ndonjë popull, që t’i jetë nënshtuar më shumë faktorëve shtrëngues të dëbimit dhe largimit. Vlerësohet se vetëm në periudhën 1912-1967, kryesisht në Turqi, janë detyruar të largohen mbi 240000 vetë, ndërsa në periudhën Rankoviciane, 1953-1966, rreth 500000 shqiptarë¹⁹⁾.

Fushata të vërteta terroriste dhe genocidi përjetuan shqiptarët në fund të Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi dhe Greqi, ku në emër të luftës kundër reaksionit dhe bashkëpunëtorëve të fashizmit, u godit në masë popullsia e pafajshme civile, gra, pleq e fëmijë. Në Jugosllavi në bazë të listave të përgatitura më parë, u arrestuan mijra njerëz, u ngritën kudo burgje, dhe u ekzekutuan po aq, duke e kthyer Kosoven në një pellg gjaku dhe në një teatër të një rezistence të vërtetë të armatosur nga ana e shqiptarëve në pranverë të 1945, të cilët, të përndjekur nga të gjitha anët, të mashtruar, pa mundur të realizonin të drejtat e tyre për vetvendosje, u ndodhën si të zënë në çark. Vetëm në Tivar, në prill 1945, Brigada e 10-të e Ushtrisë Nacionalclirimtare Jugosllave, kreu një masakër të pashembullt, në oborrin e një ndërtese, ku u sulmuan në befasi rreth 4000 të rinj shqiptarë, të mobilizuar në ushtri, nga të cilët mundën të shpëtonin vetëm 800 vetë²⁰⁾. Shpërngulje masive të popullsisë shqiptare u kryen njëkohësisht në Çamëri, sidomos mbas Konventës së Lozanës, në janar të vitit 1923, kur mijëra çamë myslymanë u dëbuan në Turqi të cilësuar si turq. Në vitet 1923-1925, numri i të larguarvë arriti në 33000 vetë. Qeveria greke konfiskoi të gjitha tokat dhe pasuritë e shqiptarëve që u larguan dhe në tokat e tyre u vendosën kolonë grekë, shoqëruar me terror të hapur, tortura, burgosje masive, vrasje, dhunime etj²¹⁾. Masakrat arritën kulmin në fund të Luftës së Dytë Botërore. Me të njëjtat motive si në Jugosllavi, bandat shoviniste greke, nën kryesinë e gjeneral Napoleon Zervas etj, në qershor dhe korrik 1944, në shkurt dhe mars 1945, sulmuan popullsinë e pafajshme shqiptare çame, e masakruan egërsisht atë, dhe u dëbuan me forcë rreth 23000 vetë, që u strehuan në Shqipëri.²²⁾

Përsëri popullsia shqiptare u gjakos keqas në pranverë të vitit 1999, kur genocidi dhe spastrimi etnik arriti kulmin. U detyrua me forcë të shpërngulej një popullsi e tërë, si në eksodet biblike të lashtësisë. U kryen mizori të panumërta dhe të paimagjineshme. Dihet rreth 12000 të vrarë, 3000 të zhdukur pa lënë gjurmë, 500 varreza masive etj. Ka të dhëna për shumë shqiptarë të marrë pengje, të vrarë e të djegur në furnaltat e shkretoret në veri të Mitrovicës dhe në qytete të tjerë, për burgje private në Jugosllavi me të

burgosur shqiptarë, për mbi 700 të burgosur, të ditur zyrtarisht, ende të paliruar etj. Dhe dihet gjithashtu që këto të dhëna nuk janë ende të plota.²³⁾

Njohja e së vërtetës historike mbi spastrimet etnike dhe dënimi i shfaqjeve shoviniste faktorë themelore të integritit ballkanik.

Megjithë tezat e argumentet e shumta të secilës pale për fenomenin e spastrimeve etnike në Ballkan, të gjithë tashmë janë dakord që Ballkani ka vuajtur shumë gjatë këtij shekulli, dhe më parë, nga mentalitetet dhe praktikat shoviniste. Me qetësi, duhet të përballemi me pyetjet: A duhet njohur e vërteta historike për spastrimet etnike? A duhet që popujt ballkanas të nxjerrin mësim nga e kaluara? Dhe, a pengojnë këto procesin e integritit ballkanik?

E vërteta tepër herë është e hidhur, por ajo kushton dhe njëkohësisht vlen shumë. Që në fillim të shekullit, Komisioni i Parë për Ballkanin Karnegi, shtronte këtë pyetje: "A duhet t'i lëmë të shkojnë këto luftëra ballkanike, pa nxjerrë të paktën ndonjë mësim prej tyre, pa njohur nëse ato ishin një e mirë ose një e keqe, nëse do të rifillojnë sërish, duke u përhapur më shumë?" Në fund të shekullit popujt ballkanikë por dhe politika ndërkombëtare u gjendën sërish në këtë cikël infernal. "Nuk mjafton, -u shprehën analistë kroatë,-të riprovosh barbarinë naziste të djeshme, duhet gjithashtu të ekspozosh gjithçka që i ngjan asaj, sidomos kur bëhet fjalë për praktika të sprovuara prej dy shekujsh"²⁴⁾.

E vërteta është se, shpesh herë diplomacia ndërkombëtare ka mbyllur sytë përpara shfaqjeve shoviniste në Ballkan. Megjithëse Jugosllavia s'ka qënë kurrë një shtet i së drejtës dhe një demokraci autentike dhe në Greqi janë vërejtur shkelje të hapura të të drejtave kombëtare të popullsisë çame dhe shfaqje të ksenofobisë në vite ndaj emigracionit shqiptar, "në emër të statu quo-së ndërkombëtare" është pranuar një gjendje fakti e karakterizuar nga dhunimi i pandërprerë i të drejtave të shqiptarëve dhe lirisë së tyre. Në këtë kontekst, që nga viti 1913 dhe në vazhdim, është injoruar dëshira e popullsisë shqiptare në Jugosllavi për realizimin e parimit të vetvendosjes dhe për pavarësi. Gjithashtu janë mbyllur sytë para mos zbatimit të të drejtave kombëtare të popullsisë çame në Greqi apo të emigruar në Shqipëri etj.

Që në copëtimin e trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës, analistë shqiptarë dhe të huaj, e quajtën të gabuar këtë zgjidhje jo me vizione largpamëse. Ata parashikuan qartë, që pa u zgjidhur çështja shqiptare, konfliktet nuk do të pushonin kurrë, jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë, dhe se diplomacisë do t'i duheshin Konferenca të tjera, ku të punonte me drejtësi dhe me seriozitet.²⁵⁾

Por edhe mbas ngjarjeve të përgjakshme në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë etj, në vitet 1992-1993, problemet e Kosovës dhe të Maqedonisë u lanë në hije. Ato u quajtën "dy vatra të paprekura" në Marrëveshjen e Dejtonit, ndërsa Konferenca e Rambujesë, megjithë hapat përpara dhe vendosjen e kontrollit ndërkombëtar në Kosovë, e la atë përsëri de jure nën juridiksionin e Jugosllavisë. Në këto situata rreziku i luftërave në Ballkan mbetet i hapur. Është kjo arsyeja që një sërë analistësh në botë, vërejnë që "pavarësia" është zgjidhja e vetme në Kosovë, kur të gjitha partitë politike shqiptare në Kosovë, por dhe në Maqedoni, i qëndrojnë gjithashtu kësaj teze, duke theksuar, se "vetëm ky status do t'i kontribuojë paqes, kur variantet e tjera janë jo reale, jo të drejta, jo

historike dhe të rrezikshme për paqen në Kosovë, Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe në mbarë rajonin.²⁶⁾

Zbardhja e së vërtetës historike, çlirimi nga mitet e rreme historike kombëtare, nga mentalitetet shoviniste dhe urrejtja etnike, pranimi i realiteteve historike dhe zbatimi i parimit të vetvendosjes së popujve, janë probleme të ndërlikuara dhe të vështira për t'u realizuar. Do të duhet kohë dhe impenjime të mëdha nga shtetet ballkanike dhe faktorë ndërkombëtarë. Ka arritur koha, siç theksohet nga Komisioni i Dytë për Ballkanin, që institucione të posaçme ndërkombëtare, të përcaktojnë midis të drejtës për vetvendosje, shprehur në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe angazhimit ndërkombëtar për paprekshmërinë e kufijve.²⁷⁾

Por pa prituri zgjidhjet përfundimtare në kuadrin e domosdoshmërisë së integritetit ballkanik, është e domosdoshme njohja dhe dënimi i krimeve të evidentuara gjatë spastrimeve të shumta etnike, sidomos gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kjo do të krijonte një frymë besimi dhe bashkëpunimi të ndërsjellë midis popujve dhe shndërrimin gradual të mentaliteteve shoviniste, atje ku janë shfaqur ose vazhdojnë të shfaqen akoma.

Intelektualët ballkanas, politikanë, historianë, sociologë, psikologë etj, kanë barrën të përballojnë së pari këto sfida. Klima tashmë duket më ndryshe. Janë ngritur komisione të shumta bashkëpunimi, dhe të tjerë duhet të ngrihen. Të paraqesim kështu, në dritë të diellit, pjesën e errët të së kaluarës sonë historike, të gjejmë rrënjët e saj, ta dënojmë atë dhe të evidentojmë ç'ka kemi të përbashkët në luftën për liri, për pavarësi, për demokraci, në kulturë, në modelimet tona psiko-kulturore etj. Vetëm përmes këtij procesi mund të arrihet në një ndërgjegjësim dhe shndërrim të mentalitetit të së kaluarës, si garanci për ndërtimin e së ardhmes drejt një rajoni të integruar.

Referenca

1. E.J.Hobsbaum, "Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780"^{a)} (Programi, Miti, Realiteti), Tirane, vt.1995, fq.191
2. Po aty.

3. "Paqe e Papërfunduar", Raport i Komisionit Ndërkombëtar për Ballkanin, Tiranë, 1998, fq.20-21. (Titulli i origjinalit "Unfinished Peace". Report of the International Commission of the Balkans, Washington, 1966), fq.20-21.
4. Po aty, fq. 2.
5. Po aty, fq 29
6. Historia e Shqipërise, botim i Akademisë së Shkencave, vëll.2^{të}, Tiranë, 1984, fq.141-142.
7. "Le Nettoyage ethnique", (Documents historiques sur une ideologie serbe), Rassembles, traduits et commentes par: Mirko Grmek, Mark Gjidar et Neven Simac, France, vt.1993, fq. 152.
8. "Le Nettayoge ethnique", (I cituar i plotë më lart), fq.161, 162 (Elaborati i plotë është në fq. 161-185).
9. Lefter Nasi, "Ripushtimi i Kosovës"(shtator 1944-korrik 1945), Tiranë 1994, fq.131
10. "Le Nettoyage ethnique", fq.225, 226.
11. Po aty, fq.232, 236,249,251,254. (Memorandumi i Akademisë i plotë, shtrihet në faqet 237-269).
12. "Platformë për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare", nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1998, fq.24-25
13. Historia e popullit shqiptar"(Maket), për vitin e katërt të shkollës së Mesme të Përgjithshme, Tiranë 1999, fq.242. (Pjesë e përgatitur nga Prof.As. Ana Lalaj)
14. Gazeta:"Përlindja e Shqipënisë" dt.14|27, vjeshtë e 1^{-të}, viti 1913, art."Lufta midis shqiptarëve dhe serbëve".
15. Gazeta:"Liri e Shqipërisë", dt.30 tetor 1913, art."Komisioni i Fuqive".
"Dokumente për Çamërinë", Tiranë 1999, fq.2-8.
(Mbledhur nga Dr. Kaliopi Naska)
Lumo Skëndo, "Problemet e Shqipërisë indipendente"(shkruar pas kujtimeve personale), tek revista "Përpjekja", vt.1995, nr.2, fq.102-103.
16. Leo Freundlich, "Golgota shqiptare", Tiranë 1995, (ribotim i librit titulluar "Accusation Records", Vjenë, 1913).
17. "Paqe e Papërfunduar", (cituar më lart) fq.4.
18. "Le Netoyage ethnique", fq. 153, 154.
19. Marenglen Verli,"Reforma agrare kolonizuese në Kosovë", Tiranë 1992, fq.97, 142.
20. Mr.Rifat Plaku, art."Shkaqet e eksodit shqiptar", në librin, "Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve", Prishtinë, 1992, fq.204
21. Lefter Nasi "Ripushtimi i Kosovës", fq. 134, 177, 178.
22. "Dokumente për Çamërinë", (1912-1939), fq.542
23. "Memorandum du Comite Antifasciste des emigres Tchamouriotes resident en Albanie, a la Commission d'Enquete du Conseil de Securite de L.O.N.U. (Au sujet du traitement et des massacres de la minorite albanaise au Grece), në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë, vt.1946, fq. 6, 11.
24. Gazeta "Shekulli", dt. 30 dhjetor 2000, art."Kosova pret mijëvjeçarin e ri, pa ditur numrin e të vrarëve në luftën e fundit".
25. "Le nettoyage ethniane", fq.18.
26. Fatmira Rama, art."Shtypi shqiptar i vitit 1913 për të ardhmen historike të

- shqiptarëve”, “Studime historike”, nr.1-2, viti 2000, fq. 59.
27. Gazeta”Shekulli”, dt.24 dhjetor 2000, art.”Pavarësia e Kosovës është e pashmangshme”(nga Erik Uiti).
28. “Paqe e papërfunduar”, fq. XVIII.

Prof. MILAIM FEJZIU

**TRAUMA TE SHQIPTARËT E MAQEDONISË PARË NGA ASPEKTI I REALIZIMIT
TË LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË TYRE NË MAQEDONI**

**MOTOJA: "LIRIA DHE E DREJTA NUK EGZISTON PO QE SE INDIVID I NË TË FATIN
E VET NUK E REALIZON"**

Gjendja e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve sot në Maqedoni shërben si shkas i drejtëpërdrejtë për t'i bërë një vështrim kritik dhe të përgjithshëm pozitës së tyre juridiko – kushtetuese në shoqëri rolin që luan në të dhe, nga ana tjetër natyrën dhe thelbin e shoqërisë. Vështrimi i tillë presupozon, para së gjithash, njohjen e burimeve themelore të të drejtave të njeriut.

Qysh në fillim dëshiroj të theksoj se individualiteti politiko – juridik i shqiptarëve në Maqedoni nuk mund të perceptohet vetëm me konstatim të shkeljeve të lirive themelore dhe të të drejtave të tyre në Maqedoni, por para së gjithash edhe në bazë të individualitetit etnik dhe territorial të Maqedonisë dhe vullnetit të shprehur të popullit shqiptar në Maqedoni për institucionalizimin të këtijë individualiteti.

Maqedonia sot në bazë të shumë monitorimeve që i janë bërë dhe i bëhen, është bërë e njohur në rajon e në Evropë me shkelje flagrante të lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut, të përcaktuara dhe të garantuara me Konventat ndërkombëtare që kanë për bazë parimet e përgjithshme të barazisë së plotë dhe mosdiskriminimit.

1. Në Maqedoni me dhjetra vjet jetojnë paralelisht dy bashkësi të mëdha etnike, me veçori të përcaktuara që eliminojnë mundësinë e asimilimit: ajo shqiptare, autoktone, dhe ajo sllave që sot identifikohet me emrin antik maqedon.

Të dy bashkësitë kanë histori të ndara kombëtare, trashëgimore kulturore, fetare me aspirata për t'i takuar çdo njëra trungut të vet kombëtar.

Konflikte të mëdha në mes tyre nuk ka pasur, por në situata të krizës, kur duhej të instalohet interesi sllav në teritor të huaj.

Shqiptarët rregullisht përkrahën ofertat për luftë të përbashkët, që nga Republika e Krushevës deri te lufta kundër fashizmit. Kontestet në mes dy bashkësive ndodhnin kur duhej të ndaheshin frytet e fitores së përbashkët.

Në fillim, kur ofertat dhe mosmarrëveshjet ishin ende të freskëta shqiptarët kishin të drejta parimore për barabarësi, mirëpo, me kalimin e kohës këto gradualisht i humbin p.sh. në Kushtetutën e vitit 1946 shqiptarët përkufizohen si komb, në atë të vitit 1974 si kombësi, ndërkaq me Kushtetutën aktuale "demokratike" 1991 shndërrohet në minoritet, ku Maqedonia përkufizohet si shtet një nacional i maqedonasve.

Ky përvetësim i shtetit bëhet në emër të trashigimisë historike, kulturore, shpirtëror të popullit maqedonas duke ndryshuar kështu edhe me represion trashigiminë historike, kulturore, shpirtërore të popullit shqiptar. Shqiptarët duhet të trajtohen si bashkësi e barabartë me maqedonasit, për shkak se janë shumicë dhe popull autokton, me histori, kulturë dhe veçori etnike dhe nuk mund të trajtohen në asnjë mënyrë si minoritet.

Shqiptarët në Maqedoni duhet të fitojnë statusin e popullit shtetformues, jo për të krijuar një kundërpozicion ndaj represionit të stabilizimit maqedonas, por për shkak se ata, duke filluar nga Republika e Krushevës gjithmonë janë trajtuar si shtetformues.

Kërkesa që shqiptarët të jenë bartës të sovranitetit në Maqedoni ka mbështetje:

-Parimore: për shkak të drejtës së tyre mbi trojet etnike, ku kanë jetuar me shekuj nga periudhat më të hershme, ku kanë formësuar etnitetin, identitetin kombëtar dhe ku

aktualisht vazhdimisht vazhdojnë të jetojnë në kompaktësi territoriale gjuhësore, kulturore dhe fetare.

-Historike: për shkak se këto të drejta i kanë fituar qysh më 1903 me shpalljen e Republikës së Krushevës, më 1944 (ASNOM) dhe me Kushtetutën e 1974 të RS të Maqedonisë dhe,

-Aktuale: për shkak të proceseve demokratike që zhvillohen në Evropë që riafirmojnë aktet e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës për vetvendosje të kombeve, Akti final i Helsinkit (1975), Karta e Parisit për një Evropë të re (1990) etj.

Mbi këto baza historike shkencore që konstatojnë egzistimin objektiv të diversitetit etnik, kulturor, vullneti këmbëngulës që edhe më tej, të kultivohej si dhe tendencës globale që të standardizohen këto hapësira në kuadër të sistemit të vlerave perëndimore, mund të arrihet marrëveshja për eliminimin e padrejtësive ndaj bashkësisë shqiptare në Maqedoni nga maqedonasit.

Veprimet e deritashme, imponimi i një koncepti unitar me anë të Kushtetutës aktuale që nuk përfill realitetin e brendshëm, atë të jashtëm, të drejtat e trashëguara si dhe kërkesat për lojalitet nga një pjesë e madhe e popullatës jo sllave, thellësisht të-pakënaqur me statusin e vet në të dhe në fund, ofrimi i dialogut dhe marrëveshje në kuadër të institucioneve të sistemit që në esencë e pamundësojnë atë, është gjenerator i vërtetë i padrejtësive ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve.

Maqedonia do të jetë shtet stabil po qe se në këtë kohë të oportunitetit historik ndërtohet mbi konceptin e dy bashkësive më të mëdha etnike, maqedonase dhe shqiptare që bashkërisht jetojnë me të tjerët.

Pra, pa u ballafaquar me çështjet parimore, do të jemi të shtrënguar të veprojmë pas pasojave që do të rriten gjithnjë më tepër nga që shqiptarët nuk pajtohen me statusin e tyre aktual dhe do të bëjnë orvajtje gjithnjë e më të mëdha e më të sukseshme që ta përmirësojnë atë dhe establismenti maqedonas që instaloi një koncept kushtetues të panatyrshëm në mes dy bashkësive do të përpiqet t'i pengojë këto orvajtje me mjete represive, siç edhe veproi gjatë themelimit të UT-së dhe përdorimit të flamurit në Gostivar në ngjarje të tjera, dhe në këtë mënyrë marrëdhëniet ndëretnike do të tendosen dhe sistemi do të shndërrohet në një vatër permanente të krizës, të konfrontimit jo produktiv, të shkeljeve flagrante të të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe të shkeljes së vlerave dhe të standardeve evropiane.

Rrugëdalja e vetme është përfillja e interesit dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Kushtetutë, duke mos cënuar me asnjë mënyrë ata maqedonase.

2. Në Maqedoni periudha e tranzicionit 10 vjeçar karakterizohet me vazhdimësinë e kërimit dhe formësimit të identitetit kombëtar maqedonas dhe me vazhdimësinë e kërkesës për avancim të statusit juridiko – kushtetues të shqiptarëve në Maqedoni.

Zhvillimi i deritanishëm në Maqedoni ka favorizuar gjithmonë vetëm popullin Maqedon, ndërsa shqiptarët, ndonëse numerikisht sa ata, kanë qenë në margjinat e këtij zhvillimi dhe pozitën e tij vazhdimisht ja kanë caktuar dhe ja caktojnë maqedonasit.

Lirisht mund të thuhet se kriza në Maqedoni është kriza e të gjitha vlerave njerëzore dhe shoqërore, dhe nga kjo krizë mund të dilet vetëm nëse revidohet koncepti global i shtetit Maqedonas i cili solli deri në këtë krizë vlerash.

Dyshimin parimor për lojalitetin e shqiptarëve ndaj shtetit të Maqedonisë e rritën edhe më shumë ankesat dhe kërkesat e shqiptarëve. Është fakt evident mosprezantimi dhe

mospërfshirja e tyre në administratën shtetërore (në polici, ushtri, arsim, kulturë) dhe paraqesin simptomë të një sëmundje kronike. Shqiptarët mendojnë se Maqedonasit sillen ndaj tyre, jo vetëm në planin shoqëror, por edhe në planin kulturor si ndaj njerëzve të "klasës së ulët".

Kohë pas kohe ka ardhur deri në shprazje të kësaj energjie negative dhe urrejtje ndërnacionale në disa konflikte si ai i Ladorishtit (1992), Bit – Pazarit (1993) – Shkup, ngjarjet rreth UT-në Tetovë (1995), ngjarjet e Gostivarit (1997) në Gostivar etj. Këto ngjarje tregojnë qartë se mund të sjellin deri në konflikte më serioze në Maqedoni. Dilema e evidente në Maqedoni mbetet: në mes orientimit politik dhe klimës shoqërore ku egziston një jaz i thellë në marrëdhëniet Shqiptaro – Maqedonase i cili vështirë se mund të harmonizohet.

Nëse nuk bëhen ndryshime radikale në pozitën Juridiko – kushtetuese të shqiptarëve të Maqedonisë dhe Maqedonia nuk krijohet si shtet binacional, që mund të jetë formulë e një "Modus Vivendi" në të kundërt zgjidhjet do të kërkohen në veprime konfliktuoze për avancimin e këtij Statusi.

3. Kriza e thellë në marrëdhënjet ndërnacionale konsiston pikërisht në faktin se:

Shqiptarët popull etnik në Republikën e Maqedonisë zyrtarisht paraqiten 23 % kurse realisht janë afër 40 % dhe janë popull autokton me kompaktësi teritoriale, gjuhësore dhe kulturore.

Ndaj shqiptarëve pushteti maqedonas ka ushtruar dhe ushtron veprime të cilat bien ndesh me vet Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me shumë dokumente tjera ndërkombëtare.

Një ndër gjeneratorët e diskriminimit institucional ndaj shqiptarëve është kushtetuta aktuale e cila u aprovua më nëntor të 1991 dhe shqiptarëve u imponoj Statusin e qytetarëve të rendit të dytë, përkatësisht Statusin e padefinuar dhe denigruar sipas të cilit ata përjashtohen nga e drejta e tyre historike dhe trashigimore në këto troje.

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë shqiptarët i privoi nga e drejta për të qenë element konstitutiv e shtetësisë (që nga Republika e Krushevës së vitit 1903).
2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë injoroi argumentin se shqiptarët janë bashkëformues të kësaj Republike si fryt i luftës së përbashkët në të kaluarën.
3. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nuk përfilli faktin se shqiptarët janë bartës të sovranitetit me Kushtetutën e vitit 1974.
4. Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë nuk u morën në konsideratë faktet e pamohueshme historiko – politike:
 - a) se shqiptarët në Maqedoni jetojnë në trojet e veta etnike si popull autokton;
 - b) se shqiptarët në Maqedoni i karakterizon kompaktësia e tyre etnike teritoriale;
 - c) se shqiptarët në Maqedoni paraqesin një bashkësi të shquar kombëtare, gjuhësore dhe kulturore;
 - d) se shqiptarët në Maqedoni në trojet e veta janë popull shumicë dhe se në trojet e veta etnike ndërtojnë ardhmërinë me popujt tjerë.

Dispozitat themelore të Kushtetutës aktuale duhet t'i nënshtrohen një vështrimi dhe vlerësimi kritik, gjithëpërfshirës dhe analitik e veçanërisht ato që kanë të bëjnë me

sovrانيتin dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të shkrimit shqip.

Shqiptarët në Maqedoni nuk mund të trajtohen si pakicë kombëtare ose minoritet as për nga numri, as për nga shkalla e vetëdijes kombëtare dhe as për nga zhvillimi shpirtëror dhe kulturor.

4. Është shqetësues veçanërisht fakti se shqiptarët janë të privuar nga e drejta themelore – e drejta e jetës.

Periudha prej vitit 1990 e këtej llogaritet si periudhë “demokratike dhe e paqes” në Maqedoni. Megjithatë mbi 30 shqiptarë gjetën vdekjen nga torturimet e skajshme policore. Zyrtarët maqedonas justifikohen se “ata kanë bërë vetëvrasje” ose “kanë qenë viktima të aksidenteve”. Gjithë këto raste nuk janë ndriçuar, kurse policia për këto del e pafajshme dhe këtu mbyllet procedura. E drejta e barazisë para ligjit në Maqedoni zbatohet sipas përkatësisë etnike. Intelektualët shqiptarë vetëm pse kërkuan që fëmijët shqiptarë të shkollohen në gjuhën amtare në nivel universitar’ u dënuan me burg, ndërkaq intelektualët maqedonas të cilët qëndronin në krye të protestave, ku kërkohej vrasja e shqiptarëve dhe komora të gazit as që i shqetësoi ndopak organet kompetente.

Shqiptarët vazhdimisht diskriminohen para ligjit dhe nuk gëzojnë mbrojtje të barabartë me maqedonasit. Është rregull që për të njëjtat vepra penale dënimet që u shqiptohen shqiptarëve nga gjykatat ndryshojnë sipas përkatësisë nacionale të të akuzuarve dhe ata shpeshherë janë drastike ndaj shqiptarëve.

Edhe sot e kësaj dite vazhdojnë arrestimet, burgosjet, paraburgosjet arbitrare, trajtimet jonjerëzore ndaj shqiptarëve. Në këtë “kohë paqeje” sipas të dhënave që disponon Forumi Demokratik mbi 60.000 shqiptarë, kryesisht intelektual dhe të rinj kanë kaluar nëpër duart e policisë. Në të shumtën e rasteve, denoncimet i ka bërë vetë policia vetëm e vetëm për të krijuar një psikozë mbikqyrjeje të vazhdueshme, me çka çënohet rëndë siguria personale si e drejtë themelore.

Diskriminimi i njëjtë është edhe me të burgosurit shqiptarë, të cilët nëpër burgjet e Maqedonisë trajtohen në mënyrë speciale pavarësisht nga vepra e kryer.

5. Në Maqedoni edhe pse funksionojnë dy universitete me mbi 30 fakultete, ku mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën maqedonase, shqiptarët kanë mundur të regjistrohen prej 1 – 3 %, nga shkaku se nuk u është mundur që provimet pranuese dhe ndjekjen e studimeve ta bëjnë në gjuhën amtare.

Në Universitetin e Tetovës kanë mundur të regjistrohen për gjashtë vite akademike mbi 10.000 studentë të përfshirë në 14 fakultete dhe 28 degë. Kaq studentë, dy Universitetet – ai i Shkupit dhe ai i Manastirit nuk kanë regjistruar për 50 vjetët e shkuara. Universiteti i Tetovës deri më sot nuk është pranuar nga shteti. Edhe pse faktet flasin se ai është një realitet dhe i domosdoshëm si për shqiptarët ashtu edhe për të tjerët. Në vend që ky pushtet të ndihmonte themelimin e Universitetit të Tetovës ndodhi e kundërta, ja rënoi objektin e paraparë për ligjërata, dërgoi forca të mëdha policore me ç’rast vrau një të ri shqiptar, plagosi mbi 100 të rinj shqiptarë dhe burgosi profesorët e tij. Të gjithë këta u dënuan me burg me pretekste se kanë kundërshtuar Konkluzionet e Qeverisë lidhur me themelimin e UT-së. Në fakt këta humanistë u dënuan në një proces gjyqësor të montuar politik.

Shqiptarëve në Maqedoni u kufizohet e drejta e zhvillimit dhe e ruajtjes së identitetit kombëtar. Sa vlejnë për shqiptarët në Maqedoni dispozitat nga neni 48, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 i Kushtetutës së Maqedonisë, kur shqiptarët në Maqedoni faktikisht nuk gëzojnë të drejtën që të zhvillojnë lirisht dhe të mbrojnë identitetin kombëtar, kur shteti vetëm deklarativisht iu garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor dhe fetar, ndërsa në anën tjetër ua ndalonte themelimin e institucioneve shkencore, arsimore, kulturore dhe artistike, të cilët mundësojnë shprehjen, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar të tyre.

Çfarë vlere ka dispozita kur me Kushtetutë ndalohet çfarëdolloj diskriminimi me motivet e prejardhjes nacionale apo sociale ose për shkak të bindjeve politike, ndërsa provat që disponon kjo organizatë flasin për diskriminim të hapur nacional e social të shqiptarëve.

6. Mediat elektronike dhe të shtypit gjatë kësaj periudhe 10 vjeçare në Maqedoni ishin më shumë në shërbim të politikës ditore të partive në pushtet. Në Maqedoni nuk mund të thuhet se ka ndonjë media të pavarur edhe pse ka media si elektronike po ashtu edhe të shtypit me karakter privat që do të duhej të jenë më të pavarur se mediat shtetërore, por megjithatë edhe ato humbën në luftën për egzistencë dhe e humbin pavarësinë, shpesh mund të dëgjohet se mediat private jo zyrtarisht kanë sponsorizuar ndonjë parti politike.

Ndarja klasike e mediave qoftë elektronike qoftë të shtypit bëhet në baza politike dhe nacionale pavarësisht nga cili korpus politik dhe nacional veprojnë në sferën informative.

Lirisht mund të thuhet se në Maqedoni nuk ka informata objektive dhe të sakta. Nuk ka formalisht cenzurë në mediat por vetë shtëpitë informative me përcaktimet e lartëpërmendura bëjnë autocenzurë që paraqet një absurditet sepse ato vazhdimisht kanë luftuar për fjalën e lirë etj. Shoqata e gazetarëve nuk mund të funksionojë, sepse është një nacionale – maqedonase, ndërsa shqiptarët nuk kanë shoqatë gazetarësh.

Për sa i përket sistemit gjyqësor si pushteti i tretë në ndarjen e pushtetit në Maqedoni mund të thuhet lirisht se ai nuk ka pavarësi të plotë dhe është i ndjekur nga partitë politike në pushtet ose opozitë ka raste që gjykatësit të thirren në biseda informative nga inspektorë të sigurimit shtetërorë dhe të pyeten për lëndët dhe vendimet që i sjellin.

7. Nga ajo që u tha më lart mbi gjendjen faktike të lirive dhe të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni që shkelen në mënyrën më brutale mund të konstatojmë sa vijon:

- e para: se në Maqedoni, në një periudhë më të gjatë zhvillohen proceset më antipode të çkombëtarizimit kundruall humanizmit njerëzor;
- e dyta: se në Maqedoni, zhvillohen akte dehumanizuese që atakojnë egzistencën e shqiptarëve të cilën e dënojnë dokumentet ndërkombëtare;
- e treta: se në Maqedoni, ndeshim përlligje të veprimeve që atakojnë trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve etnikë të cilën e mbrojnë Parimet Universale Ndërkombëtare;
- e katërta: se në Maqedoni, bëhen veprime që atakojnë zhvillimin arsimor të shqiptarëve, të cilin e garantojnë parimet e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut;
- e pesta: se në Maqedoni, merren masa që atakojnë vullnetin shoqëror, politik dhe demokratik të një etnikumi nga ana e një etnikumi tjetër, që është si akt i ndalueshëm me konventat ndërkombëtare;

Sado që do të dëshironim që ta pasqyrojmë gjendjen e përgjithshme të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, vëmendjen e përqëndrojmë në segmente të veçanta të saj që të gjitha veç e veç, por edhe të vështruara bashkarisht, japin një përfytyrim të shpërputhjes së theksuar ndërmjet parimeve të përcaktuara në shumë dokumente ndërkombëtare.

Një pasqyrë, qoftë edhe e shkurtër, e gjendjes së të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, nuk mund t'i anashkalojnë këto fakte të pamohueshme:

- se në Maqedoni ka të burgosur të ndërgjegjes;
- se në Maqedoni bëhen ndjekje për bindje politike;
- se në Maqedoni aplikohet arrestimi arbitrar;
- se në Maqedoni gjykohet liria e mendimit dhe e shprehjes;
- se në Maqedoni ka largime nga puna për motive politike partiake;
- se në Maqedoni nuk sigurohet dhe garantohet jeta e qetë;
- se në Maqedoni çënohet e drejta e përdorimit të gjuhës amëtare;

Përkatësia e tyre etnike në Maqedoni ka bërë që:

- Shqiptarët të jenë objekt arrestimi arbitrar, të torturimit çnjerëzor dhe të mbajtjes në burg të të pafajshmëve;
- Të jenë objekt ndjekjeje për shkak të lirisë së mendimit dhe të shprehjes (përkujtojmë me këtë rast ndjekjen dhe burgosjen e intelektualëve shqiptarë, veprimtarëve dhe studentëve shqiptarë);
- Të jetë objekt diskriminimi nacional e social në punë (numër simbolik i shqiptarëve të punësuar në ndërrmarjet shtetërore dhe përjashtimi i tyre nga privatizimi i ndërrmarjeve);
- Të jenë objekt trajtimi në zyrat e policisë (përkujtojmë se janë trajtuar mbi 60.000 shqiptarë).
- Të jenë objekt diskriminimi në shëndetësi, në arsim, në shkencë, në kulturë, në informim publik dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore.

Ç'është e vërteta, goditjet e pushtetit maqedonas kanë qenë të përqëndruara në tri drejtime kryesore:

- i pari: rrënimi i pushtetit lokal me pretendime të sllavizimit të tij;
- i dyti: shkatërrimi i ekonomisë private me pretendime të plaçkitjes dhe të tjetërsimit të saj;
- i treti: ngulfatja e veprimtarive shoqërore e atyre me interes të veçantë (si shëndetësi, arsim, kulturë, informim publik) me pretendime të zhveshjes nga qenia kombëtare shqiptare.

Problemi i realizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe i shqiptarëve në veçanti sot në Maqedoni më shumë se dje, po bëhet çështje politike, edhe pse mund të vështrohet edhe nga aspekte të tjera.

Së këndejmi, jemi përpara detyrës, që në mungesë të veprimit politik të pushtetit legal dhe legjitim të bëjmë më shumë në senzibilizimin e gjendjes, por edhe të angazhohemi më shumë në përbalimin e saj. Nuk duhet të ngurojmë të merremi me trajtimin e shkëljes së lirive themelore dhe të të drejtave të shqiptarëve, sepse ato sot në Maqedoni janë të rrezikuara në shkallën më të lartë në këtë hapësirë dhe në këtë mjedis.

Trajtimi më serioz i tyre do të na ndihmojë që ta identifikojmë drejtësinë nga padrejtësia, barazinë nga pabarazia, demokracinë nga autokracia, veprimin e shtetit juridik nga voluntarizmi dhe përbashkësinë nga ndasia.

Vrojtime përmbyllëse – Sado që ky vështrim bëhet mbi gjendjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe për atë qëllim, është e udhës që edhe me këtë rast të theksoj se problemi i shqiptarëve në Maqedoni nuk mund të përmbyllet vetëm në liritë themelore dhe të drejtat e njeriut, se ai paraqet vetëm njërin nga dimensionet e çështjes së shqiptarëve në Maqedoni.

Duke e mbyllur këtë paraqitje nga një kumtesë më e vëllimshme, dëshiroj të potencoj se sado që liria personale paraqet motivin themelor të njeriut, liria nacionale paraqet faktorin më të rëndësishëm dhe presupozimin për ruajtjen e identitetit kombëtar të një populli e më saktë të një kombi.

Kështu duhet të jetë edhe me shqiptarët e Maqedonisë të cilëve në mënyrë flagrante u shkelen liritë themelore dhe të drejtat e njeriut qofshin ato individuale apo kolektive kombëtare.

Në fund më lejoni të përfundoj këtë kumtesë me një mendim që lidhet me moton në fillim

“LIRI DHE TË DREJTA NUK KA PO OE SE NUK KA PËR TË GJITHË”

RAPORT

I FORUMIT DEMOKRATIK PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT NË MAQEDONI- GOSTIVAR, LIDHUR ME TRAGJEDINË HUMANITARE TË TË IKURVE DHE TË DEPORTUARVE NGA KOSOVA NË ISH-REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.

Organizata jonë si organizatë joqeveritare duke qenë e angazhuar në sferën e

lirive dhe të drejtave të njeriut në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, lidhur me tragjedinë humanitare që po ndodh këto ditë me të ikurit nga zonat e luftës në Kosovë, në pikat kufitare të Maqedonisë janë duke përjetuar një trajtim çnjerëzor që është në kundërshtim me Konventën e Gjenevës për Status të refugjatëve.

Me anë të këtij raporti ne dëshirojmë të shprehim jo vetëm shqetësimet tona, por edhe indignatën e thellë lidhur me tragjedinë e krijuar humanitare nga ana e Qeverisë së Maqedonisë ndaj të rrezikuarve nga zonat e luftimeve dhe për trajtimin e tyre johuman nga zyrtarët në pikat kufitare ku ato prisnin me ditë të tëra për të fituar statusin e refugjatit për të hyrë në Maqedoni. Me këtë rast organizata jonë duke u mbështetur në parimet e së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe në dokumentet kryesore për të Drejtat e Njeriut të OKB-së, Këshillit të Evropës, OSBE-së e të tjerë, dëshiron të tërheq vëmendjen Tuaj nga fakti se autoritetet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë janë duke kontribuar në mënyrë direkte që kjo tragjedi humanitare me elemente të gjenocidit dhe të krimeve ndaj njerëzimit, (vepra këto që nuk vjetërsohen, por ndëshkohen dhe nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të askujt), mund të shndërrohet në një katastrofë humanitare me pasoja të paparashikueshme.

FDMDLNI vazhdimisht është duke e përcjellë situatën e krijuar, si në pikat kufitare të kalimit të Blacës, Jazhincës dhe Tabanovcit, po ashtu edhe strehimin e rrefugjatëve nëpër familjet shqiptare të Maqedonisë Veri-perëndimore, ku edhe jeton pjesa dërmuese e shqiptarëve. Raportet e veprimtarëve dhe të aktivistëve të kësaj Organizate që drejtpërdrejt janë të angazhuar, si në pikat kufitare, po ashtu edhe në strehimin e tyre, flasin për skena të tmerrshme dhe tragjike në pikën kufitare të Blacës dhe të Jazhincës me çrast rrëfejnë se në këto vendkalime kufitare është duke u zhvilluar një krim njerëzor para syve të botës, s'ka ditë që të mos ketë të vdekur, (por edhe të lindur), të cilëve nesër nuk do t'u dihen as varret. Shtrohet pyetja si është e mundur të ndodhë e gjithë kjo para kamerave botërore, të cilat përcjellin çdo ditë lajme në agjencitë dhe studiot e ndryshme të botës, e cila vazhdon të qëndrojë indiferente ndaj kësaj katastrofe humanitare në fund të këtij shekulli. Është diçka e pashpjegueshme dhe e papranueshme për organizatën tonë që Qeveria e R.M. të mos i tërhiqet vërejtja për këto veprime.

Është me rëndësi të theksojmë se kronologjia e kësaj tragjedie zanafillën e ka në luftën heroike të popullit të Kosovës që po e zhvillon më se një vit, ndërsa Serbia filloi spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë, duke ua imponuar zhvendosjen dhe deportimin e tyre me dhunë në Shqipëri Mali të Zi dhe Maqedoni. Ajo që na brengos në këtë tragjedi humanitare për së tepërmi është fakti se Qeveria e Maqedonisë kësaj tragjedie është duke i dhënë prapavijë politike, edhe pse është thjesht një problem humanitar, dhe për këtë flasin disa veprime dhe deklarata të autoriteteve shtetërore.

Prishja e rendit publik në Maqedoni filloi me organizimin e protestave gjoja të qeta të Partisë së Serbëve që jetojnë në Maqedoni, por edhe të tjerëve të ardhur nga Serbia, apo simpatizues të vendit, kundër sulmeve ajrore të NATO-së në Jugosllavinë e mbetur duke krijuar një atmosferë kundër NATO-së të përcjell me një vandalizëm të paparë, me çrast sulmuan dhe demoluan Ambasadën Amerikane, si dhe Ambasadat e R.F. të Gjermanisë dhe të Britanisë së Madhe në Shkup. Është për t'u habitur se si u lanë pa mbrojtje të sigurisë këto objekte të diplomacive të huaja, kur dy ditë më parë Minsitria e Punëve të Brendshme paralajmëroi opinionin se ka ngritur gjendjen e sigurisë në shkallë më të lartë që lë të kuptohet se do t'i sigurojë të gjitha institucionet dhe objektet

shtetërore dhe diplomatike.

Menjëherë pas fluksit të parë të refugjatëve, Këshilli i Sigurimit të shtetit mori Vendim që të mbyllë kufijtë dhe ata u mbyllën për një ditë. Deklaratat kontradiktore të zyrtarëve flitnin se situata nuk është nën kontroll, dhe për fat të rnrë pikat kufitare u hapën për të ikurit nga Kosova.

Vlen të përmendet me këtë rast Vendimi i Qeverisë jo për pranim të refugjatëve nga Kosova, por "për përkujdesje humanitare", duke i ikur termit refugjat si status i njohur në bazë të Konventës për statusin e refugjatëve (që ka hyrë në fuqi më 22.IV.1954-Gjenevë) mund të realizojnë të drejtat e tyre, që obligohen shtetet t'ua sigurojnë. Një vendim i këtillë paralajmëroi se Qeveria do të bëjë çmos që numri i refugjatëve të jetë sa më i vogël dhe se ky status i padefinuar do të mundësojë mbajtjen e numrit të refugjatëve nën kontroll. Megjithatë dokumentet ndërkombëtare dhe vetë Konventa për statusin e refugjatëve nuk njeh terminologji të këtillë dhe ky term i Qeverisë së ish R. J. të Maqedonisë është në kundërshtim me vetë Konventën.

Ndërkohë paraqitet një kuotë prej 20.000 të përkujdesur që Maqedonia mund t'i pranojë, ndërsa për numrin e refugjatëve mbi këtë kuotë duhet zbatuar propozimin e Kiro Gligorovit për formimin e një koridori për t'i përcjellë refugjatët në Shqipëri.

Zyrtarët Qeveritarë dhe të tjerë nuk nguronin të deklarojnë se numri mbi 20.000 refugjatë do ta ndërrojë hartën demografike të Maqedonisë duke aluduar se do të ndryshojë përbërja etnike dhe do të destabilizojë Maqedoninë.

Sipas të dhënave zyrtare, në Maqedoni kanë hyrë deri më 6.IV.1999 rreth 80.000 refugjatë, ndërsa në pikat kufitare të Blacës dhe të Jazhincës presin të hyjnë edhe rreth 50.000 refugjatë por ky numër ndryshon nga dita në ditë. Pjesa dërrmuese e refugjatëve janë të strehuar në familjet shqiptare. Sipas informatave që vinin nga terreni, organizata jonë nuk ka mundur të evidentojë asnjë rast ku ndonjë refugjat shqiptar nga Kosova të jetë strehuar apo vendosur me kërkesë të ndonjë familjeje maqedonase, ose të ketë ndihmuar me artikuj ushqimorë ndonjë organizatë humanitare që kanë bërë furnizimin me artikuj ushqimorë të familjeve të rrezikuara. Kjo flet qartë se humanizmi deklarativ maqedonas është i rremë kur janë në pyetje shqiptarët. Po ashtu kuptuam se deri më 3.IV.1999, policia ka penguar autobusët me refugjatë që të drejtohen në Kërçovë, Strugë dhe Dibër, me qëllim, që policia të krijojë situatë të tensionuar, duke i kthyer autobusët në Tetovë dhe Gostivar me shpjegime banale se gjoja shqiptarët e këtyre qyteteve nuk dëshirojnë të pranojnë refugjatë.

Prej datës 3 prill 1999 Maqedonia për të dytën herë mbylli kufijtë me Jugosllavinë e mbetur dhe kufizoi hyrjen e të dëbuarëve nga Kosova. Është duke u ushtruar një presion nga faktori ndërkombëtar për hapjen e kufirit, ndaj autoritetet shtetërore, të cilët ngritën shumë pluhur rreth numrit të madh të refugjatëve duke apeluar, por edhe kërcënuar shtetet Evro-perëndimore dhe SHBA-të se Maqedonisë i kanoset destabilizim dhe kollapsi ekonomik, edhe pse dihet fare mirë se shteti s'ka patur shpenzime për vendosjen e këtyre 80.000 refugjatëve, sepse ato janë vendosur nëpër familjet shqiptare, për kundrazhi shteti maqedonas është duke përfutur nga fatkeqësia e rrefugjatëve shqiptarë.

Mund të fitohet përshtypja se ky apel ndaj bashkësisë ndërkombëtare për t'i dalë në ndihmë Maqedonisë filloj ngadalë të animojë shtetet Evropiane dhe SHBA-të, por për këtë gjendje me rrefugjatët shqiptarë në Bllacë, përgjegjëse është Qeveria e Maqedonisë me veprimet që i ndërmerre gjatë kësaj periudhe kohore, të cilat në mënyrë të drejtë kanë ndikuar në eskalimin e tragjedisë humanitare në pikat e situatës kufitare duke mos krijuar

kushte që evidentimi i të ikurve të bëhet në disa punkte ose vende të caktuara në komunat ku janë shpërndarë.

Megjithatë kjo gjendje e krijuar e katastrofës humanitare ka mundur të evitohet, po qe se Qeveria e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ndërmernte veprime konkrete, duke mos e politizuar gjendjen, sidomos duke i ngarkuar ministrinë përkatëse me detyra konkrete. Meqenëse orientimi global i Qeverisë për vendosjen e refugjatëve ka qenë të vendosen në familjet shqiptare që mund të konsiderohet si orientim i drejtë dhe i qëlluar, megjithatë të habit fakti se pse u la anësh angazhimi i Ministrisë së pushtetit lokal me detyra konkrete për vendosjen e refugjatëve në komunat e banuara me shqiptarë, ku kjo Ministri ka edhe ingerenca ndaj tyre dhe këtë aktivitet besojmë se do ta organizonte pa probleme të mëdha duke i koordinuar punët me strukturat komunale e jo të formohen shtabe të ndryshme të emergjencës nga partitë politike, bashkësi lokale dhe subjekte humanitare.

Për të demantuar pohimet e zyrtarëve se në Maqedoni nuk ka mundësi të strehohen një numër i madh të refugjatëve dhe se ky numër në aspekt ekonomik Maqedonia nuk mund ta mbajë, do të shërbehemi me të dhëna sipas Vjetorit Statistikor të 1996, ku thuhet se në Maqedoni ka gjithsej 505.852 familje, sipas regjistrimit të 1991 prej këtij numri me siguri së paku një e treta janë familje shqiptare që do të thotë se janë rreth 170.000 familje. Po të vendosej nga një refugjat mesatarisht në familje del se në Maqedoni pa kurrfarë problemi kanë mundur të vendosen rreth 200.000 refugjatë dhe se Maqedonia nuk do të përjetonte kolaps ekonomik sepse këta refugjatë do të ishin në shtëpitë e familjeve shqiptare, përkundrazi Maqedonia do të kishte leverdi ekonomike, ndërsa kolapsi ekonomik Maqedonisë do t'i vijë nga mosfunksionimi i tregut me Jugosllavinë e tjerë. Kjo statistikë zyrtare flet qartë se Qeveria e Maqedonisë nuk ka dashur ta zgjidhë problemin me të ikurit nga Kosova, por del se me qëllim, duke ndërmarrë veprime të pamatura, ka dashur të krijojë katastrofë humanitare me refugjatët dhe të shfrytëzojë këtë për të realizuar qëllime financiare në formë të ndihmave dhe anulimit të borxheve gjë që është duke e realizuar.

Nga kjo që u tha më lart FDMDLNJ vlerëson se:

- Organet shtetërore të Maqedonisë kanë shkelur rëndë parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe Konventën për status të refugjatëve, duke mos e zbatuar atë në gjendjen konkrete humanitare. Në moszbatimin e drejtë të saj dhe për qëllime vetjake politike, kanë kontribuar në tragjedinë humanitare të refugjatëve në pikat kufitare të Maqedonisë me Jugosllavinë e sidomos në pikën kufitare të Bllacës, ku të ikurit nga Kosova janë të privuar nga të gjitha të drejtat e njeriut duke përfshirë edhe të drejtën për jetë që paraqet një krim ndaj njerëzimit.
- Veprimet e Establishmentit maqedonas nuk mund të vlerësohen si jopërgjegjësi e disa ministrive të angazhuara në këtë tragjedi humanitare me refugjatët, por si papërgjegjësi e gjithë organeve shtetërore e sidomos të Qeverisë, e cila mban përgjegjësinë morale dhe politike, për katastrofën humanitare që po ndodh në kufijtë e Maqedonisë duke mos përjashtuar edhe përgjegjësinë penale të personave zyrtarë të shtetit.
- Mbajtja e të dëbuarëve nga Kosova peng në vendkalimin kufitar të Bllacës, s'është

tjetër veç se një llogor përqëndrimi që nuk arriti ushtria Serbe ta bëjë ndaj shqiptarëve të Kosovës, me çrast shteti Maqedonas dashka apo s'dashka ka marrë përsipër të kryejë gjenocidin më të madh në të gjitha trojet e Ballkanit, po qe se nuk ndërmerret diçka urgjente në evitimin e kësaj katastrofe humanitare.

- Kjo tragjedi humanitare e popullit shqiptar të Kosovës të ikur nga zonat e luftës në Maqedoni i vuri në një sprovë të madhe, si shtetin maqedonas, po ashtu edhe Shqiptarët se sa janë të gatshëm dhe të organizuar për të kaluar prej fjalëve në vepra, po ashtu edhe bashkësinë ndërkombëtare e vuri në sprovë se sa është e gatshme të angazhohet në tejkalimin e kësaj katastrofe që u kanoset refugjatëve në kufirin e Bllacës.

- Meqenëse gjatë strehimit ose vendosjes së refugjatëve shqiptarë nga Kosova janë ndarë anëtarët e familjeve dhe janë dërguar në vende të ndryshme, me ç'rast është krijuar një huti e madhe te ata familje, prandaj apelojmë te organizatat dhe organet që janë të ngarkuara me këtë detyrë të bëjnë ç'mos që të mënjanojnë këto gabime duke u mundësuar familjeve vendosje të tërësishme me çka do të kontribuonin në qetësimin e shpirtërave edhe ashtu të trazuar.

- Forumi Demokratik konsideron se raporti në fjalë rreth kësaj tragjedie humanitare nuk ka mundur ta përfshijë gjithë atë çka ka ndodhur si shkelje të rënda të parimeve dhe të dokumenteve ndërkombëtare humanitare, për atë do të përgatitet një raport tjetër, sepse kjo tragjedi me elemente të gjenocidit dhe krimin ndaj njerëzimit kërkon të ndriçohet nga shumë aspekte.

Duke u nisur nga kjo, Forumi Demokratik u drejtohet të gjitha institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, duke apeluar për një angazhim, ndofta të fundit, për gjendjen shumë të rëndë humanitare në fund të shekullit XX. Do të jetë irelevante të kërkohen fajtorët, sepse sipas fakteve të prezantuara shihet qartë se fajtori kryesor i kësaj tragjedie dhe katastrofe humanitare është komplet Establishmenti maqedonas në Maqedoni.

Lidhur me eksodin e dytë që po u kanoset rrefugjatëve shqiptarë nga Kosova të strehuar dhe të vendosur në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kryesisht në familjet shqiptare në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë, si dhe lidhur me qëndrimin e Qeverisë së Maqedonisë që me çdo kusht t'i deportojë një numër të madh të refugjatëve në shtetet tjera të Evropës perëndimore dhe SHBA-së. Kërkojmë nga Qeveritë e shteteve Evropiane dhe të SHBA-së që të mos përfillin kërkesën e Qeverisë Maqedonase për deportimin e refugjatëve në shtetet e tyre. Po ashtu kërkojmë nga subjekti politik shqiptar në Maqedoni e sidomos nga partneri i koalicionit Qeveritar PDSH-së që të ndërhyjë urgjentisht në ndalimin e deportimit të rrefugjatëve në shtete tjera të mbeten në Maqedoni. Nëse kjo do të jetë e pamundur atëherë organizata janë mbështet qëndrimin e Republikës së Shqipërisë për pranimin e një numri të konsideruar refugjatësh në Shqipëri.

Prandaj kërkojmë nga Komisariati i OKB-së për refugjatët nga Komisariati i lartë i Këshillit të Europës dhe Komisioni i OKB-së për të drejtat e Njeriut që të ndërmarrin veprime të ngutshme për tejkalimin e situatës së rëndë me refugjatët nga Kosova, si dhe të ngrenë zërin e arsyes, duke protestuar ndaj shtetit Maqedonas për mospërbajtjen e obligimeve që dalin nga dokumentet ndërkombëtare humanitare dhe të të Drejtave të Njeriut.

Angazhimi Juaj do të ndihmonte si në tejkalimin e kësaj tragjedie, po ashtu edhe

në ndriçimin e shkaqeve që sollën deri në këtë katastrofë humanitare të refugjatëve në Maqedoni.

Forumi Demokratik për Mbrojtjen
e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
Në Maqedoni
Kryetar
Prof. Milaim Fejziu

Gostivar, më 6.IV. 1999

RAPORT

I FORUMIT DEMOKRATIK PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË MAQEDONI-GOSTIVAR LIDHUR ME NGJARJET PAS 9 KORRIKUT 1997 DHE PROCESET GJYQËSORE

Organizata jonë (FDMLNJM-Gostivar) me anë të këtij raporti dëshiron të shprehë

shqetësimin e thellë lidhur me masakrën dhe brutalitetin e njërive speciale policore të MPB-së dhe proceset e montuara politike gjyqësore e veçanërisht procesi dhe vendimi gjyqësor ndaj prefektit të Gostivarit Zot. Rufi Osmanit dhe Kryesuesit të Këshillit Komunal Zot.Refik Dautit.

Duke i dhënë këtij procesi gjyqësor prapavijë politike, duke manifestuar dhunë politike jashtë mase në ngjarjet e Gostivarit dhe Tetovës, duke ndërrmarë veprime antishqiptare, Qeveria maqedonase dhe MPB-ja jo vetëm që nuk respektuan normat ligjore dhe humane por me këto veprime krijuan tragjedinë e Gostivarit me çrast u suspendua "shteti juridik" pa shpallur zyrtarisht gjendje të jashtëzakonshme, gjë që ka patur për qëllim fshehjen e dhunës dhe brutalitetit policor ndaj shqiptarëve dhe turqve kundrejt faktorit ndërkombëtar nga njëra anë dhe për t'i kënaqur disa forca politike shoviniste maqedonase nga ana tjetër .

Për brutalitetin e policisë në ditën kritike në Gostivar dhe Tetovë dhe më pas flasin dëshmitë relevante që disponon FDMDLNI. Sipas deklaratave zyrtare njësitë speciale policore në Gostivar kanë harxhuar mbi 2800 plumba (municion) kurse realisht janë harxhuar tre herë më shumë.Për këtë dëshmojnë shtëpitë e pronarëve ku mund të shihen gjurmat e plumbave dhe numri i madh mbi 50 të qytetarëve të plagosur.

Për ilustrim po përmendim disa pronarë të shtëpive: Baftjar Shabani Rr "B Gjnoski p.n", Menfi Sagiri Rr "B.Gjinovski nr. 24",Bujar Agai Rr. "N.Parapullovi p.n", në lokalet e vëllezërve Kujtim dhe Sani AliGega .në rrugën "JNA", Gajur Demiri Në Rr."JNA p.n", gjithashtu në Rr."Koço Xoxe" sjellje barbare dhe çnjerëzore ndaj Isa Rexhepit, Adem Rexhepit, Islam Mehmetit, Halit Jasharit, Qazim Gjakovicës, Jashar Koçit, Dilaver Zylfiqarit, Enver Hasanit me familjen, Shinazi Azizit me familjen dhe të tjerë.

Gjatë këtij terrori policor është bërë edhe plaçkitja e qytetarëve. Këtë objektiv e kryen policët në masë të madhe duke mos lënë asnjë gjurmë, me këtë rast po përmendim disa qytetarë shqiptarë të plaçkitur: kështu Emërli Dautit nga Gostivari policia duke e kontrolluar ia merr 300DM, Besnik Nuredinit nga Gostivari ia merr 2500DM dhe 3000Den, Zabedin Sadikut ia merr orën e dorës, 13000DEN dhe 100Dm, Imer Zeqirit duke u kthyer nga puna e përkohëshme në Gjermani ia merr 20000DM, Xhevat Bejtës Sekretar i KK ia merr 23000DEN dhe 560DM, Sani Aligegës në vendin e punës policia ia merr 600DM, Shenazi Azizit ia merr 2300DM, Njazi Selmanit ia merr 100DM dhe 2000DEN kurse gruan e Halit Jasharit policia e detyron ta çel kasfortën shtëpiake por aty nuk gjen gjë për të marrë Gjithësej janë plaçkitur mbi 30.000Dem.

Dëshirojmë të theksojmë se të gjitha ndërhyrjet kanë qenë të përcjellura me dhunë nga ana e policisë nëpër shtëpi, banesa, lokale afariste dhe ambiente tjera. Një vandalizëm i këtillë llogaritet se ka shkaktuar dëme të mëdha materiale: thyerje të dyerve, dritareve të orendive dhe aparateve shtëpiake, thyerje të vitrinave dhe inventarit të dyqaneve si dhe demolimin të disa veturave në rrugë. Këto dëme vlerësohen mbi 1000.000Dm gjermane por është shumë vështirë që qytetarët shqiptarë të fitojnë kompensim për këto dëme. Organizata jonë është veçanërisht e shqetësuar nga fakti se vazhdojnë arrestimet dhe burgosjet paarsye nga rruga nga shtëpitë, lokalet afariste.

Nga kjo dhunë primitive nuk u kursyen as personat e paaftë gratë fëmijët, po përmendim rastin e një fëmije 12 vjeçar e cila rrihet nga policia deri në atë shkallë sa që nëna e vet nuk ka mundur ta njohë. Organizata jonë është e brengosur për mosrespektimin e ligjeve egzistuese ndaj personave që është ushtruar procedurë

kundërvajtëse dhe penale.

Gjykimet mbaheshin në prezencën e policëve të armatosur. Avokatët e tyre nuk kishin mundësi të paraqesin mbrojtje cilësore as të parashtronjë pyetje dhe të kontaktojnë me klientët e tyre gjatë procedurave gjyqësore. Policët e armatosur gjatë gjithë kohës kanë qëndruar para sallave të gjyimit duke ushtruar trysni psikike ndaj të pandehurve dhe dëshmitarëve me qëllim që me çdo kusht të vërtetohet fajësia e tyre. Për ilustrim po përmendim rastin e Sadri Demirit nga Vrapçishti të cilin policia e rreh para gjykatësit ndërsa gjykatësi e dënon me 60 ditë burg.

E gjithë kjo tregon se organet e juridikaturës kanë qenë të suspenduara dhe detyruara të shqiptojnë dënime me burg.

Lidhur me ngjarjet e Gostivarit në vazhdim në fillim po japim pasqyrën listën e personave të akuzuar dhe të dënuar edhe atë të 10 personave për vepra të rënda penale dhe 60 personave për vepra kundravajtëse.

Shumica e personave janë dënuar me burg efektiv: Rufi Osmani 13 vjet e 8 muaj, Refik Dauti 3vjet, Feti Uka 3vjet, Besim Musai 3 vjet, Velit Ismani 3vjet, Fari Ramadani 6 muaj, Izet Fidani 60 ditë, Salajdin Fidani 60 ditë, Musa Rexhepi 60 ditë, Jashar Pupi 60 ditë, Xhemail Jakupi 60 ditë, Qemal Ademi 60 ditë, Nevzat Bejta 60 ditë, Teki Abazi 60 ditë, Aziz Beqiri 60 ditë, Irfan Saliu 60 ditë, Zaim Vehapi 60 ditë, Agron Zeqiri 60 ditë, Ejup Osmani 60 ditë, Sait Osmani 60 ditë, Fuat Ameti 60 ditë, Mexhedi Neziri 60 ditë, Xhemail Aliu 60 ditë, Nasfi Ademi 60 ditë, Alush Tahiri 60 ditë, Zendel Behari, Fetush Dalipi 60 ditë, Sadri Demiri 60 ditë ndërsa Ilir Asllani, Mejsut Sejfuli, Nasir Ejupi, Fetih Neziri u është shqiptuar masa e parburgimit prej 30 ditësh kurse gjykimi ende nuk është mbajtur dhe këta janë liruar të mbrohen në liri. Po ashtu gjatë procedurës kundravajtëse janë dënuar me të holla në shumë prej 2000 denarësh mbi 30 persona. Emrat e të cilëve i disponon FDMDLNJ.

Deri më tani gjithsej janë shqiptuar dënime me burg 37 vjet e 4 muaj, ndërsa pritet që kjo shifër të jetë edhe më e madhe kur të përfundojnë edhe proceset e tjera gjyqësore. Duhet cekur se policia edhe më tutje vazhdon të marrë qytetarë në "biseda informative" dhe këto biseda shpesh shërbejnë si pretekst për të akuzuar vetëm e vetëm që të shpallet fajësia e tyre. Me këtë rast po theksojmë se thirrja në këto "biseda informative" është në kundërshtim me ligjin sepse ligji në fjalë ndalon rreptësisht thirrjen e qytetarëve në "biseda informative". Ajo që na brengos është fakti se procedurat gjyqësore nuk u zhvilluan sipas ligjit për procedurë penale, jo që nuk respektohen, por shkilen deri në fund.

Rasti i gjyimit të prefektit të Gostivarit Zot. Rufi Osmani dhe Kryesuesit Komunal Refik Dautit dëshmon qartë për lidhjen e ngushtë të pushtetit ekzekutiv me atë të pushtetit gjyqësor.

Gjykimi filloi më 1 shtator 1997. Kërkesa për lirim të pandehurit Zoti Rufi Osmani nga paraburgimi u refuzua me arsyetim se nuk janë plotësuar kushtet në bazë të Nenet 183 të ligjit të procedurës penale. Nji vendim i këtillë është i papranueshëm edhe për arsye se nuk justifikohen dyshimet eventuale për "përsëritjen e veprës" dhe të largimit nga vendbanimi. Vazhdimi i paraburgimit është i papranueshëm edhe nga shkakut se mungojnë provat të përpikta që mund të tregojnë largimin e të pandehurit. Vetë fakti që ai është Kryetar Komune i zgjedhur nga populli dhe ska garancë më e madhe se elektorati. Përveç kësaj mbrojtësit u thirrën në neni 110 të Kushtetutës së Maqedonisë i cili ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, neni 16 i cili bën fjalë

për lirinë e vetëdijes dhe neni 21 i cili bën fjalë për lirinë e veprimit të lirë gjatë kryerjes të funksioneve.

Organizata jonë dëshiron të tërheq vëmendjen se neni 50 i Kushtetutës së Maqedonisë parasheh në mënyrë mjaft të qartë të drejtën e mendimit dhe të shprehurit të lirë i cili nuk mund të kufizohet, ndërsa ndjekja penale e bazuar në nenin 319 dhe që ka të bëjë me "nxitjen e urrejtjes nacionale fetare racore" është në kundërshtim me Kushtetutën e Maqedonisë. Deklarimet politike dhe sjellja e një zyrtari që i përket një etnikumi sido që të jetë nuk mund të dënohet, jo vetëm për shkak se deklaratat e funksionarve janë praksë e zakonshme por për shkak se ato i takojnë sferës së mendimit dhe qëndrimit të një personi zyrtar.

Prandaj organizata jonë konsideron se deklaratat e Zotit Rufi Osmanit në asnjë mënyrë nuk mund të merren si veprime inkriminuese. Gjykimi vazhdoi me 10 shtator dhe zgjati deri më 17 shtator edhe atë duke filluar prej orës 9 e deri 21 pas dite. Një ditë para se të lexohet akt akuza mbrojtja u largua në shenjë proteste kundër procedurës të padrejtë që i'u zhvilloheshte dy zyrtarëve të lartë komunal.

Kjo protestë bazohej në një numër të madh të shkeljeve gjatë procedurës penale dhe të drejtave gjatë procesit gjyqësor, kurse shkelja më e madhe ishte që asnjërit nga 15 dëshmitarëve të mbrojtjes dhe të Zotit. Rufi Osmani nuk ju lejua paraqitja para gjyqit, kurse, të gjithë dëshmitarët që i propozoi prokurori u pranuan.

Është me rëndësi të përmendim se të gjithë dëshmitarët që ishin të propozuar nga zv.prokurori publik përveç njërit (kryeshef i policisë rajonale për Tetovë -Gostivar Vangjel Duroski) praktikisht folën në favor të pandehurve.

Një shkelje e rëndë gjatë kësaj procedure ishte se Rufi Osmani nuk iu dha akt akuza në gjuhën amtare edhe pse kodi penal i Maqedonisë (Neni 9 Alinea 3) parasheh përdorimin e gjuhës amtare në mënyrë obligative, ndërsa trupi gjykues rrefuzoi këtë kërkesë të ligjshme me arsyetim se i pandehuri e njej gjuhën Maqedonase.

Edhe pse Zoti Rufi Osmani Kambëngulte që para gjyqit të flasë në gjuhën shqipe kjo e drejtë, nuk iu mundësua për shkak se përkthyesit gjyqësor nuk e njohin mirë gjuhën shqipe dhe se gjatë kësaj procedure u ndërruan tre përkthyesë. Në fund Zoti Rufi Osmani U dënua me 13 vjet e 8 muaj burg (8 vjet për nxitje të urrejtjes nacionale racore dhe fetare, 4 vjet për organizim të rezistencës 3 vjet për mos zbatimin e vendimit të gjykatës Kushtetuese. Zoti Refik Dautit ju dha dënimi prej 3 viteve burg për moszbatimin e vendimit të gjykatës Kushtetuese.

Lirisht mund të konstatohet se ky proces gjyqësor do të hyjë në analet e Jurisprudencës për nga lëshimet dhe shkeljet që i bëri trupi gjykues i cili është më i thirrur që t'i respektojë normat e procedurës penale dhe "të ndajë drejtësinë". Po ashtu ky gjykim dëshmoi qartë se kur janë në pyetje shqiptarët u montohen vepra inegzistente nga ana e policisë dhe ata përçohen deri në marrjen e vendimit të prerë. Kjo dëshmon qartë se Maqedonia është shumë larg shtetit demokratik dhe është shndërruar në një shtet policor sepse policia është ajo që burgos, akuzon, dëshmon, dënon nën ombrellën e organeve të Judikaturës. Faktet e mësipërme flasin për këtë konstatim.

Duke e përfunduar këtë raport po theksojmë se ky raport në vete përmban një mori faktesh dhe argumentesh të rëndësishme dhe paraqet një pasqyrë reale dhe objektive si për ngjarjet tragjike po ashtu edhe për proceset skandaloze gjyqësore. Ky raport konsiderojmë se do të kontribuojë që në mënyrë të argumentuar të njoftohet opinioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar me të vërtetën se ç'ndodh në Maqedoni.

FDMDLNJM – GOSTIVAR
Kryetar
Prof. Milam Fejziu

Gostivar, më 24.IX.1997

RAPORT

LIDHUR ME NGJARJET E 11 JANARIT NË KOMUNËN E HARAÇINËS

Organizata jonë me anë të këtij raporti dëshiron të shprehë shqetësimin dhe brengosjen e thellë lidhur me vrasjen e tre pjestarëve të MPB-së dhe brutalitetin e vandalizmin e njësive speciale policore të MPB-së të kryera ndaj qytetarëve të pafajshëm shqiptar në Komunën e Haraçinës.

Raporti në fjalë është përpiluar nga dokumentacioni i grumbulluar nga aktivistët e FDMDLNJ, nga dokumentacioni i Këshillit të Komunës së Haraçinës si dhe nga deklaratat e publikuara në mediat e shkruara dhe burime të tjera.

Raporti përmban tre pjesë: kronologjia e ngjarjes, rregullativa ligjore shtetërore dhe ndërkombëtare që u referohet garantimit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet, dhe vlerësimet e organizatës sonë mbi shkeljet e rënda nga pjestarët e MPB-së në ngjarjen e Haraçinës ndaj qytetarëve që paraqesin shkeljet jo vetëm të të drejtave dhe lirive të njeriut por edhe mos respektim i rregullativës ligjore si shtetërore edhe ndërkombëtare.

I. KRONOLOGJIA E NGJARJES

Komuna e Haraçinës është një nga ish komunat e Shkupit që doli pas ndarjes së re territoriale, është e banuar me rreth 10.000, banorë ku afër 90 % janë shqiptarë, ndërsa 10 % janë maqedonë e të tjerë.

Më 11 janar 2000 në orën 22:³⁰ në afërsi të hyrjes në Komunën e Haraçinës në rrugën kryesore që lidh këtë komunë me Shkupin, persona të panjohur me armë zjarri vranë tre pjestarë të MPB-së, Erol Gotek, Ace Angellovski dhe Kiril Petrushevski ndërsa pjestari i katërt i policisë mbetet gjallë.

Pas incidentit policia bllokoi të gjitha vendkalimet kufitare ndërsa Komunën e Haraçinës për disa ditë e izoloi tërësisht nga pjesët e tjera të vendit. Me qindra policë, në mesin e të cilëve edhe njësitë e maskuara speciale, me autobllinda, dhe mjete tjera transportuese hynë dy ditë pas vrasjes në Haraçinë, me qëllim të kapjes së vrasësve të tre policëve. Me këtë rast, fillon gollgata e shumë familjeve të Haraçinës, rrahën brutalisht shumë haraçinas të pafajshëm, në mesin e tyre gra, pleq dhe fëmijë të mitur.

- Ndaj këtij brutaliteti, gjatë bastisjeve, oficalisht paraqitet se janë bastisur tetë familje, ndërsa realisht numri është shumë më i madh, reagon Kryesia e Këshillit Komunal, ndërsa një delegacion i saj së bashku me deputetin Ismet Ramadanin realizojnë një takim me ministren Dosat Dimovska me çrast shprehin revoltën e banorëve të komunës së Haraçinës ndaj dhunës së ushtruar nga ana e policisë.

MPB-ja lëshon kumtesë për opinion se janë arrestuar 5 (pesë) persona kundër të cilëve janë ngritur kallëzime penale për armëmbajtje pa leje dhe lëshim në treg të mjeteve narkotike në mesin e të cilëve ka të dyshuar për vrasjen e tre policëve, policia nuk arriti t'i gjejë as armët me të cilat është shtënë as veturën "Golf i bardhë", kështu aksioni i policisë fillon të shtrihet në vendet tjera të Maqedonisë.

- Më 13 janar policia ndërmerr aksion për arrestimin Sabri Hasanit, Albert Muçës dhe Lirim Dinaricën të cilët, siç u njoftua opinioni, u kapën në vilën e Sabriut në Mavrovë.

Me këtë rast duke i transportuar për në Shkup, sipas burimeve policore, vdes Sabri Hasani me shpjegimin se ka përjetuar infarkt.

Pas intervenimit të mjekësisë ligjore ai i dorëzohet familjes Hasani me çrast varroset në varrezat e fshatit dhe janë vërejtur lëndime të rënda trupore e sidomos në kokë është parë të ketë kaluar plumb nga armë zjari. Dy personat të tjerë që kanë qenë në vilën e Sabriut në Mavrovë janë dërguar në Spitalin Ushtarak në Shkup për shërim, supozohet se edhe këta persona kanë qenë të lënduar rëndë nga ndërhyrja e policisë, nuk iu lejua as familjeve të tyre ti vizitojnë në spital dhe është vërejtur se spitali është mbajtur nën rrethim me policë.

Për ndriçimin e kësaj ngjarje në Haraçinë, sipas burimeve të policisë, në "biseda informative" janë marrë mbi 200 qytetarë shqiptarë.

Policia duke dashur të ndriçojë sa më shpejt vrasjen e tre policëve shkaktoj rastin e katërt të Sabri Hasanit, i cili duhet të ndriçohet po ashtu nga organet kompetente, në të kundërtën mbetet dyshim i bazuar se e gjithë kjo ka konotacion të vrasjes.

Të arrestuarit, në mesin e të cilëve ka pasur edhe të mitur, shumica që janë marrë në "biseda informative" nuk janë kthyer por kanë vazhduar të mbahen në arrest ka katër pesë ditë, edhe pse sipas ligjit procedura policore mund të zgjasë vetëm 24^h.

Gjatë procedurës policore të gjithë dëshmojnë se policët e maskuar duke i rrahur dhe keqtrajtuar në mënyrën më çnjerëzore kanë dëgjuar fjalën "do të pendohesh se je shqiptar". Këtë fjalë e ka dëgjuar gati cdo njeri që me ditë të tëra është rrahur nëpër stacionet policore të Maqedonisë, ndërsa arsye nuk e di askush përveç policëve të maskuar në uniformë ose pa të.

Sipas burimeve tona bastisjet e shtëpive shqiptare në Haraçinë dhe vende tjera janë bërë me forma brutale dhe vandalizëm të paparë, duke demoluar mobilje dhe orëndi të ndryshme shtëpiake. Në asnjë familje ose shtëpi e bastisur policia nuk ka lënë dokumentacion zyrtar zakonisht procesverbal nga bastisja e bërë nënshkruar nga përgjegjësi i policisë dhe nga kryefamiljari, gjatë bastisjes policia është e obligueshme të sigurojë edhe një palë të tretë rëndom qytetar të rastit. Nuk përjashtohet që policia të ketë siguar vendim gjyqësor, por ai vendim nuk është prezantuar në asnjë rast të bastisjeve fakt që lë mundësi për të dyshuar, se a ka patur policia dokument për të bërë bastisje?

Sipas zyrtarëve të policisë "në Araçinë janë bastisur vetëm tetë shtëpi, policia ka qenë korrekte gjatë kryerjes së punës së saj me urdhër të gjykatës hetuese, numri i të arrestuarëve dhe i atyre që janë marrë në ashtuquajtura biseda informative ka qenë diku mbi 200 persona", "dhuna ndoshta është ushtruar, por vetëm mbi ata që kanë bërë rezistencë" Megjithatë, dëshmitë flasin krejtësisht ndryshe si ato që kanë kaluar nëpër stacionet e policisë po ashtu edhe ato të familjeve: Hasani, Emini, Mustafa, Dinarica etj. ka patur raste që pas brutalitetit dhe vandalizmit të ushtruar nga forcat policore të dëgjohet fjala "më fal" ose "na falni se kemi qenë gabim".

Hetimet e deritashme të MPB-së për ndriçimin e vrasjes së tre policëve përfunduan me ngritjen e 11 kallëzimeve penale. Prej këtyre katër (4) persona akuzohen sipas nenit 123 alinea 2 pika 6 e kodit penal me të cilën ato ngarkohen për "vepër penale vrasje", ndërsa 7 të tjerët për pjesëmarrje në vrasje.

Të gjithë të akuzuarit janë shqiptarë dhe se shumica e tyre janë nga Haraçina, ndërsa njëri ndodhet në arrati.

II. RREGULLATIVA LIGJORE SHTETËRORE DHE NDËRKOMBËTARE

Duke dashur që ky raport të ndriçojë veprimet e ndërmara nga MPB-ja në ngjarjen e Haraçinës do të paraqesim rregullativën ligjore ku garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut në Kushtetutë, ligjin për punë të brendshme dhe dokumentet ndërkombëtare që duhet t'i respektojnë edhe MPB-ja.

1. Kushtetuta e Maqedonisë:

Neni 9 "Qytetarët e R. së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale,

bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore”.

Neni 10 ”Jeta e njeriut është e pacënueshme”.

Neni 11 ”Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacënueshme. Ndalohet çdo formë e mundimit e sjelljes dhe dënimit jo njerëzor dhe nënçmues”.

Neni 12 al. 3. ”Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria me doemos të njoftohet për shkaqet e thirrjes, arrestimit ose privimit të tij nga liria dhe me të drejtat e tij të caktuara me ligj dhe prej tij nuk mund të kërkohej deklaratë.

Personi ka të drejtë për mbrojtje në procedurën policore dhe gjyqësore. Personi i privuar nga liria me doemos menjëherë e më së voni në afat prej 24^h orësh nga momenti i privimit nga liria të paraqitet para gjykatës e cila pa anullim të vendosë për ligjësinë e privimit nga liria”

Neni 25 ”Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së fjalës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe autoritetit”.

Neni 26 ”Garantohet pacënueshmëria e shtëpisë”.

”E drejta e pacënueshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve”.

Neni 39 ”Çdo qytetari i garantohet e drejta e mbrojtjes shëndetësore.

Qytetari ka të drejtë dhe detyrë që ta ruajë dhe ta përparoj shëndetin e tij dhe shëndetin e të tjerëve”.

Neni 54 ”Liritë dhe të drejtat e njeriut mund të kufizohen vetëm në ratstet e caktuara në Kushtetutë.

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit mund të kufizohen gjatë kohës së luftës ose të gjendjes së jashtëzakonshme sipas dispozitave të kushtetutës. Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk ka të bëjë me të drejtën e jetës, ndalimin e mendimit, veprimit jo njerëzor dhe nënçmues dhe të dënuar, në përcaktueshmërinë juridike të veprave të dënueshme dhe dënimeve,

si dhe të lirisë së bindjes, ndërjegjes, mendimin e shprehjes publike të mendimit dhe predikimit fetar”.

2. Ligji për punë të brendshme i vitit 1995 në dispozitat e përgjithshme përcakton qëllimet dhe detyrat e MPB-së.

Neni 1 – ”Mbrojtja e jetës, sigurisë personale dhe pasurinë e qytetarëve”.

- ”Pengimi i kryerjes së veprave penale”.

- ”Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të garantuara me kushtetutë”.

Neni 7 ”Punëtorët e ministrisë janë të obliguar në kryerjen e punëve dhe detyrave të mbrojnë dhe ruajnë pasurinë e qytetarëve, të respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarëve dhe ti aplikojnë në mënyrë të rregullt vetëm me masa dhe mjete të dhunshme që janë rregulluar me këtë ligj ose normë tjetër”

Neni 35 ”Personi i autorizuar zyrtar do të përdor armë zjari, kur me mjete tjera të dhunëshme nuk mund:

1. Të mbrojnë jetën e qytetarëve;

2. Të pengojë sulmin e drejtëpërdrejtë me të cilin rrezikohet jeta e tij....”

Neni 37 ”Para përdorimit të mjeteve të dhunshme ose armë zjarri në rastet e neneve 34 dhe 35 të këtij ligji, personi i autorizuar zyrtar është i detyruar që ta bëjë me

dijeni të zëshëm personin ndaj të cilit do ta përdorë mjetin ose armën.

3. Nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut do t'i përmendim:

Deklarata Universale për të drejtat e njeriut (OKB-së).

neni 3 "Çdo individ ka të drejtë në jetë, në liri dhe në sigurinë".

neni 5 "Askush nuk do të jetë i nënshtruar torturës as mundimeve ose trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese".

neni 9 "Askush nuk mund të arrestohet në mënyrë arbitrare, i privuar"

neni 12.....

2. Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike.

neni 6 a1.1,2,3

neni 7; neni 8 pika 1,2,3'; neni 9 pika 1.2.3.4.5 neni 10 pika 1, 2,3.

3. Konventa mbi të drejtat e gruas (femrës)- – 1981

neni 5; neni 7.neni 8; neni 11 pika 1, 2.

4. Konventa mbi të drejtat e fëmijëve- - 1990

neni 2; neni 3; neni 4; neni 5; neni 9; neni10.

5. Konventa evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

neni 2; neni 3; neni 4; neni 5; neni 7dhe 8.

6. Konventa kornizë për të drejtat e pakicave kombëtare.

neni 4 pika 1; neni 6 pika 1,2; neni 10, neni 23.

Të gjitha këto dokumente ndërkombëtare të lartpërmendura i ka ratifikuar R. e Maqedonisë me çka ka krijuar obligim për zbatimin e tyre në legjislativën shtetërore.

III. VLERËSIM I ORGANIZATËS SONË LIDHUR ME KËTË NGJARJE.

Nga kjo që u tha më lartë Forumi Demokratik për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Maqedoni vlerëson se:

1. Është koha e fundit që të demistifikohet ngjarja e Haraçinës nga shumë aspekte sepse shpallja e shqiptarëve si popull fajtor dhe destabilizues i maqedonisë dhe ndarja e thelluar në mes shqiptarëve dhe maqedonasve mund të ketë pasoja të paparashikueshme.

Nuk duhet të lejohet që në hesap të hetimeve të 11 të akuzuarëve të ndërmerren kësisoj veprimesh që do t'i rrënojnë edhe ato pak'marrëdhënie ndërnacionale të tolerueshme dhe se duhet ndaluar atmosfera e krijuar hakmarrëse ndaj shqiptarëve si komunitet vetëm e vetëm se të akuzuarit janë pjesëtarë shqiptarë.

2. Pjesëtarët e MPB-së me veprimet e ndërmarra në Komunën e Haraçinës, jo vetëm që kanë tejkaluar autorizimet e veta, siç janë arrestimet arbitrare, kidnapimet dhe marrja në "biseda informative", dhe mbajtja jashtë kohës së paraparë me Kushtetutë dhe ligj, brutaliteti çnjerëzor dhe vandalizmi i ushtruar ndaj të arrestuarve dhe bastisjeve të shtëpive të tyre, por kanë shkelë rëndë Kushtetutën e R M. dhe dokumentet më të

rëndësishme ndërkombëtare që u referohen të drejtave dhe lirive të njeriut.

3. Ky veprimi MPB-së nuk mund të konsiderohet thjesht si jo përgjegjësi e individëve të MPB-së që kanë vepruar kokë më vete, por si përgjegjësi e organeve të MPB-së, të cilët kur janë në pyetje shqiptarët dhuna dhe brutaliteti çnjerëzor arsyetohet edhe nga qarqet më të larta shtetërore dhe politike dhe shqiptarët i trajtojnë si armiq të këtij shteti gjë që u manifestua edhe në rastin konkret e kjo duhet ta brengos jo vetëm Qeverinë e Maqedonisë por edhe bashkësinë ndërkombëtare.

4. Vdekja misterioze e Sabri Hasanit me shpjegimet banale se ka vdekur nga infarkti, duhet të ndriçohet sa më shpejt nga organet kompetente sepse mbyllja e kësaj dosje është e pamundur, pasi që ka dëshmitar të gjallë që mund të rekonstruojnë ngjarjen e kopjes së tij në mavrovë dhe fajtorët të nxirren para organeve të drejtësisë, në të kundërt ky rast dëshmon qartë se si policia jo vetëm që ushtron dhunë por merr kompetencat e organeve tjera duke dëshmuar se ajo vet akuzon, vet gjykon, vet shqipton dënime edhe vet egzekuton vendimet edhe me vdekje, kjo paraqet një nonsens në praktikën policore dhe kërkon urgjentisht të ndërpritet një veprim i këtillë në të kundërt ska shtet juridik por ka vetëm shtet policor.

5. Pa nevojë është përdorur forca fizike përtej mase që paraqet sjellje degraduese dhe johumane, si për të arrestuarit po ashtu edhe për familjet e bastisura, tejkalimet e tilla jologjore duhet të ndëshkohen. Ajo që na brengos është se e gjithë kjo nuk është bërë për shkak të hetuesisë së aktit kriminel, por ka në vetvehte elemente hakmarrës të pjestarëve të MPB-së

Forumi Demokratik konsideron se raporti në fjalë rreth kësaj ngjarjeje nuk ka mundur ti përfshijë të gjitha rastet dhe të gjitha dukuritë, dhe se ky numër i prezantuar në pjesën e parë është shumë më i madh se ky që prezentohet në raport. Duke u nisur nga këto fakte Organizata jonë u drejtohet të gjitha organeve më të larta shtetërore dhe politike për një angazhim konkret në demistifikimin e kësaj ngjarjeje duke e trajtuar me seriozitetin më të madh dhe me urgjencë duke ndërhyrë në MPB për të zbuluar fajtorët e kësaj ngjarjeje.

Prandaj kërkojmë që Qeveria dhe Parlamenti të debatojnë rreth ngjarjes në Haraçinë dhe të kërkojnë përgjegjësi në MPB duke filluar nga polici më i rëndomtë e deri te Ministri për lëshimet, gabimet dhe tejkalimet e kompetencave të pjestarëve të MPB-së, si dhe të nisen hetime për vdekjen e Sabri Hasanit nga ana e prokurorisë publike duke mos pritur kallëzim penal nga MPB-ja dhe nga subjekte tjera por këtë ta ndërmarrë me vetë iniciativë, sepse e ka për detyrë.

Forumi Demokratik për Mbrojtjen e të
Drejtave dhe Lirive të Njeriut në
Maqedoni-Gostivar
Kryetar

Gostivar, më 1.II.2000

Prof.Dr. ADEM TAMO

TRAUMA TE SHQIPTARËT NË NJË PERSPEKTIVË SOCIAL PSIKOLOGJIKE

I. REAGIMET E PËRGJITHSHME TË TË RRIURVE NDAJ NGJARJEVE TRAUMATIKE ²

1. Reagimet emocionale: shokim, mosbesim, zemërim; tërbim, terror, faj, humbje,

² Meichenbaum, po aty, f.34-35, ² Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, Fourth Edition, Copyright 1994, American Association

- lëndim, irritim, pafuqi, frikë, ankth, depresion, trishtim, mjerim, armiqësi, dëshpërim, makth, frikë braktisjeje, frikë vetmie.
2. Reagimet kognitive: dëmtim i përqëndrimit të vëmendjes, konfuzion, vetëfajësim, çorientim, ulje e vetvlerësimit, frikë se mos humbet vetkontrollin, pushtim nga kujtime a imazhe të ngjarjeve traumatike.
 3. Reagimet biologjike: lodhje, pagjumësi, llahtarisje, reaktivitet, ankesa psikosomatike.
 4. Reagimet sjellore: shmangie, tëhuajsim, tërheqje sociale, rritje e stresit në marrëdhëniet, abuzim me substancat, kërkim sensacionesh, dëmtim i aftësive profesionale, sjellje regresive.
 5. Reagimet karakterologjike: deformime të marrëdhënieve të stabilizuara, deformime të identitetit.

II. KRITERE TE DSM-IV PËR ÇSPT²

Pavarësisht prej reagimeve të mësipërme që mund të bëjë njeriu, prezenca e këtyre reagimeve nuk do të thotë se kemi të bëjmë automatikisht me ÇSPT. Për të pasur ÇSPT janë përcaktuar kriteret.

A. Personi i është ekspozuar një ngjarjeje traumatike në të cilën janë prezente:

Personi është ballafaquar, ka qënë dëshmitar apo ka përjetuar kërcënim me vdekje, plagosje serioze, ose kërcënim të integritetit fizik të tij ose të të tjerëve pranë. Reagimi i personit shpreh frikë, pafuqi ose tmerr. Vini re: te fëmijët kjo shprehet në formën e sjelljes së çorganizuar ose të axhituar.

B. Ngjarja traumatike rijetohet në mënyrë këmbëngulëse të paktën në njërën nga rrugët e mëposhtme:

1. Pushtim nga kujtime të këqija të ngjarjes, përfshirë edhe imazhe, mendime ose perceptime. Vini re: në fëmijët e vegjël mund të vihet re lojë përsëritëse në të cilën shfaqen tema ose aspekte të traumës.
2. Shikim ëndërrash të këqija herë pas here. Vini re: tek fëmijët kjo mund të shprehet në formën e llahtarisjeve nga ëndrra që nuk mbahen mend. Veprim ose përjetim sikur ngjarja traumatike po ndodh tani. Tmerr i madh psikologjik në rastin e ekspozimit ndaj sinjaleve të brendshme ose të jashtme që simbolizojnë ose i ngjajnë një aspekti të traumës. Reagim fiziologjik në rastin e ekspozimit ndaj sinjaleve të brendshme ose të jashtme që simbolizojnë ose i ngjajnë një aspekti të traumës.

C. Shmangie këmbëngulëse e ngacmuesve që kujtojnë traumën dhe mpirje e aftësisë të përgjithshme për të reaguar (kjo duhet të mos ketë ekzistuar para traumës), gjë që duhet të vihet re në prezencën e të paktën tre prej shtatë sjelljeve të mëposhtme.

1. Përpjekje për të larguar mendimet, ndjenjat ose bisedat që lidhen me traumën.
2. Përpjekje për të shmangur aktivitete, vende ose njerëz që të

- kujtojnë taumën.
3. Paaftësi për të kujtuar një aspekt të rëndësishëm të traumës.
Rënie e dukshme interesi ose mospjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme.
Ndjenja detashimi ose largimi nga të tjerët.
Afeksion i kufizuar (paaftësi për të dashuruar).
Ndjesi e humbjes së perspektivës (nuk pret më të bëjë karrierë, të martohet, të ketë fëmijë a një jetë normale)

D. Simptoma përsëritëse në rritje të eksitimit (që nuk viheshin re para traumës) që shfaqen të paktën me dy nga simptomat e mëposhtme.

Vështirësi për të rënë në gjumë ose për të qëndruar zgjuar
Irritim ose shpërthime zemërimi.
Vështirësi në përqëndrimin e vëmendjes.
Vigjilencë e ngritur e ruar dhe e papritur
Reagim i ekzagjeruar dhe i papritur.

E. Kohëzgjatja e çrregullimit (simptomat në kriterin B, C, dhe D) është më shumë se një muaj.

F. Çrregullimi shkakton rrezik të madh klinik ose dëmtim të funksionimit social, funksional apo dhe të aspekteve të tjera të rëndësishme.

Specifiko nëse:

Çrregullimi është akut: nëse kohëzgjatja e simptomave është më pak se tre muaj.
Çrregullimi është kronik: nëse kohëzgjatja e simptomave është më shumë se tre muaj.
Çrregullimi ka shpërthim të vonuar: nëse simptomat vihen re të paktën gjashtë muaj pas veprimit të stresorit.

III. PËRFUNDIMET MË TË SHËNUARA PËR ÇSPT DERI SOT

1. Problemet që njerëzit përjetojnë pas ngjarjesh traumatike³ dhe që lidhen me ngjarjen e jetuar janë të dukshme, të dallueshme. Simptomat më të dukshme janë: mendimet, ndjenjat dhe imazhet që të pushtojnë papritur. Njeriu ka frikë të flejë vetëm, ka frikë nga gjërat që i kujtojnë traumën, ndjen dhimbje në vende të ndryshme të trupit, shfaq sjellje regresive, shfaq agresivitet dhe rikrijon shpesh atë që i ka ndodhur, humbet aftësinë për të përqëndruar vëmendjen, ka frikë se mos vdes, shqetësohet për sigurinë e të tjerëve, mbyllet në vetvete.

³ Joseph, Stephen, Williams Ruth, Yule William, "Understanding Post-Traumatic Stress: a Psychosocial Perspective on PTSD and Treatment", John Wiley & Sons, Chichester et al., 1997.

2. Megjithëse janë bërë mjaft rishikime të kriterëve për diagnostikimin e ÇSPT që prej 1980 përsëri debatohet për simptomatologjinë e çrregullimit dhe të përkufizimit të traumës. Vitet e fundit vihet re një prirje që vlerëson shumë rolin e perceptimit subjektiv në çrregullimin që lidhet me traumën dhe se ka një prirje që ÇSPT të shihet si një fenomen me natyrë shumëplanëshe. Bën përshtypje fakti se ndaj traumës reagojnë me të njëjtat modele si të rriturit ashtu edhe të miturit, por edhe fakti se të rriturit kanë prirjen që t'i nënvleftësojnë reagimet e fëmijëve.

3. Studime të tjera kanë vërtetuar se të mbijetuarit shpesh përjetojnë reagime pozitive e negative dhe është e nevojshme të kemi të dhëna të tjera për ndryshimet që të mbijetuarit përjetojnë. Ka disa të dhëna që ndryshimet pozitive në pamjen e jashtme janë të zakonshme pas disa ngjarjeve. Madje disa herë të mbijetuarit pranojnë se eksperiencat e tyre të ngjarjeve traumatike kanë qenë të dobishme në disa aspekte për ta.

4. Deri më sot njihen disa ngjarje tipike që çojnë në ÇSPT. Dihet gjithashtu se ngjarje të ndryshme çojnë në nivele dhe modele të ndryshme çrregullimi. Deri më sot njihet gjithashtu se ngjarje të tilla si epidemiologjite, fatkeqësitë natyrore (tërmete, zjarre, vullkane, përmbytje, etj.), fatkeqësitë teknologjike, lufta, përdhunimet, dhuna politike, fetare, etnike, etj. prodhojnë çrregullime të ndryshme. Ngjarjet tipike që shkaktojnë ÇSPT perceptohen përgjithësisht si ngjarje të cilave nuk kemi ç'u bëjmë.

5. Trauma e zgjatur dhe e përsëritur mund të çojë në ndryshime të thella të personalitetit dhe në këtë rast shkon shumë termi i përdorur "çrregullim posttraumatik i stresit".

6. ÇSPT shihet në disa këndvështrime teorike. Këto janë:

a. "proçesimi emocional": njeriu pas traumës e proçeson atë në mënyrë të tillë saqë arrin të mos reagojë më emocionalisht ashtu si reagoi në fillim. Ngjarje të ngjashme si trauma e pësuar atij nuk i bëjnë më përshtypje. **b.** *teoria e kushtëzimit*: sipas kësaj teorie njeriu i traumatizuar e lidh traumën me reagimet emocionale negative, prandaj kjo lidhje ruhet dhe njeriu u shmanget gjërave që i kujtojnë traumën dhe shmang kujtimet mbi të. **c.** *pafuqia e mësuar*: trauma e pësuar ka një ndikim kaq të fortë mbi individin saqë ai humbet tërësisht besimin se mund t'i shpëtojë fatalitetit të traumave ose gjërave të ngjajshme. Ai mëson të jetë i pafuqishëm dhe nuk bën më reagime mbrojtëse. Kjo vepron me forcë sidomos kur trauma është e paparashikueshme dhe kur nuk mund të kontrollohet.

7. Të gjitha modelet kanë pikat e tyre të forta e të dobëta për shpjegimin e fenomeneve të reagimeve posttraumatike. Prandaj sot njihen disa përpjekje për të integruar dhe rikonceptuar disa modele të hershme. Këto përfshijnë modelin psikosocial i cili e vë theksin në rolin e mjedisit social për adaptimin e individit pas traumës. Modeli psikosocial e vë theksin në bashkëveprimin e disa elementeve mjedisore, personale dhe sociale për të prodhuar simptomat.

8. Rëndësi ka të bëhen dallime midis ripërjetimit të materialit kognitiv të aspekteve të ngjarjes traumatike dhe preokupimit për ngjarjen dhe reagimet emocionale. Gjithçka mund të ndikohet nga personaliteti i individit, mënyra e perceptimit, teknikat e përballimit të tij, dhe mjedisi social.

9. Studimet kanë vënë re se reagimet emocionale pas traumës janë në vartësi të mënyrës se si i atribuon klienti. Është vënë re se atribuimi i brendshëm lidhet me mendime intruzive, depresion dhe ankth, ndërsa atribuimi i jashtëm lidhet me më pak lëndim emocional.

10. Studimet kanë vënë re gjithashtu një lidhje midis historisë së problemeve psikologjike dhe mjerimit pas traumës. Ky efekt është më i madh kur intensiteti i traumës është më i vogël.

Pas pak do të paraqes disa ide të cilat përbëjnë jo rezultate përfundimtare të kërkimeve të kryera, por vetëm hipoteza që mund dhe duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kritik. Po i paraqes me synimin e vetëm të nxis diskutimin.

IV. EKSPERIENCA E NDËRHYRJES PSIKOLOGJIKE PËR TË TRAUMATIZUARIT KOSOVARË

Refugjatët kosovarë pësuan trauma nga më të ndryshmet: ata u goditën fizikisht, ata panë skena vrasjesh dhe bombardimesh, ata u ndanë forcërisht nga të afërmit, ata përjetuan dhunë verbale, atyre iu vodhën dhe shkatërruan shtëpi, prona e dokumente, ata dëgjuan zhurma të tmerrshme, ata përjetuan konsumim fizik (ecje të gjata, mungesë uji dhe ushqimi, lagur nga shiu), ata nuk dinin për anëtarët e tjerë të familjes ku ishin dhe si ishin, ata nuk dinin a do të ktheheshin ndonjë ditë në shtëpitë e tyre, ata nuk e merrnin dot me mend zgjidhjen që do të jepte komuniteti ndërkombëtar për ta. Ata kishin në radhë të parë nevojë për ushqim, ujë, rroba, strehë, ilaçe, mbështetje psikologjike.

Në planin psikologjik u vu re një fillim i pëlqyeshëm: të dëbuarit u vizituan nga qytetarë të panjohur, një masë e madhe e tyre u mbajtën dhe jetuan bashkë me familje shqiptare nga Shqipëria, ata u nxitën të flisnin për atë që u kishte ndodhur dhe reagimin që kishin bërë. Në fakt këtu kemi të bëjmë me një model adaptimi social psikologjik⁴. Kjo gjë duket edhe në karakterin e nevojave që kishin të dëbuarit kosovarë dhe në mënyrën se si u plotësoheshin ato: u bënë përpjekje të vendosen kontakte me pjesëtarët e tjerë të familjes (telefona, radio, gazeta, stenda) e të mbroheshin nga dhuna “e butë” e medias; u pikasën rastet që kërkonin një ndërhyrje individuale ose grupale psikologjike ose psikiatrike më të studiuar; u parapa se disa do të kishin rastin të shihnin trupat e vdekur të të afërmeve, se disa do të duhej të ndihmonin në identifikimin e trupave të dekompozuar në varret masive; se për disa do të duhej të mundësohej çlirimi emocional në një mjedis mbështetës. U penguan përpjekjet për t'i ndarë familjet e zgjeruara kosovare në favor të respektimit të dëshirës së anëtarëve të tyre për të qëndruar bashkë. U nxit prirja e vënë re për vetshërbim e për strukturim të jetës në kampet ku të dëbuarit kosovarë ishin sistemuar.

⁴ Michenbaum Donald, “Treating Post-Traumatic Stress Disorder: a Handbook and Practice Manual for Therapy” Wiley, Chichester, Canada, 1994

Të gjitha këto elemente flasin për përdorimin e një modeli të adaptimit social psikologjik. Kjo eksperiencë e grumbulluar mendoj se ndihmon të kuptohet se traumatizimi njerëzor mund të përballohet më me lehtësi në një situatë të caktuar sociale, ndërsa në një situatë tjetër ai trajtohet me më shumë vështirësi.

V. SFONDI SOCIAL PSIKOLOGJIK I TRAUMATIZIMIT

Pse në rastet e diagnostikimit me DSM nuk rezulton të kemi simptomat e ÇPTS?
Kemi lindur të imunizuar apo si?

Pse nuk bëjmë dot ashtu si duhet punë grupi?

Pse ka rezistencë që trauma të bëhet publike?

Nga vjen gjithë ajo aftësi që ta luash rolin e të traumatizuarit aq mirë?

Më duhet ta them që në fillim se këtyre pyetjeve do të na duhet kohë për t'iu përgjigjur në mënyrë më të plotë. Megjithatë që tani mund të thuhet disa gjëra:

Populli ynë jeton prej shekujsh brenda një kulture dhunuese e traumatizuese. Nuk është e huaj për kulturën tonë që i rrituri të dominojë të miturin, që mashkulli të dominojë femrën, që i pasuri të dominojë të varfërin, që i arsimitari të dominojë të paarsimituarin, që i forti të dominojë të dobëtin, njëri komb të dominojë tjetrin, institucioni të dominojë individin. Rezultati: kemi vetëm një president dhe ne të gjithë ndjehemi mbretër.

Brenda kësaj kulture kam përshtypjen se jetojnë, pak a shumë, të gjithë shqiptarët e Ballkanit. Kjo kulturë brenda së cilës ne rritemi transmetohet tek ne pa qenë nevoja ta vrasim mendjen posaçërisht për ta transmetuar. Ajo përçohet nga njeri brez në tjetrin. Ne rritemi, arsimohemi, forcohem, pasurohem duke vënë në jetë elementët e një projekti të madh të cilin ne e mbartim me vete nga koha në kohë. Kjo trashëgimi duhet ta pranojmë është mjaft dhunuese e traumatizuese. Pastaj krahas saj e paralel me këtë dhunë tonën për njeri tjetrin ne kemi përjetuar edhe dhunën e të tjerëve: dhunë sistematike etnike e pushtuesve nga etni të tjera. Ne kemi një histori dramatike pushtimesh, kryengritjesh, rebelimesh, revolucionesh dhe përkatësisht nënshtrimesh, mposhtjesh, shpartallimesh, kundërrevolucionesh. Për mua nuk ka çudi se si populli ynë, më i varfëri i Evropës, që u gri me kallashnikovë në vitin 1997, të tregonte atë gjest kozmik bujarie në vitin 1999 kur priti gjysëm milionë kosovarë të dëbuar.

Po pse nuk jemi shkatërruar tërësisht, meqë qenka kështu? Ndoshta sepse geni i mbijetesës na ka ndihmuar të ndërtojmë disa mekanizma kolektivë rezistence:

1. Aftësinë për jetë dyfishe. Një jetë për vete e për familjen, e një tjetër për mëhallën e për shoqërinë. Ne nuk jemi aq koherentë në këto dy dimensione të mëdha të jetës njerëzore. Këtë ne ia njohim vetes: kemi tryeza shumë të varfëra, por kostume shumë të bukura; vuajmë së brendshmi e tregojmë dinjitet së jashtmi, në shtëpi na dominojnë gratë e në mëhallë shesim mend se jemi burra zamani e sundojmë gjithë qytetin. Kjo duket se krijon herë-herë mundësinë e një përshtatjeje shumë efikase: një persekutor i përbindshëm në shtëpi të vet, hiqet si i persekutuar kur është me të tjerë.

2. Anestezinë sociale: ne e proçesojmë ngjarjen traumatike në një mënyrë që ajo të mos përjetohet më si në fillim. Në këtë rrafsh kultura jonë ka mjaft mjete. Ne themi se plumbi e burgu për burrat janë! Ne i edukojmë fëmijët të mos e derdhnin një pikë loti edhe në

situata të vështira. Ne çmojmë ata që durojnë e që janë qëndrestarë. Të tjerët i përçmojmë si langaraqë. Të bombarduar me këtë material kulturor, ne modelohemi psikikisht për ta perceptuar në mënyrë më pak të dhimbshme atë që në të vërtetë dhemb mjaft. Në këtë kuptim kultura jonë prodhon anestezikë të tillë që na bëjnë t'i ndjejmë më pak efektet e traumatizimeve. Kjo, nga njëra anë të ndihmon t'i përballosh më lehtë traumat e rënda, por nga ana tjetër nuk të lë t'i asimilosh e t'i bësh të parrezikshme.

3. Kulturën e cinizmit: ne përçeshin çdo gjë që është e huaj, që nuk është si jona, që nuk e pëlqejmë, që nuk na e bën qejfin, që është kritike ndaj nesh. Ne ndodh të gëzohemi që ngordh lopa e komshiut e jo që pjell lopa jonë. Ne, duhet ta pranojmë, ushqejmë shumë mosbesim dhe negativitet. Këtu do të ndalem pak më gjatë:

Ne nuk kemi trashëguar eksperiencë të mjaftueshme në trajtimin e këtyre fenomeneve, veçanërisht të atyre shpirtërore. Periudha që po kalojmë është, në këtë këndvështrim, periudha e depresionit tonë të madh. Ky kompleks i madh fenomenesh negative ka dëmtuar mjaft aftësinë e njerëzve për të besuar. Shkatërrimi i besimit përbën fenomenin social më të madh të jetës shpirtërore shqiptare. Çështja e besimit, e mirëbesimit dhe e mosbesimit është gjithashtu një nga çështjet më të mëdha të psikologjisë sonë kombëtare. Dihet se fuqia ndërtuese e njerëzve që nuk besojnë në atë që bëjnë është e dyshimtë. Fundi i shekullit e gjeti vendin tonë me shumë shkatërrime (madje ndoshta më të mëdha se ato të Luftës II Botërore), por shkatërrimi më i madh që na ka ndodhur është shkatërrimi i besimit: shqiptari i sotëm e ka të vëshirë të besojë te polici dhe te oficeri, te gjykatësi dhe te nëpunësi, tek kleri e tek politikanët, tek partitë dhe tek kompanitë, ai e ka të vështirë të besojë edhe tek vetja. Më duhet ta them se me këtë nivel të ulët të ndjenjës së besimit është e vështirë të ndërtohet ajo që ne e aspirojmë si popull për ardhmërinë tonë, madje është e vështirë të ruhet edhe ajo që tashmë e kemi.

Momenti aktual i zhvillimit të shoqërisë është shumë kompleks e delikat. Jeta mjaft konkurrionale e panjohur deri 10 vjet më parë prodhon me shumicë stresorë të panumërt: mungesë mjetesh për të plotësuar nevojat bazë, nevojitet kujdes për anëtarët e tjerë të familjes, probleme me punën që e ke ose që nuk e ke, probleme me shëndetin e dikujt nga familja, probleme banese, jetesa pa fëmijët kur ua ke nevojën më shumë se kurrë, etj. Por kësaj liste që mund të bëhet shumë e gjatë i shtohet edhe një listë tjetër, ngjarjet kritike të jetës së çdo njeriu: vdekja e një të afërmi, humbja e vendit të punës, ndryshimi i punës, ndarja ose divorci, prekja nga një sëmundje e rëndë, etj. Këtyre iu shtohen si për të keqen tonë edhe ngjarje të tjera traumatike: poshtërime, akuza, sharje, plagosje kriminale e vdekje të dhunshme, aksidente, konflikte e trazira sociale⁵. E gjithë kjo masë e madhe agjentësh ngacmues prodhon traumatizime gjithfarëlloji. Veçoj këtu listën e tretë, e cila dekadën e fundit erdhi bashkë me pazotësinë tonë për të administruar lirinë e fituar. Kam parasysh këtu shkatërrimet ekonomike të vitit 1991, rrënimin financiar të vitit 1996, kaosin social dhe krimet e vitit 1997, tronditjen politike të vitit 1998, dëbimet e kosovarëve të vitit 1999. Jo pak destabilitet e dhunë vetëm në dhjetë vjet.

4. Atribuimi i jashtëm. Me ne ndodh ajo që ne e dimë: ne dimë se asnjëherë nuk e kemi ne fajin, fajin e kanë gjithmonë të tjerët. Ne nuk kemi prirjen të marrim përgjegjësitë. Edhe traumat ne i shpjegojmë me faktorë të jashtëm. Kjo është me leverdi: duke mallkuar traumat e deri edhe fatin tonë, madje edhe faktin pse jemi shqiptarë, ne ndjejmë më pak

⁵ Albania's Road to Democracy: A Fascinating Country in Transition, ORT/USAID, Tirana, July 1998, p.53-54

lëndim. Atribuimi i jashtëm ka ekonominë e vet.

Veçanërisht shkencat e shërbimet humane kanë mision të punojnë për ringjalljen e besimit në historinë tonë e në vlerat naciogale, në veten e në njeri-tjetrin, në institucionet dhe në proceset. Ne, siç duket, kemi nevojë për një psikologji sociale më optimiste, pozitive e konstruktive, pasi pesimizmi, negacioni e destruktivizmi ka fituar terren.

Dëshiroj që të kuptohem mirë: nuk po them që ne kemi një kulturë të keqe, por se kemi një kulturë tejet komplekse të cilën na duhet ta pastrojmë nga shtresat e kohërave, sidomos nga elementi i dhunës, konfliktit, agresivitetit e destruktivitetit në të. Neve na duhet ta pranojmë se kulturën tonë na duhet ta bëjmë më pak traumatike. Keni vënë re sesi me sa lehtësi ne i ankohe mi e i kallëzojmë njëri tjetrit të këqijat që na ka bërë dikushi?

Keni vënë re pastaj sesi ne që porsa jemi ankuar, jemi gati t'i bëjmë të njëjtën të keqe një tjetri? Ja kështu ndodh. Ne të gjithë jemi dhunues e të dhunuar njëkohësisht. Na duhet të mësojmë të jetojmë më paqësisht. Për mua ky është një element i modelit të adaptimit social psikologjik. Të njohim lëndimet personale dhe ato lëndime mos t'ia bëjmë tjetrit; t'ia lehtësojmë lëndimet shoshoqit se pastaj do jetë dikush që të na i lehtësojë ato edhe neve. Të mos ia bëjmë tjetrit atë që nuk duam të na e bëjnë neve.

VI BIBLIOGRAFI

1. Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, Fourth Edition, Copyright 1994, American Association.
2. Joseph, Stephen, Williams Ruth, Yule William, "Understanding Post-Traumatic Stress: a Psychosocial Perspective on PTSD and Treatment", John Wiley & Sons, Chichester et al., 1997
3. Meichenbaum Donald, "Treating Post-Traumatic Stress Disorder: a Handbook and Practice Manual for Therapy", Wiley, Chichester, Canada, 1994.
4. Jenkins, L, Albania's Road to Democracy: A Fascinating Country in Transition, ORT/USAID, Tirana, July 1998, p.53-54

DR. DRAGUSH TOTOZANI

TRAJTIMI PSIKOSOCIAL NË QSHRMT

Në këtë referat do të dëshiroja që para se të jap të dhënat konkrete mbi aktivitetin e punës së qendrës , të sqaroj disa probleme teorike që lidhen me nocionin e shëndetit mendor. Puna e QSHRMT-së është totalisht e lidhur me këtë nocion. Ne jemi të ndërgjegjshëm mbi situatën e gjendjes së shëndetit mendor në Shqipëri dhe mungesën e strukturave të domosdoshme për të mbajtur nën kontroll shëndetin mendor.

Organizata Botërore e Shëndetësisë , nëpërmjet zyrës së saj në Tiranë , me sa jemi të informuar ka filluar nga realizimi i një plani që lidhet me shëndetin mendor.

Është ngritur një komision në rang republike që ka përpiluar një projekt pune sidoqoftë duket se hë për hë gjithcka është fokusuar në gjendjen e shëndetit mendor të të sëmurëve psikikë që të parandalojnë sëmundjet dhe të krijojë kushte rehabilitimi .

Qendra jonë është e interesuar totalisht për gjendjen e ish të përndjekurve politikë në Shqipëri, për gjithë shmangiet psikologjike apo psikiatrike që kanë mbetur si pasojë e torturave. Madje ka nën kontroll edhe gjendjen fizike të kompromentuar nga e kaluara traumatike, apo probleme aktuale shëndetësore që natyrisht janë të lidhura me gjendjen e shëndetit mendor duke ndikuar reciprokisht tek njëri tjetri.

Pikat e mëposhtme paraqesin në vetvete në mënyrë të përmbledhur mendimet që unë do të sygjeroj më tej me gojë gjatë referimit tim. Ato më shërbejnë mua si pika orientuese për të folur në mënyrë koherente por janë njëkohësisht një koncentrat i kuptueshëm i materialit që do të paraqes para jush.

- Shëndeti mendor, nocion i futur në shëndetësi në 1902.
- Kriteret e përcaktimit të nocionit të shëndetit mendor.
- Shëndeti mendor, përkufizimi i lidhjes të gjendjes së shëndetit të individit në raport me mjedisin ku ai kontribuon në proësin e zhvillimit dhe përfiton nga të mirat që pasojnë.
- Situata e shëndetit mendor në Shqipëri pas rrëzimit të sistemit komunist.
- Elementët negativë gjatë tranzicionit që rënduan gjendjen e shëndetit mendor.
- Lëvizje të mëdha demografike të pakontrolluara.
- Humbje e vlerave tradicionale
- Emigrim masiv
- Përhapje e drogave
- Prostitucion
- Krim i organizuar
- Armë në duar të popullatës
- Korrupsion
- Projekti dhe ndërhyrja e OBSH-së në drejtim të përmirësimit të shëndetit mendor.
- Përlllogaritja e burimeve që do të bëjnë të mundur ristrukturimin e shërbimit psikiatrik.
- Kalimi i aktivitetit psikiatrik nga spitalet në komunitet.
- 30 dhe 31 Maj.2000 Konferenca për zhvillimin e shëndetit mendor në Shqipëri organizuar nga OBSH-ja nëpërmjet zyrës së saj në Tiranë.
- Diskutimi ynë në këtë konferencë për aktivitetin e QSHRMT-së për rehabilitimin e ish të përndjekurve politikë.

Sipas një burimi (nga shtypi) në Shqipëri ka pasur:

26768 burra të dënuar politikë
7367 gra të dënuara politike

48217 burra të internuar
10792 gra të internuara

- Populli dhe shoqëria shqiptare duhet tu kushtohet atyre. Kjo nuk duhet konsideruar çështje humanizmi, moraliteti dhe drejtësie, por si çështje që ka të bëjë me stabilitetin dhe të ardhmen e vendit.

- 8.08.1994 me vendimin Nr.52 Gjykata e Rrethit të Tiranës vendosi rregjistrimin si person juridik të QSHRMT-së.

OBJEKTIVAT

1. Të organizojë punën dhe të ndihmojë rehabilitimin e gjendjes shëndetësore, mendore dhe fizike për ish të përndjekurit dhe familjarët e tyre nëpërmjet shërbimit të specializuar psiko-terapeutik.
2. Të bëjë kërkime lidhur me torturën dhe pasojat që shkakton.
3. Të sensibilizojë dhe të ndërgjegjësojë opinionin publik për domosdoshmërinë e ndihmës psiko-sociale ndaj tyre.
 - Njohuritë e kuadrove të psikiatrisë në fushën e psikoterapeutikës.
 - Mungesa e kuadrove psikologë.
 - Përbërja e stafit të QSHRMT-së dhe detyrat që dilnin para tij.
 - Domosdoshmëria e rritjes së njohurive në fushën e psikoterapisë.
 - Kompletimi i stafit me kuadër në nivelin bashkëkohor për të bërë të mundur ekzaminimin multidisiplinar të klientëve.

MASAT QË U MORËN

- Grumbullimi në qendër i gjithë literaturës së huaj dhe të vendit që lidhet me post traumën.
- Pjesëmarrja e stafit në gjithë seminarët e organizuara për problemet e traumës nga ekspertë të vendeve të ndryshme. (Danezë, hollandezë, amerikanë, grekë, kroatë etj.)
- Kompletimi gradualisht i stafit me specialistë të aftë në fushat e tyre (psikiatër, psikolog, kardiolog, neurolog, gjinekolog, internist, fizioterapet).
- Aftësia e stafit për të dhënë ndihmë psiko-terapeutike:
 - Këshillim
 - Psikoterapi individuale
 - Psikoterapi çifti
 - Psikoterapi familjare
 - Psikoterapi grup
- Aftësia e stafit për të dhënë ndihmë mjekësore:
 - Psikiatrike
 - Neurologjike
 - Kardiologjike
 - Patologjike
 - Gjinekologjike
 - Fizioterapike
- Aktiviteti është i orientuar kryesisht në qendër por edhe në ambientet familjare.
 - A. Vizita ambulatorë, për probleme të thjeshta patologjike

B. Klientë të kartelizuar, për procedura të zgjatura psikoterapeutike si dhe procese kronike organike.

Vizita ambulatorore		Të kartelizuar	
Viti 1998	2038	Viti 1995	94
Viti 1999	3354	Viti 1996	120
Viti 2000	2663	Viti 1997	60
(deri ne 1 Tetor)		Viti 1998	94
		Viti 1999	53
		Viti 2000	53

-Trajtimi psikoterapeutik prioritar

-Trajtimi shëndetësor si domosdoshmëri për disa arsye:

- Patologji Natyrale
- Patologji nga traumat fizike të torturës
- Mosha e vjetër e shumicës dërrmuese të klientëve

Sipas studimit të realizuar me 434 klientë të kartelizuar mosha rezultoi si më poshtë.

Mosha sipas viteve

15-20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-70	71-80	Mbi 80	Totali
3	6	16	33	81	145	124	26	434
0.69	1.38	3.68	7.60	18.66	33.41	28.57	5.99	100%

-Ndër 434 rastet veç torturës psikologjike, 257 kanë patur edhe tortura të rënda fizike.

-Këto arsye si edhe kushtet e rënda ekonomike kanë shkaktuar anomali të shumta organike të aparatit kardiovaskular, nervor, urogenital, të frymëmarrjes, të tretjes, lokomotor etj.

-Aktiviteti i Stafit të qendrës në ndihmë të refugjatëve kosovarë gjatë 1998-1999 me një volum të madh pune në të gjitha drejtimet.

-Aktiviteti në funksion të projektit të ri me grupet e memorizimit. Aktualisht janë realizuar:

- 2 grupe burrash, vazhdon grupi i tretë.
- 1 grup grash, vazhdon grupi i dytë.

BARDHYL BELISHOVA

VEÇANTI TË REHABILITIMIT TË VIKTIMAVE TË TOTALITARIZMIT KOMUNIST NË SHQIPËRI

Tanimë ka kaluar një kohë e gjatë (gati një dekadë) nga fillimi i proceseve rehabilituese të ish të përndjekurve politikë të regjimit totalitar komunist të Shqipërisë. Megjithatë, ende jemi larg rehabilitimit psikosocial dhe integritit real e të plotë të tyre. Arritjet e deritanishme në këto dy drejtime janë larg kërkesave të normave ligjore, por edhe atyre humane. Një dekadë në proceset historike është e papërfillshme, por nuk mund të jetë e tillë për një periudhë tranzicioni, aq më tepër nëse e krahasojmë me shtete të tjera ish-komuniste të Evropës Lindore dhe nëse kemi parasysh se bëhet fjalë për fundin e shekullit të XX.

Duhet theksuar se dështimet në realizimin e një rehabilitimi psikosocial të pranueshëm nuk janë të vetmet në realizimin e objektivave të tranzicionit të kalimit të

shoqërisë shqiptare nga diktatura totalitare në demokraci dhe të kalimit nga ekonomia socialiste (tërësisht e centralizuar) në ekonomi të tregut. Dështime të tjera më të mëdha dhe me më shumë pasoja kemi pasur në realizimin e objektivave në fushën e ekonomisë, rendit, në kthimin e pronës, në ndërtimin e një shteti të drejtë e të respektueshëm nga qytetarët, etj. Ajo që shqetëson më tepër është e vërteta se shoqëria shqiptare edhe pas një dekade tranzicioni nuk është më pak konfliktuale nga sa ishte pas rrëzimit të totalitarizmit komunist.

Edhe qytetari më i thjeshtë nuk mund të mos pyesë pse Shqipëria pati një komunizëm aq të egër, pse po kalon një tranzicion kaq të rëndë dhe me shumë pasoja? Pse ndodhi 1997-a? Pse ndodhi 14 shtatori 1998? Pse politika shqiptare pas regjimit komunist është aq e egër dhe konfliktuale? “Pse”-të janë të pafundme. Përgjigjet janë gjithashtu të shumta e të llogjikshme ose jo. Disa prej tyre: *është faj i politikës shqiptare, stabilitetin e pengojnë fqinjët, akoma nuk e dëshirojnë normalizimin e Shqipërisë të mëdhenjtë dhe se revoltën e vitit 1997 e organizuan amerikanët!*

Nëse në diktaturë përgjegjësia për gjithçka që ndodh është kryesisht e diktatorit (pa përjashtuar edhe shoqëritë nga përgjegjësitë e tyre), në rendet demokratike përgjegjësia është e përgjithshme, që nga qytetari më i thjeshtë deri te personalitetet më të larta të të gjitha fushave, sigurisht në shkallë të ndryshme. Nëse në një diktaturë drejton një diktator apo një kastë, apo një parti, në demokraci drejton e gjithë shoqëria. Prandaj në demokraci për suksesin është një domosdoshmëri që ajo të mos jetë *konfliktuale* dhe problemet që i dalin t’i zgjidhin në frymë vëllazërore. Sigurisht, në të njëjtën kohë sukseset e një shoqërie demokratike janë të kushtëzuara nga marrëdhëniet e mira ndërkombëtare. Është mendimi ynë se për dështimet e gjendjen e rëndë kanë përgjegjësinë e tyre politika, shteti shqiptar, OJQ-të dhe *e gjithë* shoqëria shqiptare. Nuk mund të përjashtohet as bota e qytetëruar që mori përsipër drejtimin e ndërtimit të rendeve demokratike në ish-vendet komuniste të Evropës Lindore.

Përmendëm disa aspekte politike pasi jemi të mendimit se rehabilitimi psikosocial dhe integrimi nuk mund të realizohen jashtë kontekstit të një shoqërie demokratike, të qetë dhe të stabilizuar, krijimi i së cilës në rradhë të parë është objektiv i politikës. Shkaqet e gjendjes së rëndë në shoqërinë tonë, në mënyrë të vecantë në komunitetin e ish të përndjekurve politike, janë objektive dhe subjektive. Është koha të analizojmë rrugën dhjetëvjeçare. Për të realizuar arritjet e dëshiruara duhet të përcaktojmë si mund të ribëhet çka është bërë gabim dhe çka nuk është bërë të bëhet sa më shpejt. Është një detyrë komplekse dhe e rëndë, dhe i përket çdo individ, shoqërisë dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Zgjedhëm temën “Veçanti të rehabilitimit të viktimave të totalitarizmit komunist në Shqipëri” pasi vlerësojmë se një nga shkaqet e gjendjes së sotme të rëndë të shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht e ish-të përndjekurve politikë është se nuk u zbuluan e vlerësuan sa duhet *veçoritë e shoqërisë shqiptare* në përgjithësi, si edhe *veçoritë e persekucionit totalitarist, pasojave të tij dhe të proceseve të rehabilitimit e integrimin në veçanti.*

Përfundimet janë nxjerrë kryesisht nga përvoja dhe vëzhgime personale gjatë 26 viteve të mia të burgut, punës time në shoqatën e të përndjekurve politikë politikë dhe

punës kërkimore në QSHRMT, më tepër sesa nga një studim i mirëfilltë shkencor. Këto përfundime janë në nivel hipoteze dhe një pjesë e tyre janë përfshirë në hipotezat e projektit “Vlerësimi i nevojave dhe memorizimi” që QSHRMT-ja po realizon.

Mbi konceptin e totalitarizmit

Është Xhovani Amendola, një liberal italian, që krijoi më 1923-24 mbiemrin “totalitario”. Përkufizimet e deritanishme për totalitarizmin ende nuk kanë gjetur aprovim të përgjithshëm. Më i pranueshëm është ai i Rajmond Aron, filozof e politolog.

Nëse diktatura sipas Leninit është “një pushtet që nuk kufizohet nga asnjë ligj, nuk kushtëzohet nga asnjë rregull dhe që bazohet drejtpërdrejt te forca”, totalitarizmi është “diktaturë e politikës së masave, pushtet total mbi individin që synon krijimin e njeriut të Ri!”. Prej shumë autorëve regjimi i parë totalitar vlerësohet ai i Rosberit në Francë 1793-94 i “Vullnetit të Shumicës”.

Totalitarizmat e shekullit të XX

Totalitarizmat e shek. XX filluan në Rusi në 1917, u pasuan në Itali në 1923 dhe Gjermani në 1933, dhe në vendet komuniste të Evropës Lindore pas vitit 1945. Diktaturat janë autoritare, tiranike dhe totalitare. Kanë ekzistuar dy lloje totalitarizmash: jo komuniste dhe komuniste.

Ndryshime ndërmjet totalitarizmave komuniste dhe jokomuniste

Rezulton se ndërmjet totalitarizmave komuniste dhe jo komuniste të Evropës ka ndryshime dhe vecanti të ndjeshme. Këto ndryshime konsistojnë edhe në rrugët e format e ardhjes, kohëzgjatjen dhe formën e përmbyesjes së tyre.

a. Rrugët e vendosjes së totalitarizmave

Diktaturat jo komuniste në Itali dhe Gjermani kanë ardhur në fuqi në një rrugë në dukje ligjore, si një “vullnet i shumicës”.

Diktaturat komuniste janë vendosur respektivisht:

- në Rusi nëpërmjet një grushti shteti dhe e pasuar nga një luftë civile shumë e përgjakshme.
- në Jugosllavi dhe Shqipëri nga partitë komuniste, duke kombinuar luftën për çlirim nga okupatori me elementë të luftës civile, për vendosjen e regjimit totalitar.
- Në vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore totalitarizmi u imponua me forcë nga Bashkimi Sovjetik. Në këto zona u futën trupat sovjetike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo prezencë ushtarake u shfrytëzua për imponime politike.

Totalitarizmi fashist dhe nazist ruajtën institucionet (Pushtetin Gjyqësor, policinë, ushtrinë). Në përgjithësi nuk u prekën prona private e vogël dhe e madhe. Totalitarizmi komunist ishte më radikal në përmbyesjet e tij të aparatit shtetëror dhe të industrialistëve dhe bankierëve. Njëkohësisht, totalitarizmi komunist ishte më i skajshëm në synimet e tij pasi likuidoi pronën private, monopolizoi të gjitha fushat jetësore të shoqërisë, kufizoi ose ndaloi fenë, etj.

b. Mbijetesa e totalitarizmave të Evropës

Totalitarizmi fashist në Itali, 1923-1943

Totalitarizmi nazist në Gjermani, 1933-1945

Totalitarizmi komunist në: Rusi, 1917-1989

Vendet ish komuniste të Evropës Lindore, 1945 –1989

Shqipëri, 1944- 1991

c. Rrugët e përmbysjes së totalitarizmave

Totalitarizmi fashist dhe nazist u përmbysën nëpërmjet një luftë botërore, ndërkohë që totalitarizmat komuniste falimentuan dhe në rrugë demokratike paqësore kaluan në shtete demokratike.

Të gjitha këto ndryshime kanë komponentët dhe influencën e tyre në proceset e demokratizimit. Ndryshime shfaqen edhe në shkallën e krimeve dhe persekucionit të popujve të vet dhe të tjerë, shkallën dhe llojet e pasojave, si edhe në qëndrimet post-totalitare ndaj tyre. Mendimi ynë është se totalitarizmi komunist i ka sjellë shoqërive ku ai u vendos më shumë pasoja sesa ai jo komunist (pasoja të lidhura me cënimin e pronës, luftën e klasave, ndalimin i fesë, etj). Pasoja më e rëndë mund të konsiderohet ajo e cënimit të unitetit të popullit nëpërmjet luftës së klasave. Terrori, politika e egër penale dhe politika totalitare komuniste kanë shkaktuar në shoqërinë shqiptare një armiqësi të një shkalle shumë të lartë. Përballimi i pasojave të totalitarizmit komunist paraqitet më i vështirë sesa përballimi i pasojave të atij jo komunist (veçanërisht për vështirësitë ose rezistencat në dënimin e të kaluarës, kalimin nga ekonomia socialiste në atë të tregut, kthimin e pronave, uljen e acarimeve ose armiqësive dhe pajtimin brenda shoqërisë, etj.). Ndryshimet midis dy llojeve të totalitarizmave janë shoqëruar me veçanti edhe në proceset e ndërtimit të shoqërive demokratike post-totalitare dhe në proceset e rehabilitimit dhe integritit.

VEÇANTI TË TOTALITARIZMIT NË SHQIPËRI

Pasojat e totalitarizmit varen nga shkalla, lloji, kohëzgjatja dhe veçanti të tjera të persekucionit. Proceset e ndërtimit të shoqërive demokratike post komuniste po zhvillohen nën një program të gjerë botëror të drejtuar nga Perëndimi. Mosmarrja parasysh e atipizmit të Shqipërisë si një vend ish-komunist i Evropës Lindore është një nga shkaqet e rëndësishme të gjendjes së rëndë të shoqërisë shqiptare sot. Njohja e këtyre veçorive nga ana jonë dhe bërja e qartë edhe tek të tjerët është kusht për të siguruar arritjet e dëshiruara.

Disa vecanti të totalitarizmit komunist në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore:

1. I vendosur nëpërmjet një lufte me elementet e luftës civile (si edhe në Jugosllavi).
2. diktatura më çnjerëzore dhe më e zgjatur në formën e regjimit Stalinist. Pushkatimet, torturat dhe keqtrajtimet, burgosjet politike masive, internimet e familjarëve kanë vazhduar deri në fund të viteve 80.
3. një totalitarizëm më ekstrem dhe më absurd:

- Shpronësim total. Fshatari u la krejt pa tokë, pa gjedh, pa shpendë, kooperativat të drejtuara krejtësisht nga shteti, etj.
- Ndalimi i punës private.
- Ndalimi i fesë.
- Lufta dhe diskriminimi "klasor" i pakrahasueshëm me vendet e tjera. Diskriminimi i qytetarëve të klasës së pasur, të familjeve të vjetra politike, të kulturës perëndimore, të intelektualëve të vjetër; heqja e së drejtës të pensionit të nëpunësve të lartë dhe të mesëm të Monarkisë, reduktimi i pensionit për të dënuarit politikë, heqja e së drejtës së arsimimit të lartë për fëmijët e kundërshtarëve politikë, heqja e të drejtës së ushtrimit të profesionit për motive politike, etj.
- I vetmi vend komunist në Evropë që aplikoi totalitarizmin kinez në mënyrën e jetesës, në art, në kulturë, në politikë, etj.
- Një izolim shumë më i thellë nga bota
- Një shtet dhe shoqëri policore me një shtrirje të pakrahasueshme.

Disa veçori në pasojat e totalitarizmit krahasuar me vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore janë:

1. Një shoqëri shumë më konfliktuale.
2. Pasoja të një shkalle më të lartë të persekucionit dhe indoktrinimit. Numër masiv i të persekutuarve, por edhe i të indoktrinuarve dhe persekutorëve.
3. Fatkeqësitë, krimet, traumat janë shumë më të afërta në kohë. (Në vendet e tjera ish komuniste të Evropës Lindore, regjimet u moderuan pas vdekjes së Stalinit).

SHOQËRIA SHQIPTARE NË FUND TË VITIT 2000

Karakteristika të gjendjes së sotme

Siç u theksua më lart, ende nuk është realizuar një rehabilitim psikosocial dhe integrim i plotë i ish-të përndjekurve politikë në Shqipëri. Për më tepër, shumë qëndrime dhe veprime të shtetit dhe shoqërisë civile shqiptare gjenerojnë ngarkesa psikologjike te ky komunitet. Ndërkohë që shoqëria shqiptare është një shoqëri konfliktuale, e zhgënjyer, e pastabilizuar nga mungesa e sigurisë për jetën, prodhimi tejet i ulët kombëtar, papunësia, varfëria, shteti i korruptuar, shkalla e lartë e kriminalitetit dhe trafiqeve, etj.

Një gjendje e tillë, ka ardhur si rezultat i faktit se në të gjithë vendet ish-komuniste të Evropës Lindore proceset e demokratizimit dhe kalimit të ekonomisë socialiste në atë të tregut u shoqëruan me pasoja më të rënda sesa ishin menduar dhe se sfida e rrëzimit të komunizmit rezultoi më e vështirë nga sa u mendua.

Ndërsa pasojat dhe gjendja e sotme e vendit tonë janë rrjedhojë edhe e faktit se nuk u mor parasysh se Shqipëria ishte një rast i veçantë, krahasuar me vendet e tjera ish komuniste të Evropës Lindore si vendi më i varfër dhe më i prapambetur, i fundit vend evropian që fitoi pavarësinë vetëm në 1912 dhe ku prapambetja më e madhe, madje edhe e drejta zakonore ka vepruar deri vonë, vendi më i izoluar nga bota e jashtme, me pronë private dhe veprimtari private zero, me ekonomi të centralizuar dhe të drejtuar plotësisht nga shteti, që i duhej të kalonte nga regjimi Stalinist në demokraci. Por veçantia më e madhe ka qenë në skajshmërinë e zhvillimit të luftës klasore dhe të likujdimit të pronës

private që e çoi totalitarizmin komunist në një ngjashmëri me sisteme feudale e bujkërobërie.

Pikërisht për këto arsye, Shqipëria duhej të kishte *një program të mirëfilltë shkencor kombëtar të ndërtimit të rendit demokratik* dhe si pjesë e tij të ishte edhe rehabilitimi dhe integrimi i ish të përndjekurve politikë.

SHQIPËRIA NË FILLIM TË MIJËVJEÇARIT TË TRETË

Për shkak të veçantive historike dhe të pasojave të totalitarizmit, Shqipëria ka veçanti edhe në hartimin dhe zbatimin e një programi shkencor kombëtar për të ndërtuar një shtet dhe shoqëri me të vërtetë demokratike dhe të begatë. Demokracia pa stabilitet, pa mirëqënie shpirtërore dhe materiale nuk i duhet askujt dhe nuk i shërben të ardhmes. Në shërbim të hartimit të këtij programi po parashtrijmë disa mendime, si një kontribut modest në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me rehabilitimin dhe integrimin e ish-të përndjekurve politikë, që është një detyrim ligjor dhe human për shtetin dhe shoqërinë shqiptare.

Rehabilitimi, shteti dhe shoqëria shqiptare

Proceset rehabilituese dhe integruese të ish-të përndjekurve politikë kanë shumë veçori. Identifikimi i tyre është një domosdoshmëri për realizimin e këtij rehabilitimi. Proceset rehabilituese filluan në Evropën Lindore duke u bazuar në përvojën rehabilituese të të mbijetuarve të torturës në Evropën Perëndimore dhe Amerikë. Por kjo përvojë ishte e pamjaftueshme për rehabilitimin dhe integrimin e ish-të përndjekurve politikë të totalitarizmit komunist shqiptar, shumica e të cilëve janë të mbijetuar primarë të torturës.

Vendi ynë nuk kishte asnjë traditë në proceset rehabilituese të të mbijetuarve të torturës. Sot mund të themi se falë ndihmës së botës së qytetëruar dhe për QSHRMT në mënyrë të veçantë të ndihmës norvegjeze dhe daneze (realizuar nëpërmjet RCT/IRCT) është arritur që të aftësohemi dhe të kemi grumbulluar një përvojë, sigurisht shumë modeste, në fushën e rehabilitim-integrimit. Më poshtë po shtjellojmë disa përfundime të nxjerra nga puna rehabilituese 6-vjeçare e QSHRMT-së:

1. Rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë në Shqipëri nuk është vetëm një çështje drejtësie dhe humanizmi, por është edhe çështje stabiliteti, kjo edhe për shkak të përmasave të të persekutuarve dhe të diskriminuarve, të pasojave dhe të vazhdimit të persekucionit të ashpër, madje dhe krimeve të egra deri në fund të viteve '80. Sa më sipër është e rëndësishme të njihet nga shteti, shoqëria dhe miqtë e Shqipërisë që problemet e rehabilitim-integrimit të ish-të përndjekurve politikë të vlerësohen më drejtë.
2. Proceset rehabilituese dhe integruese nuk do të kenë arritjet e mjaftueshme po nuk u mor parasysh se ato do të realizohen nga një shoqëri në tranzicion, tejet konfliktuale dhe me prapambetje të jashtëzakonshme të shkencave shoqërore dhe veçanërisht në fushën e psikologjisë dhe shëndetit mendor dhe do të realizohen nga një vend me ekonomi në gjendje katastrofike.


Rehabilitim-integrimi dhe zhvillimi i shkencave shoqërore

Rehabilitimi psikologjik kërkon kulturë dhe besim në psikologjinë kliniciste. Por në vendin tonë për shkak të prapambetjes në fushën e psikologjisë e ardhur nga totalitarizmi komunist kjo kulturë dhe ky besim janë në një nivel shumë të ulët, prandaj arrijmë në përfundimin se në vendin tonë duhet të ketë një program për edukimin shëndetësor të shoqërisë në përgjithësi dhe si pjesë e tij një program të veçantë për edukimin shëndetësor të ish-të përndjekurve politikë. Për përmasat e numrit të ish të përndjekurve politikë me pasoja post-traumatike është e pamundur që ndihma e nevojshme psikologjike të realizohet me këshillues profesionistë, kur dihet se grupi i parë i psikologëve (rreth 30 studentë) u diplomuan vetëm në verën e vitit 2000. Një zgjidhje do të ishte nga njëra anë trajnimi i aktivistëve të shoqatave të ish të përndjekurve politikë dhe vullnetarëve ish të përndjekur ose jo për të dhënë ndihmë psikologjike, për tua lehtësuar shqetësimet dhe përballimin e pasojave të persekucionit dhe të stresit të sotëm dhe nga ana tjetër ndërgjegjësimi i shoqërisë për domosdoshmërinë e trajnimit të mjekëve të përgjithshëm dhe arsimtarëve për probleme të stresit dhe pasojave të tij në shëndetin e njeriut.

▪Rehabilitimi dhe konfliktualiteti i shoqërisë

Pasoja më e rëndë e totalitarizmit është konfliktualiteti i trashëguar në shoqërinë shqiptare. Fatkeqësia më e madhe është se edhe mbas dhjetë vjetësh ky konfliktualitet nuk është zbutur. Ai është bërë objekt i trajtesës sonë pasi sot përbën një pengesë për realizimin e objektivave tona të rehabilitim-integrimit të ish të përndjekurve politikë.

Rehabilitimi dhe integrimi real i ish të përndjekurve politikë mund të realizohet vetëm në një shoqëri të stabilizuar. Por në Shqipëri ky stabilitet jo vetëm nuk është vendosur, por vendosja e tij kërkon edhe rehabilitimin dhe integrimin e komunitetit të ish të përndjekurve politikë. Jemi brenda një rrethi vicioz.



E vetmja rrugëdalje është që këto dy procese të ecin paralelisht.

Arritja e stabilitetit të shoqërisë shqiptare kërkon nga shteti dhe shoqëria zgjidhjen e një numri shumë të madh problemesh. Njeri prej tyre, jo më i rëndësishmi, është edhe qëndrimi i shtetit dhe shoqërisë ndaj të kaluarës totalitare.

Së pari, duhet të ndërgjegjësohemi se e kaluara nuk harrohet, ajo përballohet. Çështja shtrohet si të përballohet në mënyrë që normalizimi i marrëdhënieve në shoqërinë shqiptare të arrihet sa më shpejt. E kaluara komuniste është një nga faktorët më frenues të proceseve të normalizimit të marrëdhënieve në shoqërinë shqiptare. Pasoja nga totalitarizmi komunist ka gjithë shoqëria shqiptare: ish të përndjekurit nga përndjekja, ish të diskriminuarit nga diskriminimi dhe të tjerët nga indoktrinimi. Në shoqërinë shqiptare duhet të ecin paralelisht të dy proceset: ai i rehabilitimit të ish të përndjekurve politikë dhe çlirimi nga indoktrinimi i të indoktrinuarve. Nëse në drejtim të rehabilitimit është punuar në njëfarë shkalle në drejtim të çindoktrinimit pothuajse nuk është punuar

fare. Për të realizuar sa më sipër është i nevojshëm një program i *dekomunizimit*, ashtu si ai i denazifikimit, që ta çlirojë shoqërinë shqiptare nga pasojat e totalitarizmit. Pjesë përbërëse e këtij programi duhet të jetë edhe *ulja e konfliktualitetit*. Shoqëria gjermane ishte vetëm 12 vjet nën totalitarizmin nazist dhe në programin e ngritjes së demokracisë gjermane kishte si një pikë të veçantë, denazifikimin. Shqipëria qëndroi gjysëm shekulli në totalitarizmin komunist dhe ende nuk ka një program për dekomunizimin.

Thirrjet patetike për pajtim kombëtar kthehen në slogane boshe pa një program të realizimit të tij. Sharjet kundër komunizmit janë të pamjaftueshme për t'u çliruar nga pasojat e tij, përkundrazi ato e pengojnë këtë çlirim. Realizimi i pajtimit kërkon:

- Të vërtetën dhe çindoktrinimin
- Pendësën që nuk mund të realizohet pa çindoktrinimin.
- Ndjesën mbas pendësës. Nuk ka falje pa ndjesën.
- Pa falje nuk ka pajtim.
- Por falet gabimi, falet faji, nuk falet krimi!

Dënimi i krimit, e vërteta për të kaluarën realizohen nga shteti dhe shoqëria edhe nëse viktimat nuk e kërkojnë këtë! Në shoqërinë shqiptare ky problem akoma nuk shtrohet drejt. Realizimi i çindoktrinimit dhe aq më tepër i arritjes së pendësës, ndjesës dhe faljes është një detyrë jashtëzakonisht e vështirë, shumë më e vështirë se proceset reabilituese materiale, morale dhe shëndetësore. Konfliktualiteti ose armiqësitë në totalitarizëm janë shumë më të shtrira se në diktaturat jo totalitare. Ato nuk kufizohen ndërmjet të burgosurve, të internuarve dhe disa policëve, hetuesve dhe politikanëve. Pendesa, ndjesa kërkohet që nga udhëheqësit, funksionarët e lartë deri tek anëtarët e partisë, te ideologët, te arsimtarët, te shkrimtarët, te aktivistët e organizatave shoqërore, te brigadierët, etj.

Gama e problemeve që duhet të përfshijë një program të dekomunizimit është shumë e gjerë dhe nuk është objekt i trajtesës sonë, megjithatë poshtë po rendisim disa nga problemet që duhet të përfshijë ky program:

1. Një "Libër i Zi" për krimet, persekucionin komunist dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.
2. Kritika jo vetëm për Stalinizmin, Enverizmin, por edhe Marksizëm-Leninizmin (Në shtypin e majtë nuk shkruhet as kundër Stalinizmit as kundër Enverizmit). Çindoktrinimi nuk mund të realizohet nëse nuk do të jetë objektiv i së majtës.
3. Çmitizimi i miteve të komunizmit dhe të socializmit.
4. Vënia në vend e së vërtetës historike për periudha dhe për personalitete të politikës dhe kulturës.
5. Vendosja e drejtësisë për kthimin e pronave (pronarët janë viktimat e totalitarizmit) dhe kompesimin material të ish të përndjekurve politikë.
6. Rehabilitimi dhe integrimi real të ish të përndjekurve politikë.

Pajtimi kombëtar nuk mund të arrihet po nuk qenë të drejtë dhe humanë ndaj ish të përndjekurve politikë në rradhë të parë, ata që kanë përgjegjësi morale për të kaluarën. Partia Socialiste, pa e diskutuar nëse është e drejtë, konsiderohet nga shumica dërrmuese

e ish të përndjekurve politikë si vazhdim i Partisë së Punës. Prandaj kjo parti duhet të ketë në programin e saj realizimin e çindoktrinimit, pendesës, ndjesës dhe dënimit të krimeve, si kërkesë e drejtësisë, moralitetit dhe humanizmit.

Shtrohen pyetjet: a është e drejtë që sot ish të përndjekurit politikë që disponojnë dhjetra milionë lekë (letra me vlerë) dhe kanë prona të pakthyera prej qindra milionash, të jetojnë në varfëri? A është e drejtë që ish të përndjekurit vazhdojnë të jetojnë në vendet e internimit ose në shtëpi krejt të papërshtatshme dhe kushte çnjerëzore, në një kohë që gjenden fonde për shtëpi komode për deputetët, funksionarët, etj? Ashtu siç u gjenden fonde për strehimin e atyre që humbën shtëpitë në firmat piramidale, duhet të ishin gjetur fonde jo vetëm për strehim, por edhe për rehabilitimin dhe integrimin e të përndjekurve politikë. Në këtë gjendje a mund të bëhet pajtimi kombëtar?

Çfarë gjeneron stres tek ish-të përndjekurit politikë sot?

Ish të përndjekurit politikë, si e gjithë shoqëria shqiptare, jetojnë një periudhë të jashtëzakonshme stresante. Por ata i nënshtrohen edhe streseve të tjera të gjeneruara nga qëndrimet ndaj të kaluarës komuniste, si :

1. Pompoziteti i festimeve të 29 Nëntorit dhe teprimet në festimet përkujtimore të ngjarjeve të L.A.N.Ç dhe pjesëmarrja e udhëheqësve shtetërorë në këto festa.
2. Ceremonitë zyrtare të varrimit të ish gjeneralëve dhe madje të H.Lleshit, presidentit që ka firmosur pushkatimin e qindra viktimave, ligjin për internim, ndalimin e fesë, etj.
3. Nekrologjitë vlerësuese edhe në TV publik për ish funksionarët e lartë të totalitarizmit, duke përfshirë edhe funksionarët e sigurimit të shtetit.
4. Shfaqja e filmave me “heroizma” të sigurimit të shtetit, me luftë të klasave, etj.
5. Publiciteti i konsultave me ish ministrat e totalitarizmit.

Evitimi i këtij stresi të gjeneruar nga qëndrimet ndaj të kaluarës nuk kërkon mjete financiare, por vetëm urtësi dhe kulturë demokratike.

Politika dhe Stresi

(E kaluara, shteti, politika dhe pajtimi)

Shteti, politika dhe e gjithë shoqëria shqiptare deklarohen se janë për ndërtimin e shoqërisë demokratike dhe ekonomisë së tregut. Por realizimi i këtij objekti nuk është i lehtë. Në këtë rrugë ka shumë pengesa dhe një nga këto, jo pak e rëndësishme, është mjedisi konfliktual me armiqtë e trashëguara dhe me zemërimet, sharjet, inatet etj. që ushqehet përditë edhe nga stresi që gjeneron politika. Në luftë nuk ndërtohet as demokracia dhe as mirëqenia, ato mund të ndërtohen vetëm në një shoqëri me marrëdhënie normale, të mirëkuptimit dhe të konkurrencës së alternativave, por jo të armiqtëve dhe “luftërave”.

Konfliktualiteti kaq i lartë nga njëra anë konsumon energjitë e kësaj shoqërie, nga ana tjetër pengon funksionimin normal të logjikës së saj. E veçanta e shoqërisë shqiptare

si në të kaluarën komuniste ashtu edhe në ato post komuniste është se komponentja absurde e veprimeve të shtetit dhe politikës është shumë e lartë. Nëse kjo komponente në diktaturë varet nga diktatori dhe klika e tij, në demokraci varet nga kultura dhe shkalla e konfliktualitetit të shoqërisë. Si rezultat i kësaj gjendjeje shumë qëndrime e sjellje të shtetit dhe politikës kanë qënë pa asnjë përfitim, madje të dëmshme edhe për ata vetë.

Një pengesë e normalizimit të marrëdhënieve në shoqërinë shqiptare është bindja se “proceset e demokratizimit në vendin tonë ecin sipas porosive të Katovicës”. Ta pranojmë apriori se nuk është e vërtetë. E mira e vendit kërkon një qëndrim aktiv për sqarimin e së vërtetës. Për t’i kthyer ata që e besojnë Katovicën, nga armiq në konkurrentë, është e nevojshme t’u ndryshohet ky qëndrim. Në ish të përndjekurit dhe jo vetëm ndër ta, mbijeton mendimi se Partia e Punës për t’iu shmangur përgjegjësive manovroi fillimisht me ndërrimin e emrit nga e ‘Punës’ në ‘Socialiste’ dhe se shumë shpejt u deklarua se Partia Socialiste s’ka asnjë lidhje me Partinë e Punës.

E vërteta për proceset e rinovimit të Partisë së Punës ose të krijimit të Partisë Socialiste është një çështje e rëndësishme për normalizimin e marrëdhënieve në Shqipëri. Ç’u bë Partia e Punës? E vërteta kërkon sqarim:

- a. Pse gazeta e P.S. mban emrin “Zëri i Popullit” dhe pse kjo gazetë mban vitin e botimit 1942?
- b. Ku shkuan mjetet financiare të P.P.SH dhe P.S. a ka të njëjten llogari bankare?
- c. Anëtarët e P.P kanë bërë kërkesë për t’u pranuar si anëtarë të P.S?
- d. Pse në përvjetorin e Konferencës së Pezës marrin pjesë vetëm socialistët (ndoshta dhe disa të majtë të tjerë) dhe nuk u ftuan partitë të tjera?
- e. Përse në gazetën Z.P. nuk ka artikuj teorikë kundër totalitarizmit komunist, dhe Marksizëm –Leninizmit, shkrime kundër Stalinit, E.Hoxhës, etj?

Bëhen thirrje për pajtimin kombëtar për të mos parë nga e kaluara, për të parë përpara, për ta bërë Shqipërinë si Evropa! Por këto thirrje bëhen nga ata që jo vetëm nuk janë cënuar nga totalitarizmi, por kanë qënë edhe aktorë të tij. “Të mos shikojmë prapa”, por festat vazhdojnë si në totalitarizëm bazuar në mitet e komunizmit. Po kjo traditë e festave dhe e propagandës a nuk do ndonjë reduktim? A veprohet kështu në Evropë ose edhe në Ballkan, Jugosllavi, Greqi që nuk luftuan më pak se ne? Këto vende e kanë festë zyrtare, me pushim e me fishekzjarre ditën e largimit të ushtarit të fundit?

Organizohen konsulta me ministrat e regjimit komunist. Por harrohet politika e jashtme katastrofike deri e neveritshme dhe e turpshme e izolimit dhe e sharjeve e shpifjeve të paskrupullta. Harrohet se fshatari s’kishte qumësht, vezë, nuk ngopej me bukë, harrohet se gati 80% e popullatës ishte në fshat dhe nuk sigurohej ushqimi për popullatën. Dhe nëse do të ishte e nevojshme ndonjë bashkëpunim ose marrje e ndonjë mendimi a nuk mund të bëhej larg kamerave që të mos ngacmoheshin plagët e vjetra?

Shfaqen filma me armiq të klasave, me diversantë me sabotatorë etj. etj. E a e kanë të qartë se çfarë u kujtojnë të mbijetuarve të torturës? Me të vërtetë këta filma kanë vlera të mirëfillta artistike? Të paktën për hir të pajtimit duhej tani për tani të mos shfaqeshin. A është meritë të kesh qënë funksionar i lartë i regjimit totalitar? Pse TV

publik duhet të japë nekronologji për ta? Pse gjeneralët e regjimit komunist dhe presidenti H. Lleshi duhet të përcillen me ceremoni zyrtare?

Nëse kërkohet të mos shihet prapa për të mirën e unitetit nuk duhet të shihet jo vetëm për turpin, por edhe për “lavdinë”. Kur edhe komshiut me të cilin është në armiqësi i ndodh një mort, shqiptari ndalon sazet e dasmës së tij! Këto qëndrime nuk tregojnë as mençuri, as moralitet as humanizëm. Le të shpresojmë që janë pasojë e indoktrinimit, pasionit, mungesës së kulturës demokratike.

Sa shumë flasim për tolerancën, por toleranca kërkon të paktën të heqësh dorë nga e drejta e festave, kur te pala tjetër me të cilën do të pajtohesh shkakton dhimbje dhe i kujton atë çka e ka armiqësuar me ty. Sa më sipër janë vetëm një pjesë e problemeve për normalizimin e marrëdhënieve të shoqërisë shqiptare. Sa janë ato? Ka ardhur koha t’i zbulojmë dhe t’i korrigjojmë. Ne vetëm e shtrojmë si problem që kërkon zgjidhje.

Pakti i Stabilitetit Ballkanik

Pakti i Stabilitetit Ballkanik ka si objektiv arritjen e stabilitetit ballkanik, që Ballkani të mos jetë më ‘fuçi baruti’. Stabiliteti do të jetë rruga drejt integritimit evropian dhe ky integrim është garancia e çlirimit përgjithmonë të shteteve ballkanike nga armiqësitë dhe luftrat. Por nuk mund të ketë stabilitet ballkanik pa stabilitetin e çdo vendi të tij dhe stabiliteti i çdo vendi nuk arrihet lehtë dhe nuk do të jetë i qëndrueshëm pa stabilitetin e gjithë rajonit ballkanik.



Pakti i Stabilitetit Ballkanik dhe Shqipëria

Pakti i Stabilitetit Ballkanik (P.S.B.) është një shans historik, veçanërisht për ne shqiptarët me më shumë halle e probleme. Humbja e këtij shansi do të jetë e pafalshme.

Ballkani ka nevojë për investime të mëdha në infrastrukturë dhe ekonomi, por edhe më të mëdha në fushën e demokratizimit e qytetërimit. Po nuk ecën paralelisht, ato që ndërtohen për vite prishen vetëm për disa ditë ose muaj. Por fatkeqësisht vërejmë se ka shumë pak projekte për demokracinë. Në të njëjtën kohë po realizojnë projekte më shumë ata që janë më të aftë në përpilim e realizim projektësh, sesa ata që kanë më shumë nevojë. Ndërsa projektet në rradhë të parë duhet të jenë për ato vende dhe ato probleme që janë më të qenësishme për arritjen e Stabilitetit Ballkanik.

Shqipëria është vendi me më probleme për të zgjidhur, por është edhe më i paaftë për të realizuar projekte. Drejtësia dhe mençuria kërkojnë që organizmat e PSB të ndihmojnë në hartimin dhe realizimin e projekteve në vendin tonë. Është totalitarizmi ekstrem dhe izolimi i plotë i Shqipërisë për ½ shekulli që shpjegon këtë gjendje të paaftësisë së shoqërisë shqiptare për përpilim projektësh. Vetëm nëpërmjet projekteve me

PSB shoqëria shqiptare do të mund të dalë nga rrethi vicioz që përmendëm më lart. Vetëm nëpërmjet projekteve me PSB do të mundësohet të korigjohen ato që janë bërë gabim dhe do të bëhen ato që nuk janë bërë.

Stabiliteti i vendit nuk mund të arrihet pa një *program shkencor të pajtimit kombëtar*, i cili për veçantitë e shoqërisë shqiptare është jashtëzakonisht i vështirë për t'u hartuar dhe për t'u realizuar. Hartimi i tij nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen e shkencës shqiptare dhe bashkëpunimit të studiuesve tanë me ata të huaj. Nëse studiuesit tanë kanë akoma boshllëqe në njohuri e përvojë, studiuesit e huaj akoma nuk njohin veçantitë e totalitarizmit komunist dhe veçanërisht të atij shqiptar.

Pa këtë program nuk mund të hartohen projekte me të vërtetë të dobishme në realizimin e objektivave të PSB. Pa këtë program nuk do të arrihet impenjimi i shoqërisë, shtetit, politikës, shoqërisë civile, impenjim pa të cilin këto projekte nuk mund të jenë plotësisht eficientë.

Pakti i Stabilitetit Ballkanik dhe Ballkani

Edhe në realizimin e stabilitetit ballkanik ne shqiptarët kemi shumë veçori. Një ndër ato është se territoret që rrethojnë kufijtë shtetërorë të Shqipërisë banohen nga shqiptarët dhe numri i tyre është afërsisht sa ai RSH-së. Si afria jonë e gjakut, ashtu dhe e mira e arritjes së stabilitetit ballkanik kërkon nga ARCT të luajë një rol të veçantë në proceset e rehabilitimit dhe integritetit të viktimave të genocidit, totalitarizmit ose çfarëdo lloj dhune tjetër në Kosovë dhe Maqedoni.

ARCT dhe viktimat në Kosovë dhe Maqedoni

Me viktima nënkuptojmë të mbijetuarit e genocidit serb të torturës, të totalitarizmit dhe çdo dhune tjetër të organizuar, ish të përndjekurit politikë të djeshëm dhe të sotëm. Përvoja jonë, të ndërgjegjshëm se është shumë modeste, do të ndihmonte që në Kosovë dhe Maqedoni veprimtaria rehabilituese dhe parandaluese të jenë më eficiente. Sa më sipër për shkak të lidhjes së gjakut, të kulturës, zakoneve, por edhe se jemi viktima të të njëjtit totalitarizëm komunist. Për nivelin e auditorit do të ishte e tepërt të zgjatesha në argumenta të tjerë të dobisë së krijimit të një network-u bashkëpunimi të tri qendrave tona. Krijimi i këtij Network-u, caktimi i objektivave dhe realizimi i tyre mund të arrihen vetëm si projekt i PSB, realizimi i të cilit kërkon edhe përkrahjen dhe bashkëpunimin e Network-ut Ballkanik të Qendrave të Rehabilitimit (BAN).

Pakti i Stabilitetit Ballkanik

Realizimi i Stabilitetit të Ballkanit është një program me të vërtetë shumë i vështirë. Ai as nuk mund të imagjinohet pa ndihmën e botës së qytetëruar. Por kjo detyrë lehtësohet disi, mbasi ne kemi një mundësi të ecim jo në një rrugë të pashkelur, por në një rrugë të njohur: *në rrugën e realizimit të Evropës së Bashkuar*. Evropa e sotme e bashkuar, e paqes e miqësisë, e lulëzimit të paparë jo shumë larg ishte Evropa e urrejtjes

dhe armiqësive reciproke e luftrave që shkaktuan dhjetëra milionë të vrarë. Evropa e sotme e Bashkuar të bind se edhe ne ballkanasit mund të arrijmë të bëhemi si evropianët, të paktën si fillim të bëhemi të mençur që t'i japim fund armiqësive.

Evropa e Bashkuar nuk do të realizohet:

1. nëse gjermanët do të justifikoheshin me fajësimin e dënimit të Hitlerit, shokëve dhe partisë së tij. Përkundrazi ata i bënë analizë vetes dhe çka ndodhi ia atribuon kulturës së shoqërisë gjermane, rezultat i gabimeve historike të saj. Ata njohën veten, u penduan, kërkuan dhe kërkajnë ndjesë edhe gjermanët antinazistë edhe gjermanët e sotëm që nuk kishin lindur kur u kryen krimet e nazizmit.

2. nëse Evropa (veçanërisht fuqitë e mëdha) nuk do të kishin analizuar veten, nëse nuk do të kishin nxjerrë përgjegjësitë e tyre për këto dy luftëra botërore, nëse Gjermania do të ishte trajtuar vetëm si shtet i mundur dhe nuk do të ishte trajtuar edhe si partner, nëse nuk do të vlerësonte më tepër faljen se dënimit, nëse problemet nuk do t'i trajtonte me një frymë vëllazërore, nëse nuk do ishin demokratizuar normat ndërkombëtare, nëse politika nuk do t'i përmbahej moralitetit, nëse nuk do të ishte likuiduar sistemi kolonist.

Megjithë ndryshimet e pakrahasueshme të situatave dhe të kulturave ballkanike të sotme dhe evropiane të pas Luftës së Dytë, shumë mësimë mund të nxirren nga kjo përvojë për të gjithë ne popujt e Ballkanit. Por një domosdoshmëri e fillimit të mirë të proceseve të realizimit të stabilitetit në Ballkan është analiza që duhet t'i bëjë shoqëria serbe vetes, si shoqëria e shtetit që shkaktoi këtë tragjedi të fundshekullit në disa popuj të Ballkanit.

Ashtu si shoqëria gjermane edhe shoqëria serbe duhet të kuptojë se gjithçka që ndodhi në territoret e ish Jugosllavisë nuk mund të justifikohet me një Millosheviç apo dhe me një parti apo klikë. Luftat kundër Sllovenisë dhe Kroacisë, veçanërisht tmerret e genocidit në Bosnjë e Kosovë nuk janë një imponim i Milosheviçit: ato janë produkt i një kulture të përpunuar e kultivuar për dhjetra dekada e për shekuj brenda shoqërisë serbe. Autorë dhe protagonistë nuk janë vetëm disa politikanë dhe ushtarakë, por edhe akademikët, arsimtarët, shkrimtarët, historianët, inteligjenca e shoqëria serbe.

Dënimi i Milosheviçit dhe të gjithë atyre që kanë kryer krime është një domosdoshmëri, një zbatim i drejtësisë, zbatim i normave ligjore, i cili nuk mund të pezullohet nga asnjë personalitet ose institucion. Nga dënimi nuk mund të përjashtohen as edhe ata që kanë kryer krime dhe kanë shkelur të drejtat themelore të njeriut gjatë diktaturës totalitare në Jugosllavi.

Dënimi është një kërkesë e parandalimit, por është edhe një domosdoshmëri për rehabilitimin e komuniteteve të viktimave të torturës. Nga ana tjetër rehabilitimi i komuniteteve të viktimave është një domosdoshmëri për normalizimin jo vetëm të marrëdhënieve të shoqërisë së çdo vendi, por edhe të marrëdhënieve ndërballkanike. Por për normalizimin e marrëdhënieve të shoqërive ballkanike, pa të cilin nuk mund të arrihet stabiliteti, më të domosdoshme janë pendesa, ndjesa nga shoqëria dhe shteti serb dhe falja nga të dëmtuarit. Por pendesë, ndjesë dhe falje kërkohet edhe nga të tjerë për të sotmen dhe për të kaluarën. Më e vështira është arritja e pendesës se ajo nuk mund të arrihet pa zbuluar rrënjët e së keqes të ngulura thellë në histori. Asaj të keqeje që ka kultivuar egërsinë, urrejtjen, paragjykimet, padrejtësitë, etj. Edhe në këtë drejtim, Ballkani ka

veçantitë e veta. Pa i evidentuar këto veçanti, që nuk mund të arrihen pa studime shkencore të mirëfillta, normalizimi i marrëdhënieve tona nuk do të arrijë parametrat evropianë.

Rehabilitimi i individit nuk mund të realizohet pa një mjedis normal. Por normaliteti i mjedisit është problem që nuk mund ta rregullojmë ne. Nëse ne marrim përsipër ta rregullojmë atë do të ishim “fantazioz” ose utopistë. Nëse ne qëndrojmë indiferentë ndaj këtij problemi do të ishim të pandërgjegjshëm si profesionistë dhe si qytetarë. Ne vetëm mund ta ngremë si pjesë të një problemi që shtrohet për zgjidhje nga shtetet dhe shoqëritë ballkanike. Për të realizuar objektivat e këtij Network-u duhet të bashkëpunojmë me RCT-në dhe partnerë të tjerë evropianë, por veçanërisht është domosdoshmëri e padiskutueshme bashkëpunimi me BAN.

Krahas punës rehabilituese dhe parandaluese që ne zhvillojmë sipas programeve tona, është e nevojshme që nëpërmjet BAN dhe RCT - Kopenhagen të përqijemi të influencojmë te PSB për të hartuar një program të Pajtitit Ballkanik, i cili është një objektiv jashtë mundësive tona, por realizimi i të cilit ka rëndësi për punën tonë rehabilituese. E keqja e kultivuar për dekada, shekuj nga e gjithë shoqëria nuk mund të zhbëhet lehtë. Për të arritur sa më sipër është e nevojshme përfshirja e shoqërive të të gjithë vendeve tona. Nëse do të arrihet të kuptohet kjo nevojë, do të ishte një punë shumë e mirë. Realizimi do të jetë detyra e shtetit, politikës, shoqërisë, shkollës, medias, kulturës etj. Qendrat tona, Network-u Tiranë-Prishtinë-Tetovë, BAN do të jenë protagonistë të rehabilitimit dhe shëndetit mendor të këtij programi të madh.

Bibliografia

- 1. Leon Poliakov**
“ Totalitarizmat e shekullit XX”
- 2. Courtos, Werth, Pann**
“ Libri i Zi i Komunizmit”
- 3. Stanley Chodorow, Mac Gregory Knox**
“ The Mainstream of Civilization”
- 4. Anthony Giddens**
“ Sociologjia”
- 5. Pjetër Pepa**
“ Dosjet e diktaturës”

DR. FERIDE RUSHITI

PREZANTIMI I QKRMT-SË

Në fillim do t'ju jap një pasqyrë të shkurtër mbi situatën aktuale në Kosovë dhe pastaj një prezantim të aktivitetit të Qendrës Kosovare të Rehabilitimit të Mbijetuarve të Torturës. Më lini t'ju informoj që do pajiseni me një material më të gjerë mbi veprimtarinë e QKRMT.

Ka kaluar vetëm një vit e gjysëm që kur popullata shqiptare e Kosovës përjetoj vrasjet më të tmerrshme, masakrat më çnjerëzore, përdhunimet, varret masive torturat e jashtëzakonshme psikike e fizike dhe dëmtimet e infrastrukturës nga parmailtarë, ushtarë e policë serb.

Ky ishte një krim jo vetëm kundër shqiptarëve por një krim kundër njerëzimit në tërësi. Shqiptarët kanë ende kujtime të freskëta nga lufta. Nuk ekziston edhe asnjë mundësi që ata ndonjëherë do të mund të harrojnë vrasjet përvëluese të anëtarëve të familjes para syve të tyre. Të gjitha metodat e torturës ishin ushtruar ndaj tyre ndoshta edhe më tepër dëbimi pothuajse i një populli të një vendi nuk është parë ndonjëherë në Europën e civilizuar. Kjo ishte një përpjekje e shkatërrimit të dinjitetit dhe kulturës së popullit shqiptar. Por dëshira për liri ishte më e fortë se gjithçka. Për të u flijuan jetë të tëra të të gjitha moshave gjaku i tyre solli lirinë dhe shqiptarët për vite e vite të qenit

subjekt i torturës tani mund të frymojnë lirshëm.

Është e qartë që lufta ka mbaruar, por kjo nuk do të thotë që të gjitha problemet e popullit kanë përfunduar gjithashtu. Tani njerëzit duhet të ballafaqohen me realitetin e ri: ata duhet të jetojnë pa më të dashurit e tyre, shtëpitë e tyre janë shkatërruar, mijëra prej tyre ende po konsiderohen si të zhdukur dhe ekzistojnë pak mundësi që ata të jene ende diku gjallë. Në anën tjetër rreth një mijë shqiptarë po mbahen në burgjet e Serbisë, kushtet sociale dhe ekonomike të cilëve janë të papërshkruara. Vetëm para pak ditësh me mijëra protestues nëpër të gjitha qytetet e Kosovës protestuan për evakuimin e të burgosurve shqiptarë në burgun e Nishit dhe Pozharevcit të cilat ishin uzurpuar nga të burgosurit serb dhe kërcënonin për vrasje të burgosurit shqiptarë. Familjarë të të burgosurve dhe të zhdukurve gdhinë në rrugë para Teatrit Kombëtar për 13 ditë rresht duke vënë jetën e tyre në rrezik vetëm të dëgjonin ndonjë lajm për më të dashurit e tyre që nuk, dihej asgjë për jetën e tyre .Në emër të të gjithë popullit shqiptar lider të të gjitha partive, Shoqata e ish të burgosurve politik dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës nënshkruan një deklaratë Institucioneve më të larta ndërkombëtare për lirim të pakushte të të gjithë shqiptarëve pengje të luftës që mbahen në burgjet Serbisë.Ende deri më tani nuk është marrë ndonjë hap konkret nga ndërkombëtarët për zgjidhjen e çështjes së të burgosurve.

Pas gjithë atyre që ndodhën, gati askush nuk e besoi dhe priti që shqiptarët e Kosovës do të dinë të udhëheqin një jetë kaq dinamike. Ata po dëshmojnë çdo ditë që janë dhe duhet të jenë pjesë e demokracisë. Shembull më i mirë i kësaj është dëshmia para pak kohë e mbajtjes së zgjedhjeve elektorale në Kosovë.Nuk ndodhi edhe vetëm një incident gjatë periudhës elektorale dhe ditës së zgjedhjeve. Citat (ushtarët ndërkombëtarë të KFOR-it):”Na jepni me shumë ditë zgjedhjesh sepse ishte dita e vetme prej se kemi ardhur në Kosovë që nuk pati asnjë incident”.

Le të shpresojmë që kështu do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen.

MISIONI I QKRMT

QKRMT është një organizatë e pavarur joqeveritare jo fitimprurëse me qëllimin e sigurimit urgjent të trajtimit dhe rehabilitimit për kosovarët e traumatizuar si dhe ngritjen e kapacitetit dhe trajnimin e stafit të saj mjekësor dhe arsimor në Kosovë. QKRMT ka qendrën e saj kryesore në Prishtinë dhe gjashtë qendrat e tjera satelitë nëpër qytetet e Kosovës: Skënderaj, Podujevë, Gjilan, Suharekë, Pejë dhe Deçan.

OBJEKTIVAT

- Të fuqizojë viktimat e torturës për të rifituar kontrollin e jetës së tyre përmes sigurimit të këshillimit psikologjik individual dhe në grup dhe sigurimin e kushteve të tjera të nevojshme.
- Të organizojë trajnime për mjekët e përgjithshëm infermierë dhe mësues mbi PTSD në mënyrë që të parandalohet dhe lehtësohet agresioni dhe të forcohen potencialet psikologjike të fëmijëve dhe të rriturve.

- Të nxisë ndërgjegjen e popullatës mbi traumën dhe pasojat e torturës dhe të ndikojë në çështjet prevenuese të torturës në të ardhmen.

GRUPI I SYNUAR (TARGET)

- Viktimat e luftës dhe torturës
- Gratë(e perdhunuara,të veja etj.)
- Jetimët,personat që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes
- Ish të burgosurit politik
- Personat që kanë një ose më shumë anëtarë të familjes ende të burgosur ose të zhdukur

NGRITJA E KAPACITETIT TË STAFIT

Një pjesë e stafit të QKRMT ishte e angazhuar në shërbimin e rehabilitimit të shqiptarëve të traumatizuar të Kosovës të dëbuar me dhunë në Shqipëri nga terrori serbe dhe në këtë kohë ata fituan një eksperiencë të rëndësishme në shtjellimin e problemeve psikosociale. Kjo ishte hera e parë që stafi i ardhshëm i QKRMT ishte kyçur në problemet psikosociale. Mund të themi që ajo ishte vendimtare në hapjen e QKRMT. Gjatë punës në Shqipëri dhe më vonë pas ngritjes së QKRMT, stafi i saj përfitoi shumë e më shumë njohuri nga kurse trajnimi nga profesionistë të Danimarkës, Shqipërisë, Kroacisë, Holandës, Greqisë, Francës dhe Bullgarisë. Trajnimet konsistonin në identifikimin dhe mbështetjen e personave të traumatizuar,metodave të trajtimit: këshillimit, psikoterapisë, bodyterapisë, Gestalterapisë. Stafi administrativ i QKRMT po ashtu është trajnuar në çështje menaxhuese.

PËRJETIMET E KLIENTËVE

Pjesa më e madhe e klientëve kanë përjetuar trauma direkte.Llojet më të shpeshta të torturës të përdorura në klientët e QKRMT-s janë:

- Psikologjike-zhvendosje me forcë, fyerje ,kërcënime,dëshmitarë të vrasjeve,përdhunime dhe keqtrajttime,ndarje nga familja ,ekspozimi ndaj temperaturave të ulta dhe zërimeve të larta,marrja peng e anëtarëve të familjes,përjetime të shkatërrimit të shtëpive të tyre dhe pronësisë etj.
- Fizike-rrahje me mjete të ndryshme metalike,plagosje dhe gjymtime nga minat,annet,bombat,përdhunimet,deprivimi nga ushqimi dhe uji,ekspozimi në elektrohok etj.

TRAJTIMI

Mënyrat e trajtimit të përdorura në QKRMT terapia individuale, grupore dhe familjare.Llojet e trajtimit janë:

- Trajtimi mjekësor- i cili përfshinë konsultimet, përcjelljen e trajtimit, referimin në institucione të tjera specialiste
- Trajtimi psikologjik-i cili përfshin psikoterapinë mbështetëse, këshillimin, intervenimin në krizat akute dhe terapinë ekspresive – kreative.

Ne jemi duke punuar me instrumente diagnostikë që identifikojnë personat e traumatizuar dhe shkallën e përjetimit të traumës. Në të njëjtën kohë ne kemi marrë hapa drejt preventimit të pasojave somatike si rezultat i përjetimit të traumës. Ishte një aplikim i rëndësishëm i terapisë grupore tek ish të burgosurit dhe gratë e traumatizuara. Kjo ishte mjaft e suksesshme dhe dha rezultate mjaft të mira.

REGJISTRIMI DHE MONITORIMI I TRAJTIMIT

Historia e traumës dhe simptomat e çdo pacienti regjistrohen në dosjen e pacientit dhe asistimi i progresit gjatë seancave trajtuese vërehet nga personi i trajtuar ose të afërmit.

PUNA KËRKIMORE DHE DOKUMENTACIONI

QKRMT është e angazhuar në kryerjen e studimeve kërkimore në pacientët e saj për të identifikuar mbizotërimin e metodave dhe ekzekutimin e torturës, pasojave në populatë ,për të vlerësuar nevojat për ndihmë psikologjike, për të dokumentuar rastet e torturës dhe për të ngritur një strategji parandalimi.

QKRMT ka filluar të realizojë një studim kërkues mbi ndryshimet simptomatike te personat që kanë përjetuar direkt apo indirekt traumën. Kjo u aplikua në dy qendrat satelite deri më tani, por supozohet të vazhdohet edhe në qendrat tjera satelite.

ETNICITETI I KLIENTËVE

KRCT është e hapur për të gjithë kosovarët pa dallim feje apo origjine. Bazuar në nacionalitetin e klientëve shumica prej tyre janë shqiptarë, por janë po ashtu edhe një numër i minoritetit turk dhe boshnjak.

NGRITJA E KAPACITETIT PËR PERSONELIN SHËNDETËSOR DHE ARSIMOR

Stafi profesional i QKRMT-së është i përfshirë në sigurimin e kurseve trajnuese për mjekë, infermierë, paraprofesionistë mjekësorë, pedagogë, punonjës social dhe anëtarë të OJQ-ve lokale. Qëllimi i trajnimeve është ngritja e njohurive në fushën psikosociale të atyre që janë direkt dhe në kontakte të përditshme me njerëz që kanë

nevojë për ndihmë psikosociale. Ky do të ishte një kontribut i madh në identifikimin e njerëzve që kanë nevojë për ndihmë rehabilituese dhe referimi i tyre në institucione profesionale dhe organizata si QKRMT. Trajnimet janë mbajtur në formë seminaresh, Workshopesh dhe mbledhjesh.

PUBLICITETI

Fletushkat e QKRMT-së të cilat përshkruajnë personelin e saj, objektivat, target grupin dhe shërbimet mjekësore janë shpërndarë në vende publike si shkolla, spitale, posta etj. Gjithashtu fletushkat e QKRMT-së në "Menaxhimin e stresit" dhe "reaksioni ndaj traumës" janë publikuar gjatë qershorit '00 dhe shumica e tyre u janë shpërndarë pjesmarrësve në manifestimin e 26 qershorit. Intervistat e personelit të QKRMT-së në mediat elektronike dhe të shkruara lokale dhe ndërkombëtare ishin një hap i rëndësishëm në informimin e popullatës mbi aktivitetet e QKRMT-së, pasojat e torturës dhe traumës Komemorimi i 26 Qershorit-Dita Ndërkombëtare në mbështetje të viktimave të torturës ishte një arritje e madhe për KRCT-në. Por kjo nuk ishte arritje vetëm për KRCT-në. IRCT-ja na ndihmoi dhe na mbështeti në këtë aspekt. Shfrytëzova rastin për t'iu falenderuar të gjithë atyre që na mbështetën në këtë ditë veçanërisht Dr. Jens Modvig Sekretar gjeneral i IRCT-së and Suzanne Clark Drejtore për informim pranë IRCT-së. Më shumë informacione rreth komemorimit të 26 Qershorit mund të gjeni në Q T-Prezentimi. Po në këtë ditë u nënshkrua edhe Deklarata e Rehabilitimit psikosocial- kombëtar, Koekzistenca paqësore dhe Prevenimi i Torturës që nuk ishin bërë më përpara kurrë në Kosovë. Ajo u nënshkrua nga udhëheqësit e partive më të mëdha politike në Kosovë, pjesëmarrësit e minoritetit turk dhe zyrtarët e KB të akredituar në Kosovë.

BASHKËPUNIMI

- QKRMT është anëtare e Këshillit të Përkohshëm Administrativ të Kosovës.
- QKRMT është anëtare e kryesisë së Bordit të OJQ-ve.
- QKRMT është anëtare BAN-Networkut (rrjet bashkëpunimi i qendrave rehabilituese në Ballkan).

QKRMT bashkëpunon me shumë organizata lokale dhe internacionale qeveritare dhe joqeveritare.

QKRMT ka formuar një sistem referues me këto organizata: Kryqi i Kuq i Kosovës, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Departamenti i Psikiatrisë i Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës. Qendra e guas dhe fëmijës, ICMC, IOM, Mjekët pa kufij, World Vision, ICRS, Instituti Social-Skënderaj, Krings Kinder Nothilfe, Kinder Berg etj. Me disa nga organizatat e lartpërmendura KRCT-ja ka nënshkruar memorandume të mirëkuptimit. Q T ka nënshkruar një letër nënkuptimi me Tribunalin e Hagës për krimet e luftës me qëllim të trajtimit të personave të intervistuar dhe të referuar në QKRMT. Edhe pse lufta ka mbaruar ende ka me mijëra refugjatë shqiptar nga Kosova në vendet e tjera të botës. QKRMT ka bashkëpunim të mirë me organizatat që përkujdesen për refugjatët në vendet e caktuara. Në këtë kontekst do të theksoja bashkëpunimin që kemi me Suedinë me

Bordin e Migrimit të Suedisë dhe Kryqin e Kuq të Suedisë si dhe me Australinë përmes TRANSAKT-it.

Qëllimi i bashkëpunimit është shkëmbimi i informatave në mes të refugjatëve shqiptarë nga Kosova në vendet përkatëse dhe të kthyerit në Kosovë prej atyre vendeve si në aspekte psikologjike, trajtimin kushtet sociale dhe ekonomike etj.

Mendoj se është e rëndësishme të përmendet fakti se pas tre muajve të ndërmjetësimit të QKRMT-së dhe insitutit të TRANSACT-it në qeverinë Australiane 27 persona me familjet e tyre (80 persona) të cilët ishin në një gjendje shumë të vështirë psikologjike dhe kishin kushte shumë të vështira ekonomike janë pranuar të kthehen përsëri në Australi.

PLANET NË TË ARDHMEN

QKRMT është duke punuar rreth një strategjie të re të rehabilitimit të klientëve tanë. Kemi bërë draftin e parë të një publikimi rreth përjetimit të klientëve të trajtuar. Po ashtu jemi në përfundim e sipër të disa instrumenteve më të detajuara të cilat do të jenë në forma testesh dhe kartelash.

QKRMT po përgatitet rreth shtrirjes së aktivitetit të saj në Komunën e Mitrovicës.

Shaban Memeti

NEVOJA E NGRITJES SË QENDRËS SË REHABILITIMIT PËR TË MBIJETUARIT E TORTURËS NË MAQEDONI

KRONOLOGJIA E NGJARJEVE.

Fillimisht në mënyrë të shkurtër do të japim kronologjinë e ngjarjeve që kanë çuar në diskriminimin e popullsisë etnike shqiptare në trojet e ish- Jugosllavisë, në veçanti në Maqedoni në çdo aspekt, si atë: nacional, historik, social-kulturor, shëndetësor, të drejtën për të jetuar, për t'u edukuar, për të punuar, të drejtën e religjionit, të informimit, të kultivimit të identitetit nacional dhe kulturor, gjuhës dhe simboleve kombetare etj.

Kjo është një histori 50-vjeçare e diskriminimit të shqiptarëve, duke filluar që pas Luftës së Dytë Botërore, jo se përpara kësaj periudhe diçka e tillë nuk ka ekzistuar.

Pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët i nënshtrohen një terrori të paparë nga regjimi komunist i atëhershëm, rrihen, arrestohen, burgosen, vriten, terrorizohen se kinse disponojnë armë, por kjo ndodhte vetëm se ishin shqiptarë. Këtu duhet përmendur si kategori të burgosurit e pasluftës (NDSH – ja) dhe valën e burgosjeve të njohur me emrin periudha e Goli Otokut.

Më tutje e njëjta politikë ndiqet kundër shqiptarëve në sferën e mbledhjes së armëve të prirë nga Rankoviçi kundër dëshirës së shqiptarëve për liri dhe të drejta nacionale; në vazhden e ushtrimit të dhunës dhe terrorit shtetëror mbi disidencën politike (e cila asokohe ishte kryekëput shqiptare) dallojnë periudhat e demonstratave 1968, 1981, 1989 ...etj.

Ky diskriminim në Maqedoni bëhet akoma më i fortë gjatë periudhës së tranzicionit nga sistemi komunist në të ashtëquajturin demokratik. Këtu shqiptarët vazhdojnë të trajtohen si qytetarë të rendit të dytë, diskriminohen në çdo sferë të jetës, arbitrarisht arrestohen, burgosen, në shumë raste edhe vriten gjatë arrestimit, në burgje dhe kazerma janë viktima të një terrori, provokohen dhe keqtrajtohen nga policia dhe organet e ndjekjes vetëm se janë shqiptarë.

Nga këto ngjarje do të përmendim vetëm disa, ngaqë për këto mund të flitet e të shkruhet shumë nga profesionistë të fushave të caktuara.

Si ngjarjet e Bit Pazarit-Shkup, Ladorishtit-Strugë, ato gjatë themelimit të Universitetit të Tetovës, aferës së armëve, ngjarjet e Gostivarit, arrestimet dhe vrasjet gjatë luftës së Kosovës (Beqir Limani i vrarë në tetor të vitit 1998), vrasjet dhe arrestimet se gjoja po luftojmë terrorizmin shqiptar si p.sh. në Kërçovë, ato të Haraçinës, arrestimet në pikat kufitare si në aeroport, etj.

Pra, deri tani shteti maqedonas ka ushtruar çdo lloj torture pavarësisht nga ligjet e tij dhe konventat e dokumentet e OKB – së, të cilat i ka nënshkruar.

Ç'ËSHTË TORTURA?

Tortura është një nga shkeljet më alarmuese të të drejtave të njeriut në kohët tona. Ajo është një mjet i fortë kundër demokracisë e cila i dëmton njerëzit si nga ana fizike ashtu edhe ajo mendore. Tortura është përdorur si në të kaluarën por edhe sot ka shtete që fenomenin e torturës e shohin si një qëllim për të realizuar qëllime të ndryshme.

Përdoret si ndëshkim për të fituar informacion ose për t'i detyruar personat që të rrëfihen, për të përhapur frikë, tmerr, pasivitet tek njerëzit, për të pranuar diçka të paqenë ose ato të jenë si bashkëpunëtorë në procese të ndryshme.

Qëllimi i torturësve është që të shkaktojnë sa më shumë dhimbje, duke mos e lënë viktimen të vdesë, të shkatërrojë personalitetin e tij ose të saj dhe kjo të shërbejë për njerëzit të tjerë: opozitën politike, sociale, fetare, racore si një shenjë apo mjet presioni. Gjithashtu nëpërmjet torturës tentohen të thyhen njerëzit që po punojnë për përmirësimin e kushteve dhe ndryshimeve politike në vend.

TARGET GRUPI.

- Viktimat e torturës
- Ish të burgosurit
- Familjarët e ish të burgosurve
- Personat që ende kanë një ose më shumë anëtarë të familjes së tyre të burgosur ose të arrestuar, personat që merren “në biseda informative”

- Personat që kanë humbur një ose me shumë anëtarë të familjes së tyre
- Refugjatët që gjenden të strehuar në Maqedoni, jo si grup kryesor

KUSH JANË VIKTIMAT?

Në bazë të disa vlerësimeve përsa i takon moshës dhe gjinisë, mbi 80 % janë burra ndërsa pjesa e mbetur: gra, fëmijë dhe pleq.

Më shumë të prekur kanë qënë njerëzit me peshë si: liderë partiak, udhëheqës komuniteti, gazetarë, njerëz të religjionit tjetër, veprimtarë për të drejtat e njeriut, njerëz të arsimit, shkencës, kulturës, mjekë, njerëz të rëndomtë që kanë ndodhur rastësisht në rrugë, banesa, shtëpi, lokale, shkolla etj; pra dominante është origjina etnike.

LLOJET E TORTURËS

Tortura është shprehur në forma të ndryshme varësisht nga personi, gjinia, koha, rëndësia e tij në shoqëri dhe qëllimet që torturuesit kanë dashur të arrijnë.

Torturat kanë qënë fizike si: goditjet me grushta, këmbë apo mjete të forta si shkopinj gome apo shkopinj druri, shufra metalike, dërrasa, rrahje brutale, zhytjen në ujë të ndotur dhe mbajtja e kokës deri në asfiksi, goditjet në shputat e këmbëve, goditje në majë të gishtave me mjete të forta, goditje në regjionin e veshkave, goditje në kokë dhe pjesë delikate të trupit, shokun elektrik në zonat e ndjeshme përfshirë këtu edhe organet gjenitale, shkuljen e thonjëve, prerjen e lëkurës me sende të mprehta, varjen, uljen në pozicione jonormale, lagia me ujë të ftohtë lakuriq, nxemja e shufrave të hekurit dhe vendosja në pjesë të ndryshme të trupit, futja në kuti të vogla dhe mbajtja disa ditë, kafshimet me dhëmbë, lënia xhveshur për disa ditë në temperatura të ulta, qëndrimi në majë të gishtave drejtë për muri....etj

Torturat psikologjike përfshijnë si: Duke parë se si torturonin njeriun e afërt, fëmijët, gruan, burrin dhe njerëz të afërt të familjes, torturuesit bënin sikur do ta ekzekutonin(ekzekutim i rremë), ia lidhnin sytë me ndonjë copë të zezë dhe hapnin zjarr aty pranë pa e qëlluar atë, të mbijetuarit janë shprehur se u është thënë se nëse nuk janë kooperues do të keqtrajtohet farqilja e tij dhe do të ekzekutohet, praninë gjatë torturimit të të tjerëve, detyrimin për të torturuar të tjerët, i izoloni, u futnin ujë dhe substanca tjera nën lëkurë, i shponin me mjete të ndryshme, i çonin të dëgjojnë se si qanin, ulurisnin apo piskatnin të burgosurit të tjerë, qëllimisht që këta ti kapë frika dhe tmerrin pasi edhe për këto mund të vrente e njëjta gjë, i kërcënonin se po të flisnin me të burgosur të tjerë, të kërkonin ndihmë mjekësore, të ankoheshin te mbykqyrësi i burgut do ta pësonin më keq. Sharjet, fyerjet në baza kombëtare ishin një refren i zakonshëm, se do ta paguani shtrenjtë për aktivitetin kundërligjor që po bëni, se ju doni të drejta më shumë dhe tani ne u japim të drejtat që u nevojiten juve shqiptarve në fakt nuk thuhej shqiptarë por "shiptari" apo "shiftari" term fyes ky për ne shqiptarët, se jeni për republikën e Kosovës apo ju doni Shqipërinë e Madheetj

Gjithashtu në këto burgje apo vende ku bëhej kjo torturë kishte edhe **tortura seksuale:** ku përfshiheshin abuzimet verbale, poshtërimin, zhveshjen, përdhunimin me mjete të ndryshmeetj

SA KANË ZGJATUR TORTURAT?

Kohëzgjatja e tyre ka qenë e ndryshme me minuta, orë, ditë, muaj apo vite. Këto fillonin nga momenti i parë i kontaktit me torturuesit deri sa ato e shihnin të arsyeshme që të torturonin atë person vetëm e vetëm që ai të pranonte akuzën apo akuzat dhe të shpallej fajësia e tij. Shumica e torturave kanë mbaruar me vrasje apo lëndime të rënda. Marrja në të ashtuqujturat "biseda informative" është e zakonshme për strukturat e policisë apo njerëzve të sigurimit të shtetit.

Torturat fillonin në rrugë, lokalet afariste, shtëpi private, banesa, institucione të ndryshme, ambiente të tjera etj; vazhdonin gjatë momentit të arrestimit, periudhës së paraburgimit, procesit gjyqësor e deri në burg.

Në këtë rast suspendoheshin të gjithë normat, pra ligjet dhe rregullat e shtetit juridik, si ajo e shkresave për arrestim, procedurave policore, paraburgimit, kundërvajtjes penale etj.

SI KA QENË E ORGANIZUAR VIOLENCA?

Violenca në përgjithësi ka efekte të cilat janë të ngjashme me torturën. Si një akt apo pjesë e një strategjie të vetëdijshme tortura prek individët e veçantë dhe grupe njerëzish të një kompaktësie si në raste politike, religjioze, grupeve etnike, kundërshtarëve të regjimit, të burgosur, opozitar etj..

Tortura në përgjithësi është ushtruar gjithashtu edhe ushtrohet nga regjimi, do të thotë shteti përkatës si përpara ndryshimeve ashtu edhe tani.

Pra qeveritë me mekanizmat e tyre si policinë, njësitë speciale, mjetet transportuese, gazin lotësjiellës, përdorimi i armëve, autobllinda, njësitë e sigurimit shtetëror, burgjet si psh.burgu i Idrizovës ku shqiptarët aty trajtohen si të veçantë, gardianët e burgut dhe punonjës të tjerë, kazernat ushtarake, janë ekzekutuesit e torturave. Në kazernat ushtarake dhe burgje bëhet një segregacion i madh i shqiptarëve.

ÇFARË EFEKTESH KANË PËSUAR TË TORTURUARIT.

Dëmtimet që kanë pësuar të torturuarit janë: gjakderdhje nga hundët, plagë të ndryshme në trup, prerje të lëkurës apo edhe ndonjë pjesë tjetër të trupit, prerje të ekstremiteteve deri në kockë, ekimoza, hematoma në sy, fisura, fraktura të kockave veçanërisht brinjëve, kockës së hundës, thyerje dhëmbësh, hematuri, asfiksioni i shumicës së torturuesve, alivanosje, koma, dëmtime të kafkës dhe hemoragji trurorë, arreste kardiake, çregullime të tensionit, infarkte të miokardit, ankthe, dëmtime të veshkëve dhe organeve tjera të brendshme, parestezi dhe paraliza të ndryshme..etj. Si përfundim tragjik i shumë të torturuarve ka qenë vdekja.

KONSEKUENCAT TIPIKE TË TORTURËS

- Ankth
- Mohim i asaj që ka ndodhur
- Shqetësime gjumi
- Dhimbje kronike
- Irritim
- Vështirësi përqëndrimi
- Sëmundje kronike
- Flashback-e
- Tendence për izolim
- Dhimbje koke
- Vetëbesim i ulët
- Humbje e dëshirës për të jetuar
- Depresione
- Ndjenjë faji
- Makthe natën
- Humbje kontrolli
- Çrregullime psikosomatike
- Hiperndjeshmëri
- Frikë nga e ardhmja
- Stresi
- Izolim
- Inat
- HTA
- Frikë
- Respekti i ulët për veten
- Arritmi
- Ulcus duodeni
- Konfuzione
- Çrregullime bipolare
- Zorra e irritueshme
- Agresivitet
- PTSD
- Konflikte në familje
- Apati
- Reagime të forta
- Dhimbje kronike të shpinës
- Qafës, nyjeve, shpatullave
- Vetëvrasjet

ÇFARE OFRON SHTETI?

Si shtresa më e persekutuar e shoqërisë, shteti nuk ofron konkretisht asgjë për këto persona.

Këto nuk kanë asnjë lloj përfitimi nga instuticionet përkatëse, pra janë lënë në mëshirë të fatit dhe si pasojë e kësaj gjendja e tyre shëndetësore shkon akoma duke u keqësuar.

Këto persona nuk janë të integruar në asnjë resor të shoqërisë me përjashtim të

atyre personave ku konsekuencat e torturës kanë qenë më pak të theksuara .

Nuk kanë punë, pensione, sigurime si ato shëndetësore, invalidore apo pensional.

Pra pasojat që theksuam më lartë e kanë shoqëruar viktimën vite me rradhë pas ushtrimit të dhunës duke ndikuar gjithashtu tek familja dhe miqtë,dhe duke e bërë të pamundur drejtimin e një jete normale.

Nga shteti këto nuk kanë të drejtën për reperacion ku reperacioni përfshin: të drejtën për rehabilitim, rimbursim, satisfaksion dhe garanci për mospërsëritje.

OBJEKTIVAT TONA

- Egzaminimi dhe dokumentimi i torturës mbi baza mjekësore.
- Diagnostifikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e të mbijeturve të Torturës.
- Të fuqizohen viktimat e torturës për të rifilluar kontrollin dhe cilësinë e jetës së tyre që këto të jenë pjesë e shoqërisë.
- Të rivendoset statusi mendor, fizik dhe social i tyre.
- Evidentimi i rasteve të torturës në stacione të policisë, burgje, kazerma dhe ambiente të tjera.
- Të ndihmohen viktimat e torturës në përmirësimin e jetës së tyre psikologjike, përmes këshillimeve psikologjike në grupe apo individuale dhe sigurimi i kushteve të tjera të nevojshme.
- Të organizohen trajnime të mjekëve të përgjithshëm, infermerëve dhe mësuesve të shkollave mbi PTSD, në mënyrë që të parandalohet dhe lehtësohet agresioni dhe të forcohen potencialet psikologjike të fëmijëve, të të rriturve dhe konsekuencave të torturës.
- Të ndërjegjësohet popullsia mbi traumën dhe pasojat e torturës, përmes botimit të broshurave të nevojshme profesionale.
- Të ndikohet në parandalimin e torturës në të ardhmen.
- Të proklamohen konventat ndërkombëtare dhe ligjet aktuale rreth torturës.

Të gjithë këto objektiva shpresojmë ti realizojmë me një trajtim multiprofesional si: mjekë, psikoterapeut, psikiatër, psikolog, punëtorë social, motra medicinale, spencialistë të fushave përkatëse dhe do të kërkojmë një bashkëpunim të mirëfilltë me organet policore, gjykatat dhe instucionet shëndetësore të vendit. Këtu nuk duhet harruar edhe mbështetja e RCT dhe qendrës së Tiranës e Prishtinës ku kontaktet me këto të fundit tashmë janë realizuar dhe shpresojmë se do të jenë mbështetës të fortë që kjo qendër sa më shpejtë të ngrihet.

MATERIALET E SHFRYTËZUARA

1. Grim Human Rights Violations in the Republic of Macedonia, Information and facts from the democratic forum for defense of human rights in Gostivar Macedonia. Translator and editor Olav Johannes Breilid, 1995
2. Raporte të Forumit Demokratik për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive

- të Njeriut në Maqedoni – Gostivar
3. Intervista me ish – të burgosur dhe familjarë të tyre, të arrestuar e të marrë në biseda informative.
 4. Materiale nga Shoqata e ish të Burgosurve Politikë Shqiptarë në Maqedoni, Tetovë.

NIAZI JAHO

DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT NË FRYMËN E DOKUMENTAVE NDËRKOMBËTARE DHE KUSHTETUTËS TONË.

PAK HISTORI

Si kategori juridike të drejtat e njeriut janë paraqitur me krijimin e shteteve, ndërsa shtytje të ndjeshme u kanë dhënë atyre, revolucionet borgjeze që dolën me parrullën “ Liri, vëllazëri, barazi”.

Vlerë historike kanë patur karta e madhe e Lirive (1215), Ligji për të Drejtat e Njeriut (1689). Deklarata për Pavarësinë e SHBA (1776), Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (1789).

Fillesat e të Drejtave Njerëzore janë pra shumë të lashta.

Për herë të parë ato u vunë në themelin e teorisë dhe të praktikës politike në Evropën e shek.17.

Traktati mbi qeverisjen e Xhon Lokut e vitit 1688 pas revolucionit britanik që rrëzoi mbretin Xhejms i II përfaqësonte teorinë e parë mbi të drejtat natyrore. Në këtë traktat veç të tjerave thuhej se individë të veçantë kanë të drejtë të natyrshme për jetën,

lirinë dhe pronën. Për ti krijuar këto të drejta njerëzit formojnë shoqëri dhe më pas këto shoqëri formojnë qeveri. Sipas Lokut qeverisja mbështetet nga një kontratë shtetërore. Shtetasit janë të detyruar të binden vetëm nëqoftëse shteti mbron të drejtat e tyre njerëzore të shtetasve të tij. Megjithëkëtë Loku paraqitet me kufizimet e tij. Ai mbron të drejtat e burrave, pronarë Evropianë. Kurse gratë anëtarët e fiseve të pazhvilluara, shërbëtorët dhe argatët nuk i njihen si njerëz me të drejta.

Të drejtat e njeriut përbëjnë një temë të konsideruar marrëdhëniesh ndërkombëtare për rreth gjysëm shekulli. Para luftës së dytë botërore edhe për masakra genocidiale reagimi shprehej vetëm me disa deklarata mosmiratimi thuajse tërë mirësjesllje. Mënyra e trajtimit të qytetarëve nga një shtet i caktuar brenda territorit të vet konsiderohej si një çështje e brendshme.

Edhe klauzola “idealistë” e Lidhjes së Kombeve nuk i përmend të drejtat e njeriut si objekt i ligjshëm vëmendjes ndërkombëtare Holokausti gjatë të cilit nazistët gjermanë u përpoqën të eliminojnë sistematikisht çifutët, bëri që problemi i të drejtave të njeriut të vihej në qendër të vëmendjes të marrëdhënies ndërkombëtare. Mirëpo edhe pse mizoritë naziste qenë tepër tronditëse, komunitetit ndërkombëtar i mungonte formulimi politik dhe ligjor për t’i dënuar. Kjo ndodhte edhe për faktin se masakrimi i shtetasve nga vetë shteti i tyre nuk quhej dhunim i sanksionuar ligjërisht në shkallë ndërkombëtare. Në zhvillimet e gjyqeve të Nurembergut për krimet e luftës (1945-1946) u fut akuza e panjohur më parë për krimet kundër njerëzimit. Për herë të parë zyrtarët detyroheshin të jepnin llogari ligjërisht përpara komunitetit ndërkombëtar për shkelje të kryera kundër shtetasve të veçantë si edhe kundër individëve të tjerë që në mjaft raste ishin bashkëkombës jo të huaj.

Megjithëkëtë, të drejtat e njeriut, në të vërtetë dalin si objekt i marrëdhënies ndërkombëtare vetëm në organizatën e kombeve të Bashkuara (OKB). Pra të drejtat e njeriut zënë një vend kryesor në kartën e OKB-së të miratuar në 1945. Kjo organizatë e re përparoi me shpejtësi në përpunimin e normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në 10 Dhjetor 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut. Kjo listë e gjerë të drejtash kodifikonte pikpamjen e re që po dilte në dritë, se mënyra me të cilën i trajtojnë shtetasit e tyre nuk është vetëm një shqetësim ndërkombëtar i ligjshëm, por edhe subjekt i standarteve ndërkombëtare. Akoma më të rëndësishme ishin konventat ndërkombëtare.

Mirëpo, meqënëse shtetet janë të lirë të hyjnë ose të mos hyjnë në traktate, detyrimet e ligjit ndërkombëtar, në rastet më të shumta vendosen mbi baza vullnetare.

Megjithëse në mesin e viteve 60 normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut u ndërkombëtarizuan, zbatimi i tyre mbeti një çështje thuajse kombëtare.

- Në vitet 1960 dhe 1970 komisionit të OKB-së për të drejtat e njeriut iu dhanë përgjegjësi për të shqiptuar shkeljet e të drejtave të njeriut në vende të veçanta. Por çështja e të drejtave të njeriut si një çështje ndërkombëtare u arrit të bëhej në vitin 1977 pikërisht në kohën kur Xhimi Karter u bë President i SHBA.

Zhvillimet pas Luftës së Ftohtë.

Forcuan procedurat që kishin të bënin me të drejtat e njeriut në planin shumëpalësh, dypalësh dhe ndërshtetëror. U krijua komisioneri i lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut. Megjithëkëtë çështjet e të drejtave të njeriut në planin ndërkombëtar vazhdojnë të shkaktojnë debate politike, psh. Në Konferencën Botërore mbi të Drejtat e Njeriut që u mbajt në Vjenë (1993) një numër i vogël vendesh u ngritën (ndonëse pa sukses) kundër përpjekjeve për t'ju përmbajtur standarteve të sanksionuara në Deklaratën e Përgjithshme dhe Konventave të tjera.

Gjatë Luftës së Ftohtë genocidi në Kamboxhia u prit vetëm me shprehje keqardhjeje. Po krejt ndryshe ndodhi në Ruanda në vitin 1994 ku komuniteti ndërkombëtar, iu përgjigj genocidit me ndërhyrje ushtarake (Në Kosovë në vitin 1998).

Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut është quajtur thelbësore që të drejtat e njeriut të mbrohen nga një rregjim ku të sundojë ligji me qëllim që njeriu të mos jetë i shtrënguar të përdorë mjetin e fundit që është kryengritja kundër tiranisë dhe shtypjes.

Të gjitha qëniet njerëzore thuhet në këtë deklaratë janë të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe të të drejtave. Deklarata përfshin 30 nene.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (E ndryshuar sipas Protokollit N.11)

Kjo konventë është nënshkruar në Romë në 4 Nëntor 1950 dhe ka hyrë në fuqi në 3 Shtator 1953.

Qysh në fillim të saj thuhet se Qeveritë Nënshkruese Anëtare të Këshillit të Evropës kanë parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 Dhjetor 1948.

Në këtë konventë bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë, siç janë e drejta për jetën, ndalimi i torturës, skllavërimi dhe i punës së detyruar, e drejta për liri dhe siguri, për një proces të rregullt gjyqësor, respektimin e jetës private dhe familjare, e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, lirisë për tubime etj.

Konventa ka edhe disa protokolle

Kështu psh. Prot.Nr.1 ku bëhet fjalë për mbrojtjen e pronës. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike por gjithmonë në kushtet e parashikuara me ligj dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Në këtë protokoll flitet gjithashtu për të drejtën për edukim, për të drejtën për zgjedhje të lira.

Prot.Nr. 4 Viti 1968

Ndalimi i burgimit për borxhe.

Liria e lëvizjes.

Ndalimi i dëbimit të shtetasve. Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve etj.

Prot.Nr.6 Viti 1985

Heqja e dënimit me vdekje.

Ka edhe protokolle të tjera
Pas përmbyesjes së rregjimit të mëparshëm totalitar duhet që ne shqiptarët të ndërtonim një shtet të ri demokratik me legjislacionin e vet gjithashtu demokratik.

Në fushën e legjislacionit hapi i parë i rëndësishëm që u hodh ishte ai i 29 Prillit 1991 kur kuvendi pluralist shqiptar, miratoi ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ky ligj shfuqizoi Kushtetutën e R.P.S të Shqipërisë të vitit 1976.

Në nenin 44 të këtij ligji thuhet se dispozitat e këtij ligji veprojnë deri në miratimin e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, projekt i së cilës do të hartohet nga komisioni i posaçëm i ngarkuar nga Kuvendi Popullor.

Nga viti 1991 deri në Mars 1993 kushtetuta nuk u miratua. Në 31 Mars 1993, Kuvendi Popullor miratoi ligjin “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Kjo ishte një pjesë e kushtetutës së ardhshme, por jo kushtetuta.

Edhe gjatë vitit 1993 u bënë përpjekje për të hartuar kushtetutën por nuk u bë gjë, ndërsa në vitin 1994 siç e dini, një projektkushtetutë që u dërgua për miratim direkt në referendum nuk fitoi. Kështu edhe në vitin 1994 mbetëm pa kushtetutë.

Në vitin 1995 Shqipëria u pranua anëtare e Këshillit të Evropës. Pas kësaj aq më tepër ndihej nisja e hartimit të Kushtetutës së re. Në të vërtetë deri në vitin 1998 kushtetuta nuk u miratua. Në nëntor të vitit 1998 Projekt Kushtetuta ndoqi rrugën komision-kuvend-referendum dhe u dekretua nga Presidenti i Republikës në 28 Nëntor, 2000 pra në 28 të muajit të kaluar ishte dyvjetori i kësaj kushtetute.

Ata që janë njohur me këtë kushtetutë që nuk e kanë parë atë me syrin partiak, por me objektivitet janë bindur dhe në vazhdim do të forcojnë bindjen se ajo edhe pse mund të mos jetë e përsosur është një dokument historik që mbështetet në përvojën tonë 8-veçare si dhe në përvojën më të mirë të vendeve të tjera demokratike.

Pyetja e parë që mund të bëhet mund të ishte:

Çfarë është kushtetuta?

Kushtetuta është ligji themeltar i shtetit që shpesh parimet themelore të sistemit juridik. Kushtetuta është dokumenti që përcakton normat themelore të organizmit të shtetit, strukturën dhe funksionet e organeve kryesore të shtetit, parimet bazë të procesit politik si dhe marrëdhëniet bazë të shtetasve me shtetin.

- Kushtetuta jonë është në përputhje me dokumentat që përmendëm më lart d.m.th. me Kartën e Kombeve të Bashkuara (Deklaratën Universale) dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Ajo përbëhet nga 183 nene, ndërsa në 45 nene ose mbi 24% bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë e shtetasve. Kështu në kreun I flitet për parimet e përgjithshme ku mbështeten këto të drejta në Kreun II për liritë dhe të drejtat vetjake, në Kreun III për liritë dhe të drejtat politike, në Kreun IV për liritë dhe të drejtat ekonomike, kulturore dhe në Kreun V për objektivat sociale.

Të drejtat dhe liritë themelore qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik. Organet shtetërore jo vetëm duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por edhe të kontribuojnë për realizimin e tyre.

Ju sigurisht keni dëgjuar të përdoren dy terma: Shtet dhe pushtet. Në fakt pushteti nuk është gjë tjetër veçse shprehje e shtetit. Pushteti është ose aftësia që imponon një urdhërim, një rregull sjelljeje ndaj një tjetri. Pushteti shtetëror ka në dispozicionin e vet një aparat të posaçëm.

Në një kuptim të përgjithshëm pushteti është ai që merr vendime , lëshon urdhra dhe siguron zbatimin e tyre.

Ju e dini ose keni dëgjuar gjithashtu se sipas nenit 7 të kushtetutës sistemi i qeverisjes tek ne bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve : ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Në nocionin e shtetit juridik përfshihen dy pjesë përbërëse:

- a) Qënësia e shtetit me aparatën përkatës të tij.
- b) Qënësia e së drejtës së ligjit në kuptimin e gjerë të fjalës.

Shtetit i duhet ligji për të realizuar funksionet e tij. Ligji pa shtetin nuk do të kishte asnjë kuptim. Raporti midis shtetit, shoqërisë dhe individit rregullohet me ligje. Në shtetin e së drejtës, ligjet mbrojnë interesat e gjera të shoqërisë duke i dhënë përparësi interesave të ligjshme të shtetasve. Mendoj se duhen konceptuar drejt çështjet që do të trajtoj më poshtë:

Së pari – Edhe në demokraci nuk mund të ketë liri dhe të drejta të pakufizuara. Është kjo arsyeja që në nenin 17 të Kushtetutës thuhet :

“ Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligje për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjëndjen që e ka diktuar atë.”

Veç kësaj:

Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në një mënyrë nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Le ta konkretizojmë këtë me disa shembuj:

- Sipas nenit 27 të Kushtetutës askujt nuk mund t’i hiqet liria përveçse në rastet e parashikuara në ligj (kur personi është dënuar më burgim, kur nuk zbaton urdhëresat e ligjshme të gjykatës, kur dyshohet se ka kryer një vepër penale etj.).

Në nenin 33 thuhet se kushdo ka të drejtë të dëgjohet përpara se të gjykohet, por nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë ai që i fshihet drejtësisë. Në Kushtetutë garantohet paprekshmëria e banesës por në rastet e parashikuara me ligje ky kontroll mund të ushtrohet. Sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës private është e garantuar por ligji mund të parashikojë shpronësime dhe kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm për interesa publike.

Kushtetuta garanton lirinë e tubimeve paqësore dhe pa armë, por tubimet në vendet e kalimit publik ose në sheshe publike duhet të merret më parë leje nga organet kompetente.

Në nenin 18 të Kushtetutës veç të tjerave thuhet se askush nuk mund të diskriminohet për shkak të bindjeve politike (ky është parimi i përgjithshëm). Bindjet e njerëzve as rregullohen dhe as imponohen me ligje. Depolitizimi në disa institucione shtetërore do të thotë të mos ushtrosh aktivitet politik, partiak, të zbatosh me rigorozitet ligjin, por t'i psh. ke të drejtë të votosh për kandidatin apo për partinë politike që dëshiron. Për mua i depolitizuar është jo ai që bërtet ose ngre zërin se është i depolitizuar, por ai që autoritetin më të lartë konsideron ligjin.

Për të gjithë është e qartë se të drejtat e njeriut, barazia para ligjit, drejtësia shoqërore dhe pluralizmi do të kishin karakter deklarativ në qoftë se mbrojtja e tyre nuk do të garantohej në fakt.

Ky është një proces i gjatë i ndërlikuar dhe kompleks. Ai ka të bëjë me shumë faktorë politikë, ekonomikë, social-kulturore, psikologjik, historik etj.

Çdo vend ka specifikat e veta që duhet të njihen, të studiohen në mënyrë të gjithanshme dhe me objektivitet.

Shteti juridik nuk është një nocion abstrakt. Veprimtaria e tij rrezaton për të mirë apo për të keqe tek njerëzit, sepse pikërisht ai duhet të vihet në shërbim të tyre. Është kjo edhe një nga arsytet që shpesh kemi dëgjuar të thuhet “nuk ka shtet!” ashtu siç dëgjojmë edhe shprehjet “shteti ka filluar të ndihet”.

Shtetasit duan rend dhe qetësi. Ata duan që hallet dhe kërkesat e ligjshme që mund të kenë t'u zgjidhen shpejt, drejt, dhe pa rryshfete. Taksa paguesit kanë të drejtë të dinë se ku shkojnë dhe si përdoren ato .

Me kushtetutë, siç dihet gjykatat janë të pavarura. Shtetasit për ankesat, kërkesat apo konfliktet që mund të kenë i drejtohen edhe gjykatës.

Kjo është e drejta e tyre. Por ata kanë të drejtë të ndihmohen, të reagojnë kur zgjidhja e çështjes zvarritet me muaj dhe vite, gjë që i jep shkas pakënaqësive, pse jo edhe vetëgjyqësisë.

Shteti juridik nënkupton demokracinë. Ai përjashton anarkinë. Shteti juridik nënkupton zbatimin rigoroz të ligjit. Ai përjashton paligjshmërinë, arbitraritetin.

Të jesh demokrat do të thotë të respektosh institucionet dhe të zbatosh normat demokratike të karakterit ligjor dhe moral. Para ligjit janë të gjithë të barabartë. Kështu thuhet në Kushtetutë. Por nuk do të thotë se kjo normë është zbatuar në çdo rast (shembull konkret : qytetari merret me detyrim për të dëshmuar në gjykatë, kur ai refuzon, funksionari, lodër partiake, jo) ose kur një shofer i thjeshtë shkel rregullat e qarkullimit gjobitet, ndërsa për një shofer që drejton makinën e një funksionari heziton.

Në zbatimin e ligjeve edhe partitë politike nuk kanë ndonjë privilegj. Edhe ato janë të detyruara të zbatojnë ligjet madje në propagandën e tyre në asnjë rast nuk duhet të bëjmë thirrje për t'iu kundërvënë ligjit ose për të kaluar në veprime vetëgjyqësie. Natyrisht që ligjet nuk janë statike. Ato mund të ndryshojnë, por në rrugë të drejtë dhe të ligjshme.

Ligjet dhe veçanërisht të drejtat e shtetasve duhet ti njohin të gjithë shtetasit. Por kuptohet duhet të njohin edhe detyrimet që ata kanë. Me leje ndërtimi të rregullt askush nuk të ndalon të ndërtohet, por kur merr guximin të ndërtohet pa leje merr përsipër edhe rrezikun. Ne duam të kemi dritë ditë e natë. Kjo është normale. Kur nuk kemi drita,

ngremë zërin , kritikojmë. Por në këtë drejtim duhet të jemi në rregull, të mos abuzojmë, të paguajmë detyrimet dhe kështu me rradhë.

Ligjet shkelen me dashje, por edhe nga pakujdesia apo mos njohja. Kur më sipër thamë se ligjet duhet të njihen nga të gjithë kemi parasysh se është detyrë e çdo dikasteri e çdo sektori të njohin sidomos ato ligje specifike që veprojnë në to.

Por mbi të gjitha qëndron kushtetuta që është burim i tërë legjislacionit. Është pikërisht kjo arsyeja që vazhdon puna për harmonizimin e legjislacionit me kushtetutën.

LUAN KROI

EKSPERIENCA E INSTITUTIT TË INTEGRIMIT TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NË SHQIPËRI

U krijua me ligjin Nr. 8246 Dt. 01.10.1997 dhe filloi punën më 1 Janar 1998, me strukturën dhe organikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave me 3 drejtori kryesore dhe një sektor si edhe degët e saj nëpër rrethe, me një numër prej 64 personash.

Në drejtorinë e problemeve sociale, në rregulloren e funksionimit jepen detyrat ku ndërmjet të tjerash janë:

- Studimi i nevojave, të të përndjekurve politikë nga rregjimi komunist, për çështjet kryesore jetësore si : strehimi, punësimi, shkollimi, kualifikimi, mbrojtja në punë, rehabilitimi shëndetësor etj.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme shoqërore për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave moralopolitike e shoqërore të kësaj shtrese.

Është evidentuar genocidi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1990:

“A” Të Ekzekutuar	5577 Burra	450 Gra
“B” Të Burgosur Politikë	26768 Burra	7367 Gra

“B ¹ ” Të Vdekur në Burgje	977 Burra	7 Gra
“A ¹ ” Me humbje Aftësish Mendore që sot janë midis nesh	308 Persona	
“C” Të Internuar	48217 Burra	10792 Gra
Të vdekur në Internim	7022 Persona	

Dhuna dhe Genocidi i ushtruar ndaj bashkevuajtësit tanë; ia ka kaluar dhe diktaturave më të egra në vende të tjera, sa mund të themi se nuk ka penë e tregimtar që mund të ritregojë një të njëmijtën e atyre që hoqën ish të burgosurit dhe të përndjekurit politikë dhe familjet e tyre në Shqipëri, duke shkaktuar trauma dhe tragjedi të pashlyeshme në popullin shqiptar.

Hekurat në duar e këmbë i ndanë nga jeta duke shkaktuar vdekjen për së gjalli. Familjeve dhe të afërmve askush nuk u fliste. Fëmijët ishin tmerrësisht të izoluar e të përçmuar . Duke u mohuar lirinë dhe të drejtat më elementare.

Një vdekje më e tmerrshme i priste në dhomat e hetimit ku xhelatët sadistë përdornin metodat më çnjerëzore të torturave.

Koha e gjatë në vendin e vuajtjes pavarësisht si e kishte emrin: Burrel, Gjirokastër, Spaç, Ballsh, Qafë-Bari, Tepelenë, Maliq. etj. mund të quhej vdekje tjetër përsë- gjalli. Janë ngritur mal me shpifje si : spiunë të agjenturave te huaja, armiq të rrezikshëm kundër popullit, terroristë, vrasës, komplotistë kundër lirisë së atdheut etj.

E megjithatë populli jetonte si në agoni për inerci, dhe asnjëherë nuk mendonte për tu hakmarrë.

Kur e ashtëquajtura demokraci erdhi apo e prunë në Shqipëri, të përndjekurit politikë vdiqën edhe njëherë, sepse të gjithë ëndrrat, durimi, vuajtjet shkuan kot. Mashtrimi u bë në mënyrën më mizore.

Të gjithë ata që në kampe e burgje urreheshin, befasisht së bashku me ekzekutorët e të përndjekurit politikë u bënë zotër të vendit. Një forcë e pa shpjeguar i ngriti ata në frone që përsëri të shikonin dhe të gjykonin të persekutuarit politikë duke shkaktuar një vdekje të dhimbshme më e dhimbshme se të gjitha vdekjet e tjera e cila mjerisht vazhdon edhe sot.

Në këto vite të mbrapshta, si pasojë e drejtimeve të këqija, është vdekja më e madhe, më e dhimbshme më tragjike.

Pa asnjë përkrahje , ndihmë , pa asnjë shpresë, ne jetojmë nën presionin e “afaristëve” tanë, nën sharjen dhe ironinë e persekutorëve tanë.

Në këto rrethana instituti për plotësimin e kërkesave, me karakter urgjent të ish të dënuarve politikë sipas ligjit Nr.7598 dt. 01.09.1992 ka administruar fondin buxhetor sipas kriterëve të V.K.M. Nr.513 dt. 26.10.1993.

Ka dhënë për ndihmë ekonomike simbolike në vitin 1998 Lekë, 2.973.800; në vitin 1999: Lekë 2.710.000, ndërsa për vitin 2000 Lekë 1.372.630

Sot kemi pa strehë 46 “A¹” nga të cilët 25 në Tiranë. Kemi shumë të burgosur politikë të moshuar pa familje të cilët kanë nevojë për asistencë. Për të cilët mendojmë ndërtimin e një azili bashkëkohor.

Instituti ynë po punon për:

1. Barazimin e të drejtave të statusit të Ish të Përndjekurve Politikë me statusin e veteranit të Luftës Nacional Çlirimtare.
2. Përmirësimin e legjislacionit të rritjes së pensioneve, të cilat nuk janë marrë parasysh deri tani nga qeveria .
3. Për të aksidentuarit në kampet e internimit, që tu krijojmë mundësinë e ngritjes së qendrave te riaftësimit.
4. Kurimi falas.
5. Përfitimi i barnave falas.
6. Udhëtimi me mjete komunikacioni falas etj.

Të drejta që jepen edhe me ligjin Nr.7748 dt. 29.07.93 Neni 12 mbi statusin. Përfundimisht jemi dakort me 3 pritshmëritë nga ky Workshop.

AFËRDITA ONUZI

MIRËNJOHJE PËR MIQTË E MIRË SI BERIT BACKER

Për herë të parë jam njohur me etnologen Berit Backer në dhjetorin e vitit 1990. Çuditërisht, pas një bisede që zgjati rreth një orë, ne u ndjemë shumë të afërta me njëra – tjetrën. Etika e përdorur në raste të këtilla pothuajse nuk funksionoi. Fillimisht mendova se vetë profesioni i etnologut i afron njerëzit më shumë me njëri tjetrin. Por nuk ishte vetëm ky fakt. Berita me temperamentin e saj dhe në tërësi me formimin e saj kulturor dhe arsimor, ishte e aftë të orientohej mirë në bisedë me çdo njeri. Mund të futej në botën shpirtërore e të përjetonte shqetësimet apo ambiciet e çdo bashkëbiseduesi. Pikërisht këto veti e kishin bërë atë aq të njohur ndër shqiptarët në Kosovë para vitit 1990 dhe më pas ndër shqiptarët në Shqipëri.

Sipas bisedave me të, kanë qënë veprat e udhëtares angleze Edit Durham që i kanë ngjallur kureshtjen dhe simpatinë për popullin shqiptar. Pikërisht këto vepra patën një ndikim të fuqishëm mbi të, aq sa i ndryshuan dhe mendimin për punën në të ardhmen në drejtim të formimit dhe aktivitetit të saj si etnologe. Kjo simpati e nxiti drejt studimeve albanologjike. Në pamundësi për të ardhur në Shqipëri për të bërë kërkime në këtë fushë, puna e saj nisi me një udhëtim të gjatë në Kosovë, duke u përqëndruar më shumë në fshatin Isniq ku dhe mësoi mirë gjuhën shqipe. Aftësitë individuale i krijuan mundësi të realizojë një studim mjaft të mirë socio-etnologjik, të titulluar “Prapa mureve të gurta” (Behind the Stone Walls). Në këtë vepër mbi të gjitha vlen të theksohet qëndrimi plot mirëkuptim i autores për kulturën dhe traditat popullore të Kosovës, përpjekjet e saj për

të hyrë thellë në ato vlera që kanë të bëjnë me identitetin e popullit shqiptar. Pas shumë përpjekjesh në vitin 1981 Berita mundi të bëjë dhe një ekspeditë dy javore në Shqipëri, kryesisht duke u përqëndruar në kooperativën bujqësore të Cakranit (Fier). Dëshira e saj për t'u thelluar më tej në kërkimet e saj në Shqipëri, u plotësua në mars të vitit 1991 me rastin e realizimit të një filmi dokumentar shkencor titulluar "Psikologjia e fshatit shqiptar në prag të zgjedhjeve të para pluraliste". Ngjarjet dhe konfrontimet para dhe pas zgjedhjeve pluraliste në Shqipëri, krijuan një imazh jo të mirë për shqiptarët. Në këtë atmosferë duke u ndeshur me shumë paragjykime të eprorëve dhe kolegëve të saj norvegjeze, ajo krijoi mundësinë për hapjen e një ekspozite etnografike në Oslo të Norvegjisë. Dashuria dhe simpatia e saj për shqiptarët e shtynë atë edhe me veprime që nuk kishin të bënin me profesionin e etnologes. Pas disa vizitave në Kosovë dhe pasi ndoqi nga afër demonstratat e vitit 1981 (në Kosovë), në vitin 1986 ajo bëri një raport në Ministrinë e Jashtme Norvegjeze ku informonte për situatën dhe padrejtësitë që bëheshin në Kosovë. Sipas të dhënave të specialistëve ky ka qënë raporti më i saktë që është bërë nga të huajt për situatën në Kosovë. Në vitin 1987 pason një raport tjetër për Ministrinë e Drejtësisë të Norvegjisë. Në vitin 1989 ajo mbyll vizitat në Kosovë pasi shteti serb e cilëson tashmë person "non gratta". Që nga ky vit ajo punoi në zyrat për dhënien e vizave (në Norvegji) ku bëri përpjekjet maximale për të lehtësuar shqiptarët e Kosovës që shkonin për t'u strehuar e punuar në Norvegji.

Në vitin 1992 vjen në Shqipëri për të punuar si përfaqësuese e Komitetit të Helsinkit për Norvegjinë. Aktiviteti kryesor i saj fillimisht u përqëndrua në ndihmat për familjet e varfëra e më pas për rehabilitimin e të përndjekurve politikë në Shqipëri duke ngritur qendrën e parë të këtij lloji. Sa e sa të përndjekur kanë ndjerë dorën dhe fjalën e ngrohtë të Beritës, përpjekjet e saj për të dokumentuar vuajtjet shpirtërore e fizike të tyre. Ndërkohë nuk mund të lëmë pa përmendur një pjesë tjetër të saj shumë domethënëse. Berita më kërkoi një ditë ta ndihmoja të gjente dhe të adoptonte një fëmijë nga Shqipëria. Ëngjëlli i dëshiruar i saj u bë një vajzë nga Vlora, me emrin Besmira. Dhe, ndryshe nga rregullat e vendit të saj ajo nuk ia ndërroi as emrin, sepse pikërisht ky emër shprehte një nga vlerat më të mira të shqipëtarëve -besën e mirë.

Vdekja e parakohshme, më 7 mars 1993 e ndau me Besmirën që aq shumë e lumturoi dhe me miqtë shqiptarë që aq shumë i deshte. Me ta ajo kishte planifikuar të bënte shumë punë të tjera të dobishme.

SUMMARY

OF

THE FIRST REGIONAL WORKSHOP

**"TRAUMA, FACTORS, CONSEQUENCES AND THE COPING
PROCESS"**

**A REGIONAL PERSPECTIVE: ALBANIA, KOSOVA AND
MACEDONIA**

(FOTOGRAFIA)

THE TABLE OF CONTENT

	page
➤ The Organization, The Proceedings, The Decisions.....	
➤ The List of Participants.....	

SUMMARY

➤ Adrian Kati The opening speech	
➤ Tue Magnussen RCT strategy in supporting the victims of torture all over the world.....	
➤ Prof.As.Dr. Fatmira Rama The Albanian national persecution retrospective and the Balkan integration.An international and national world.....	
➤ Prof. Milaim Fejziu Trauma among the Albanians in Macedonia viewed in the aspect of the realization of their rights in Macedonia.....	

- **Prof. Adem Tamo**
A social and psychological perspective of trauma among the Albanians.....
- **Dr. Dragush Totozani**
The psychosocial treatment at ARCT.....
- **Bardhyl Belishova**
The particularities of rehabilitation of the communism totalitarian victims in Albania.....
- **Dr.Feride Rushiti**
The Kosovar Rehabilitation Center of Torture Survivors.....
- **Shaban Memeti**
The necessity of establishment of the Rehabilitation Center of Torture Survivors in Macedonia.....
- **Niazi Jaho**
Some issues concerning the Human Rights and Freedoms from the point of International Documents and of our Constitution.....
- **Luan Kroj**
The integration institute experience of the former political persecuted.....
- **Aferdita Onuzi**
Grateful for good friends such as Berit Backer.....

THE FIRST REGIONAL WORKSHOP

